



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i raportit "Mbi veprimtarinë e Inspektoratit të KLD-së për vitin kalendarik 2014".

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| 1. Bujar Nishani | (kryetar) |
| 2. Xhezair Zaganjori | (anëtar) |
| 3. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 4. Flamur Kapllani | (anëtar) |
| 5. Dritan Caka | (anëtar) |
| 6. Gjin Gjoni | (anëtar) |
| 7. Ilir Mustafaj | (anëtar) |
| 8. Hysen Saliko | (anëtar) |
| 9. Tritan Hamitaj | (anëtar) |
| 10. Sokol Çomo | (anëtar) |
| 11. Albana Shtylla | (anëtare) |
| 12. Vangjel Kosta | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Nasip Naço, Zoti Artan Broci dhe Zoti Astrit Haxhialushi.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
2. **Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
3. **Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
4. **Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
5. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
6. **Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
7. **Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
8. **Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.**
9. **Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.**
10. **Agnes Bernhard, Eksperte EURALIUS IV.**
11. **Erton Karagjozi, Përfaqësues i EURALIUS-it.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i raportit “Mbi veprimtarinë e Inspektoratit të KLD-së për vitin kalendarik 2014”.

Bujar Nishani: Atëherë, përshëndetje të gjithëve!

Hapim mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Së pari, në lidhje me rendin e ditës me të cilin jeni njohur, keni marrë materialet, ka ndonjë sugjerim? Ndonjë diskutim?

Mirë! Unë kisha diçka!

Para disa ditësh ka mbërritur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë - në fakt ka qenë një interesim i administratës - një vendim i Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda për dhënien e fajësisë ndaj gjyqtarit Dhimitër Pojanaku, i cili është dënuar nga kjo gjykatë.

Kjo është e gjykatës së apelit?

Tani, normalisht, po të ishim njohur më parë me vendimin e gjykatës, do ta kishim futur në rendin e ditës për ta trajtuar. A gjykoni që ta fusim sepse një gjyqtar i dënuar nuk mund të jetë më... Ky është i pezulluar aktualisht. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka një...

Domethënë është bërë një konsultë paraprake me Ministrin dhe Ministri thotë se ky nuk është rasti klasik i nisjes së procedurës.

(Jo me Ministrin, thjesht administrata me Kryeinspektoren.)

Vendimi është i formës së prerë, është i apelit. Është i apelit, Albana!

(Anëtarët e Këshillit diskutojnë njëherësh pa ndezur mikrofonat.)

Ai i pezulluar është. Por a është obligim, desha ta diskutoj! A e kemi obligim si Këshilli i Lartë i Drejtësisë që të marrim masën e shkarkimit, sepse është i dënuar me formë të prerë domethënë.

(Zoti Gjoni flet pa ndezur mikrofonin.)

Gjin Gjoni: Normalisht, po t'i referohemi Kushtetutës, po!

(Zoti Hallunaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Dritan Hallunaj: Ai do procedurë të rregullt. Nuk mund ta kalojmë kështu, pa u thirrur gjyqtari.

Bujar Nishani: Po, është i dënuar. Nuk është masë disiplinore në këtë rast.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Urdhëro? Jo, jo, nuk po e diskutojmë për shou (show), po e diskutojmë për të qenë korrekt me detyrimin që ka Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Gjin Gjoni: Më fal, Zoti President!

Po t'i referohemi nenit 147 të Kushtetutës, në pikën 6 thuhet: "Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi", që normalisht është vërtetuar me një vendim të formës së prerë. Se, nuk do të thotë që vendimi nuk ekziston. Nuk thotë që vendimi nuk ekziston, se s'ka çfarë të thotë në rastin konkret. Kështu që...

Bujar Nishani: Kush është dakord ta fusim në rendin e ditës shqyrtimin e vendimit për shkarkimin e gjyqtarit Dhimitër Pojanaku, pas vendimit të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë

për Krimet e Rënda, e cila e ka dënuar gjyqtarin Pojanaku, e ka gjetur të fajshëm dhe e ka dënuar.

Kush është dakord për ta futur?

Dy, katër, gjashtë, shtatë (7).

Kundra?

Tre (3).

Atëherë, futet në rend dite edhe kjo si pikë. Ju lutem, bëjeni si pikë të fundit të rendit të ditës, para se të kalojmë ato.

(Zoti Gjoni kërkon të shpërndahet një kopje e vendimit.)

Po, po, patjetër!

Atëherë, ju lutem administrata – Pjerin - të bëjë gati këtë materialin e ardhur nga gjykata. Si pikë e rendit të ditës, të vendoset diku nga fundi, përpara shqyrtimit të vlerësimit për gjyqtarët, para pikës 12. Dhe gjatë kësaj kohe të përgatitet materiali, t'u jepet të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Shiko, ka edhe një pikë tjetër. Përveç dënimit penal, ka edhe një pikë që thotë: "...heqja e të drejtës të pandehurit Dhimitër Pojanaku për të ushtruar funksione publike për një afat 5 vjetësh, bazuar në nenin kaq".

(Zoti Hamitaj flet pa ndezur mikrofonin.)

A ta lëmë ta diskutojmë kur është si pikë atëherë, që të mos e bëjmë diskutimin dy-tre herë?

Mirë atëherë, fillojmë me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës. Shqyrtimi i Raportit mbi veprimtarinë e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për vitin kalendarik 2014. Me Raportin jeni njohur. Nëse është e nevojshme një përmbledhje, një pasqyrim i shkurtër nga ana e Kryeinspektores. Është e nevojshme, apo të kalojmë direkt në diskutime?

Atëherë, Zonja Xhaferllari!

Po, po!

Xhezair Zaganjori: Do ju kërkoj ndjesë vetëm për një gjë të vogël që m'u kujtua.

Për çështjen e konferencës që zhvillohet në maj, 27-29 maj.

Do ju lutesha që anëtarët ta kenë në vëmendje për të marrë pjesë aktive. Grupi i punës që keni ngritur - është edhe Zoti Gjoni edhe Zoti Hallunaj - është mbledhur, ka

përcaktuar një axhendë. Nëse keni dëshirë të njiheni me axhendën, mund t'ua shpërndajmë një projekt të Konferencës së Këshillave të Drejtësisë të zonës ballkanike dhe mesdhetare. Ka qenë një shqetësim në fakt, që nuk ka një qendër, një pikë permanente kontakti dhe ka qenë shumë e vështirë të vendoseshin kontaktet fillimisht. Por ndërkaq, disa nga shtetet, rreth 7 apo 8 shtete janë përgjigjur që do të marrin pjesë. Kështu që, nëse ka ndonjë pyetje ne mund t'i përgjigjemi. Por ndërkaq, ne kemi avancuar me programin, edhe meqenëse praktikisht ka më pak se një muaj, do ju luteshim që edhe ju ta keni në axhendën tuaj sepse është një ngjarje e cila kërkon vëmendjen e të gjithëve. Faleminderit!

Bujar Nishani: Mirë atëherë, pyetje rreth raportit?

Diskutime, sugjerime, rekomandime për raportin?

Mirë atëherë, s'ka.

Po, urdhëro Zonja Shtylla!

Albana Shtylla: Faleminderit, Zoti President!

Në fakt e kam lexuar me vëmendje raportin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Vlerësoj informacionin e përcjellë ndërmjet tyre. Për sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë si me verifikimin e ankesave, procedimin disiplinor, vlerësimin të gjyqtarëve e të tjera çështje, të cilat janë të parashikuara si kompetenca dhe detyra të Inspektoratit të KLD-së edhe në Rregulloren e miratuar në KLD. Në elementë të caktuar të cilët janë pasqyruar në këtë raport, do të doja të theksoja vazhdimin e mëtejshëm të procedurave nga ana e Inspektoratit të KLD-së edhe këmbënguljes së tyre, sa i përket vlerësimin të gjyqtarëve, një çështje të cilën ne e kemi trajtuar edhe më parë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Ndërkohë që do të rekomandoja për çështje të cilat vetë Inspektorati i ka konsideruar dhe ka vlerësuar që ka rregulla të paqarta, si për sa i përket sigurimit të provave apo të dhënave në fazat e vlerësimin paraprak. Po kështu, për sa i përket rregullave të paplota, të identifikuara edhe prej jush, lidhur me identifikimin e saktë të konkluzioneve në fazën e vlerësimin paraprak, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, t'i lëre ndoshta një detyrë – e propozoj këtë gjë – Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të bërë plotësimet e akteve, të cilat sipas tyre, janë të paplota apo të paqarta në funksion të realizimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre.

Po kështu edhe për sa i përket bashkëpunimit me institucione të caktuara, do të vlerësoja shumë të ketë një bashkëpunim të mëtjshëm në ushtrim të kompetencave që ka kanë të bëjnë me verifikimin e rasteve të përcjella nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive, për sa i përket deklarimit të pasurive të gjyqtarëve, por jo vetëm, edhe për rastet e papajtueshmërisë së gjyqtarëve. Të dyja janë kompetenca të parashikuara në Rregulloren e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ka një paragraf në fakt në raport, në faqen 38, gjithësesi në vëmendje të tyre duhet të jetë pikërisht kjo çështje, bazuar, kuptohet dhe në ankesat apo dhe në procedurat që kanë, të bashkëpunimit me Inspektoratin, po kështu dhe me institucionin e Avokatit të Popullit. Në fakt është pasqyruar që në vijim të marrëveshjes që ka Inspektorati, ka patur shkëmbim shkresash, por njëkohësisht përcjellje të qëndrimeve të tyre për rekomandime të caktuara, në vijim të ketë një bashkëpunim të mëtjshëm, për të patur një situatë sa më të rregullt ligjore në sistem. Faleminderit!

Bujar Nishani: Faleminderit dhe ju!

Tjetër mendim, koment, rekomandim?

Nuk ka.

Atëherë kush është dakord me raportin e paraqitur dhe me propozimet dhe rekomandimet e adresuara nga Zonja Shtylla për t'iu adresuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë? Kush është dakord?

Kundra?

Një (1).

Miratohet.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i projektvendimit të KLD-së "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të Kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

Shënim: Duke qenë se pika e tretë e rendit të ditës shtyhet për më tej, për efekt të procesverbalit, pjesa ku anëtarët diskutojnë për shtyrjen e saj, i bashkohet këtij procesverballi.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Bujar Nishani*** (kryetar)
2. ***Xhezair Zaganjori*** (anëtar)
3. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
4. ***Flamur Kapllani*** (anëtar)
5. ***Dritan Caka*** (anëtar)
6. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Mustafaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Hysen Saliko</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Tritan Hamitaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Sokol Çomo</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Albana Shtylla</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>12. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Nasip Naço, Zoti Artan Broci dhe Zoti Astrit Haxhialushi.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.*
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Agnes Bernhard, Eksperte EURALIUS IV.*
- 11. Erton Karagjozi, Përfaqësues i EURALIUS-it.*

RENDI I DITËS:

2. Miratimi i projektvendimit të KLD-së “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të Kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Shënim: Duke qenë se pika e tretë e rendit të ditës shtyhet për më tej, për efekt të procesverbalit, pjesa ku anëtarët diskutojnë për shtyrjen e saj, i bashkohet këtij procesverballi.

Bujar Nishani: Kalojmë në pikën dy të rendit të ditës. Miratimi i projektvendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të Kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Atëherë, në lidhje me projektin e paraqitur, pyetje? Sugjerime?

Është punuar dhe në bashkëpunim me EURALIUS.

Atëherë, kush është dakord me vendimin e paraqitur “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit”?

Kundra?

S’ka.

Miratohet edhe projektvendimi “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të Kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Pika e tretë e rendit të ditës, kemi shqyrtimin e kërkesës së zonjës Arta Llazari me objekt “Rikthim në vendin e mëparshëm të punës, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër”.

(Disa nga anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonat.)

Po pse e kam unë këtë rend dite?

Atëherë, më falni.

Pika tre është shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë të Drejtësisë për pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Zotit Osman Aliu.

Ministrin nuk e kemi.

A ta shtyjmë më poshtë këtë? Të presim derisa të vijë Ministri, se është në mbledhje qeverie edhe e shqyrtojmë në momentin që vjen Ministri.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Ne presim. Nëse Ministri nuk vjen, e marrim vetë vendimin. Derisa të mbarojë mbledhja. Mbetet për shqyrtim kjo.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së Zonjës Arta Llazari, datë 31.10.2014, me objekt "Rikthim në vendin e mëparshëm të punës", si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 4, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 3 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Bujar Nishani** (kryetar)
2. **Xhezair Zaganjori** (anëtar)
3. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
4. **Flamur Kapllani** (anëtar)
5. **Dritan Caka** (anëtar)
6. **Gjin Gjoni** (anëtar)
7. **Illir Mustafaj** (anëtar)
8. **Hysen Saliko** (anëtar)

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| 9. Tritan Hamitaj | (anëtar) |
| 10. Astrit Haxhialushi | (anëtar)* |
| 11. Sokol Çomo | (anëtar) |
| 12. Albana Shtylla | (anëtare) |
| 13. Vangjel Kosta | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Nasip Naço, Zoti Artan Broci.

Shënim 2: Zoti Haxhialushi hyn në sallën e mbledhjes gjatë shqyrtimit të kësaj pike.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.**
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.**
- 10. Agnes Bernhard, Eksperte EURALIUS IV.**
- 11. Erton Karagjozi, Përfaqësues i EURALIUS-it.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i kërkesës së Zonjës Arta Llazari, datë 31.10.2014, me objekt “Rikthim në vendin e mëparshëm të punës”, si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Bujar Nishani: Pika 4 (sipas procesverbalit i bie pika 3): Shqyrtimi i kërkesës së Zonjës Arta Llazari, me objekt “Rikthim në vendin e mëparshëm të punës”, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Zonja Llazari ka qenë këshilltare në Gjykatën Kushtetuese. Ka përfunduar mandatin e saj. Kërkon të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës, si gjyqtare në Gjykatën e Shkodrës.

Ka vakancë në Gjykatën e Shkodrës?

I është ruajtur vendi. Dakord.

Pyetje, diskutime?

Po, Zoti Kryetar!

Xhezair Zaganjori: Kam theksuar dhe herë të tjera, domethënë që është shumë mirë që gjyqtarët, magjistratët apo edhe gjyqtarët me eksperiencë, të punojnë në Gjykatën Kushtetuese apo dhe në Gjykatën e Lartë për një periudhë të caktuar kohe dhe mendoj që praktika ka treguar që përthithja e këtyre gjyqtareve vitet e fundit, mendojë që është një faktor pozitiv në punë, si të thuash në lidhjen ndërmjet niveleve të ndryshme të gjyqësorit. Por më duket që shqyrtimi dy herë i kërkesës nuk është gjë normale. Unë them që kur bëhet miratimi gjithmonë duhet që të përcaktohet edhe data se kur do të kthehet në detyrë dhe me sa jam në dijeni ka disa muaj që pret. Normalisht duhet të kthehet automatikisht. Pra, me mbarimin e afatit, në zbatim të vendimit të parë që ka marrë KLD-ja, duhet që gjyqtari i cili ka shërbyer në Gjykatën e Lartë apo në një vend në ministri apo në Gjykatën Kushtetuese, automatikisht të kthehet, pa pritur një mbledhje për të konfirmuar dhe njëherë kthimin, sepse vendi këtyre i ruhet. Kështu që mendoj që kjo praktikë duhet të ndryshohet, që të operohet disi më shpejt.

Bujar Nishani: Po, Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Faleminderit, Zoti President!

Edhe unë bashkohem me qëndrimin e Zotit Zaganjori dhe ndaj të njëjtën pikëpamje në lidhje me tërheqjen e gjyqtarëve si Këshilltarë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, qoftë dhe të niveleve të tjera në rast se do lindi e nevojshme.

Është e vërtetë që Zonja Llazari ka një periudhë kohore prej 1 muaj e ca që nuk merr rrogën, ndoshta edhe më shumë, për shkak të qëndrimit të saj pranë Gjykatës Kushtetuese dhe moskthimit në vendin e punës. Mendoj që në këtë pikë ne duhet ose të

marrin një vendim kuadër në ditën e sotme dhe të themi: Të gjithë personat të cilët shërbejnë në institucione shtetërore, në bazë të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe ligjin “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë”, në momentin e emërimit, të llogaritet koha 3-vjeçare dhe pa vendim të KLD-së të kthehen menjëherë në vendin e punës sepse praktika e deritanishme, të them të drejtën, ka rezultuar që një pjesë e këtyre të kenë qëndruar për një periudhë derisa është bërë mbledhja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Dhe unë them që në rast se me dy dispozita ligjore, të përgatisim bashkë me qëndrimin që kemi në lidhje me... jam plotësisht dakord që të shkojë në vendin e mëparshëm të punës dhe për shkak të ligjit, vendet e punës e të gjithë gjyqtarëve të cilët shërbejnë në administratën shtetërore dhe në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë, të ruhen, të shkojnë automatikisht në vendin e punës dhe mos të mbledhet Këshilli i Lartë i Drejtësisë të marrë një vendimmarrje për një diçka që parashikon ligji.

(Hyn në sallën e mbledhjes Zoti Haxhialushi.)

(Zoti Zaganjori flet pa ndezur mikrofonin.)

Gjin Gjoni: Po, po, në momentin e dhënies së lejes të thuhet: Me plotësimin e afatit 3-vjeçar, saç e parashikon, fillon momenti i fillimit të punës. Faleminderit!

Bujar Nishani: Dakord. Vetëm ka një problem Zoti Gjoni, sepse po i referohemi rastit konkret. Nuk jam kundër asaj që thatë ju, se mirë do të ishte që në çdo rast, kur ka një vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që jep leje për të shkuar, le të shtohet një paragraf aty e të thuhet që në momentin e përfundimit të kthehet në vendin e punës sepse vakanca u ruhet. Por ka një problem. Në rastin konkret, sepse parimin e pëlqimit nuk mund ta ekskludojmë, ekziston. Parimi i pëlqimit tek gjyqtari ia ka dhënë ligji, apo jo? Dhe ne nuk mund ta ekskludojmë parimin e pëlqimit. Tani, rasti konkret ka qenë që ne nuk kemi pasur një kërkesë zyrtare sepse zonja ka aplikuar për në Gjykatën e Apelit të Shkodrës në mos gaboju unë, dhe përderisa nuk ka pasur një kërkesë për t’u rikthyer në vendin e punës, ka një kontradiktë tashti. A e ka pëlqimin ajo për t’u rikthyer në atë vend pune apo s’e ka pëlqimin?! Kështu që nuk mundet Këshilli i Lartë i Drejtësisë të marrë një vendim apriori. Por ama, nëse ne vendosim që në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë - vendimin bazë, që i jepet leje për të shërbyer në një institucion të caktuar - një pikë e këtij vendimi mund të shtohet që, me të mbaruar rikthehet në vendin përkatës,

nuk jam kundër, por rastet duhen marrë dhe duhet të shikojmë dhe të reflektojmë eksperiencat që kemi pasur në këto raste.

Po, urdhëro Zoti Gjoni! Pastaj, Zoti Hallunaj!

Gjin Gjoni: Faleminderit, Zoti President!

Keni jashtëzakonisht shumë të drejtë, por problemi është, në rast se ne nuk vendosim afatin 3-vjeçar të kthimit dhe iks gjyqtar ose ipsilon gjyqtar nuk kthehet në vendin e punës, i bie që kjo të përjashtohet, të dalë nga sistemi brenda afatit 3-vjeçar. Nuk kërkohet pëlqimi në rastin konkret, sepse ligji e ka thënë në mënyrë taksative. Mund të marrim një rast të kësaj natyre, të supozojmë për një moment që një gjyqtar ka marrë një leje 3-vjeçare për shkak të një doktorature, por doktoratura është 4 vjet, është i detyruar të kthehet në vendin e punës, të paktën minimum 1 muaj, 2 muaj, 3 muaj pas kalimit të afatit 3-vjeçar, dhe mund të vijë dhe të kërkojë prapë pranë KLD-së edhe 1 vit tjetër për shkak të kësaj. Por në rast se do kaloi afati 3-vjeçar dhe nuk kthehet në vendin e punës, presupozohet që është përjashtuar njëherë e mirë dhe ka dalë nga sistemi i drejtësisë.

Bujar Nishani: Por nuk e kemi kriter detyrues neve në ligj për shërbimin e gjyqtarëve se po ta kishim në ligj kriter detyrues për të shërbyer në sistem 5 vjet, 6 vjet apo 10 vjet ishte tjetër gjë. Megjithatë, unë jam dakord. Jam dakord, në çdo rast, le të hartojmë një udhëzim, a një vendim, a një qëndrim, që në çdo rast, vendimit t'i shtohet që të kthehet automatikisht në vendin e punës. Hallunaj, urdhëro! Pastaj, Tritani!

Dritan Hallunaj: Thjesht në përforcim të kësaj që diskutuan edhe kolegët, ashtu edhe ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”: “...me kërkesë të institucioneve...”, pra pa e cituar të gjithë paragrafin, “...mund të shërbejnë për një afat 3 vjet në strukturat... Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës”. Pra e ka edhe ligji taksative që duhet të kthehet aty. Pastaj është histori tjetër që...

Bujar Nishani: Po, dakord. Po, Zoti Hamitaj! Pastaj, Zoti Mustafaj!

Tritan Hamitaj: Atëherë, në vazhdim të kësaj, në vendimmarrjen që do të marrim, unë them të shtojmë edhe një pikë që të rregullojmë edhe problemin e pagës. Që nga momenti që asaj i është ndërprerë paga në Gjykatën Kushtetuese, të paguhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi gjyqtari nuk mund të rri pa pagë.

Bujar Nishani: E kemi këtë kompetencë administrative neve?

(Disa nga anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Tritan Hamitaj: Andej e ka ndërprerë punën, në Gjykatën Kushtetuese. Këtej ngelet pa pagë dhe gjyqtarit nuk mund t'i cenohet paga. Kështu që është detyrim kushtetues ai që të vazhdojë të paguhet.

Bujar Nishani: Mund ta citojmë.

Po, Zoti Mustafaj!

Ilir Mustafaj: Faleminderit, Zoti President!

Që të mos kalojmë në përsëritje. Rasti i gjyqtares duhet bërë shembull edhe për raste të tjera sepse janë rreth 4, 5, 6 raste të tjera që do të na vijnë në vijim, që ne u kemi dhënë leje dhe shikoj në relacion që gjyqtarja, që në datën 14.12.2014... Ka 5 muaj përpara që i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe i ka thënë që dua të rikthehem. Kështu që i bëhen afërsisht 5 muaj e gjysmë që gjyqtarja ka bërë kërkesën dhe vazhdon të qëndrojë në pritje të vendimmarrjes sonë. Kështu që, vendimi që do të marrim ne sot, të jetë i tillë që t'u shërbejë edhe rasteve të tjera, që në mbarim të afatit të vendosur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në institucionin që do të shërbejë si këshilltar në Gjykatën Kushtetuese apo në Gjykatën e Lartë, të kthehet automatikisht në vendin e mëparshëm të punës. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, Zoti Kapllani!

Flamur Kapllani: Po, faleminderit Zoti President!

Unë mendoj se nuk është rasti sot për të shtuar çfarë thanë kolegët, por unë propozoj që në vendimin bazë të dhënies së lejes për afatin, ne përcaktojmë edhe datën e kthimit për çdo gjyqtar, që të mos e kemi më këtë procedurë sot sepse sot nuk mund të diskutojmë një gjë që ka shkuar. Por, në rastet që do të japim leje në vijim, përcaktojmë edhe datën e kthimit në punë.

Bujar Nishani: Mirë, plotësisht dakord që në çdo rast, vendimi të përfshijë edhe kthimin.

Gjin Gjoni: Është problemi për këta që i kemi dhënë leje. Më fal, Presidenti e tha shumë qartë që në çdo rast të ashtu. Por janë katër raste në të cilat është dhënë leje dhe po u mbaroi mandati, duhet të vijnë në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ?

Bujar Nishani: Të vijnë të paraqesin kërkesën.

Gjin Gjoni: Okej, dakord.

Bujar Nishani: Atëherë, kush është dakord me rikthimin në vendin e mëparshëm të punës të gjyqtares Rezarta, më falni, Arta Llazari?

Pagën nuk e zgjidhim ne dot. Të shkojë ta zgjidhë në Gjykatën Administrative.

Kush është dakord?

Kundra?

S'ka.

Miratohet.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Përcaktimi i numrit të vendeve vakante për kandidatët për magjistratë (profili gjyqtar), për vitin akademik 2015-2016, në Shkollën e Magjistraturës.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 5, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 4 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Bujar Nishani*** (kryetar)
2. ***Xhezair Zaganjori*** (anëtar)
3. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
4. ***Flamur Kapllani*** (anëtar)
5. ***Dritan Caka*** (anëtar)
6. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
7. ***Ilir Mustafaj*** (anëtar)
8. ***Hysen Saliko*** (anëtar)

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| <i>9. Tritan Hamitaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Astrit Haxhialushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Sokol Çomo</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>12. Albana Shtylla</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>13. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Nasip Naço, Zoti Artan Broci.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.*
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Agnes Bernhard, Eksperte EURALIUS IV.*
- 11. Erton Karagjozi, Përfaqësues i EURALIUS-it.*

RENDI I DITËS:

4. Përcaktimi i numrit të vendeve vakante për kandidatët për magjistratë (profili gjyqtar), për vitin akademik 2015-2016, në Shkollën e Magjistraturës.

Bujar Nishani: Pika 5 e rendit të ditës (*sipas procesverbalit i bie pika 4*): “Përcaktimi i numrit të vendeve vakante për kandidatët për magjistratë (profili gjyqtar), për vitin akademik 2015-2016, në Shkollën e Magjistraturës.

Keni një shkresë të ardhur nga Shkolla e Magjistraturës, kërkesë për numrin e vendeve vakant dhe me sugjerimin... i është bërë me dije edhe Ministrisë së Drejtësisë, ka pasur një kërkesë edhe me Ministrinë e Drejtësisë nga ana e Shkollës së Magjistraturës. Pra, është sugjeruar që numri i vendeve vakant për kandidatë për magjistratë (profili gjyqtar) për konkursin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2015-2016, të jetë 16 kandidatë, vlerësuar si një numër optimal për mbushjen e kërkesave me gjyqtarë në gjykata. Ministri nuk e kemi për të na dhënë një qëndrim të tij por...

Xhezair Zaganjori: Kjo ka qenë edhe kërkesa e shkollës.

Bujar Nishani: Po, e shkollës.

Xhezair Zaganjori: Në fakt ka një rritje të numrit për shkak edhe të faktit se vjet nuk u organizua, nuk kishte pranime për shkak hyrjes në fuqi të ligjit. Kështu që unë them që është më se normale, kërkesa është e shkollës. Në qoftë se është nevoja për të dëgjuar edhe mendimin e Ministrit është tjetër gjë, por numri është optimal dhe është normal.

Bujar Nishani: Po, Zoti Gjoni! Pastaj, Zoti Caka!

Gjin Gjoni: Faleminderit, Zoti President!

Unë e kam lexuar me vëmendje të gjithë kërkesën e parashtruar nga ana e Shkollës së Magjistraturës dhe kërkesën për caktimin e numrit të vendeve vakante për kandidatë të Ministrit të Drejtësisë. Unë them që është e vërtetë ajo që tha Zoti Zaganjori, që vitin e kaluar nuk u realizua për shkak të ristrukturimit dhe ndryshimeve që ndodhën në ligjin “Për Shkollën e Magjistraturës”. Problemi është që në momentin aktual ne kemi 10 gjyqtarë të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe presin që të emërohen. Problemi është që duhet të shihet edhe njëherë e gjithë struktura dhe organika e sistemit të drejtësisë dhe të shohim sa vende vakante ka sistemi sepse nuk mundet Shkolla e Magjistraturës të sjellë kërkesa të njëpasnjëshme dhe të thotë që unë kapacitetet ose kërkesat i kam për 16, në një kohë që ne nuk e dimë se sa vende vakante ka. Dhe në rast se nesër-pasnesër, i bie që këto 16 veta të përfundojnë Shkollën e Magjistraturës dhe të ngelen pa u emëruar, atëherë kujt i bie barra? Prandaj duhet të ketë një bashkëpunim

midis Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës. Dhe po ta shohësh, kjo është ajo e reja që solli ligji “Për Shkollën e Magjistraturës”, që shkëputi fare Shkollën e Magjistraturës nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë përcakton vetëm vende dhe asgjë tjetër dhe miraton programin e trajnimit të gjyqtarëve. Dhe po ta shohësh, tani të gjitha kompetencat, pavarësisht se Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është edhe Kryetari i Bordit të Shkollës së Magjistraturës, padyshim që ka një lloj lidhje, por problemi është që në momentin aktual të përcaktosh 16 vende për magjistraturën në një kohë që akoma... dhe unë e kam ngritur me të madhe dhe me forcë që e gjithë vonesa që ka ardhur për emërimin e magjistratëve, që me të vërtetë unioni i gjyqtare dhe shoqatat e ngrenë që nuk janë emëruar, është për shkak se Ministri i Drejtësisë akoma nuk ka liruar vendet vakante, nuk janë shpallur vendet vakante për gjyqtarët të cilët duhet të shpallen dhe mbi bazën e kësaj të bëhen edhe emërimet e magjistratëve të rinj. Pasi të bëhen edhe emërimet e këtyre të dhjetëve, ne të arrijmë në konkluzionin se cilët janë vendet vakante dhe a janë 10, a janë 11, a janë 16 apo do të jenë 20?

Ky është qëndrimi im. Në këtë moment, pa u arritur në një konkluzion të saktë dhe të jetë një studim edhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, ne nuk mund të hapim vende në mënyrë... Edhe koha është e mjaftueshme besoj që nga moment i sotëm, që është prill, deri në momentin që do të organizohet provimi që është gushti, të bëhet një studim edhe të thuhet që për vitin 2015-2016 ose në vitin 2018, kur të mbarojnë këta zotërinjtë shkollën, sistemi i drejtësisë ka nevojë edhe për kaç vende vakante. Ky është qëndrimi im. Faleminderit!

Bujar Nishani: Një minutë Albana. Është Tritani. Pastaj, Albana! Pastaj, Iliri!

Zoti Gjoni dhe ndoshta edhe për të tjetër. Në fakt ka një analizë që kemi dalë në këtë numër. Analiza është e bazuar tek vakancat që janë në gjykatat e rretheve. Aktualisht janë 10 vende vakante në gjykatat e rretheve. Janë 10 vende vakante në gjykatat e apeleve. Janë njëkohësisht 7 vende vakante në gjykatat administrative. Dhe është parashikuar që deri në vitin 2018 ku përfundojnë studimet (rasti i magjistratëve), të dalin në pension 7 gjyqtarë. Pra, në total, deri në përfundimin e studimeve të magjistratëve që do të nisin studimet në 2015-ën (që është 2018-ta) janë në dispozicion gjithsej 34 vende vakante. Nga kjo, zbriten numri i stazhierëve që janë në studim dhe që kanë përfunduar

dhe që janë 19 stazhierë dhe mbeten gjithsej 15 vende vakante në sistem për ata që përfundojnë në 2018-ën, që është e sigurt.

Pra ka një analizë në fakt. Po, më thuaj Gjin, në qoftë se unë kam. Jam plotësisht dakord. E bëra këtë sqarim që ka një analizë. Pastaj se sa qëndron kjo analizë, dakord do ta diskutojmë. Po, urdhëro!

Gjin Gjoni: Jo, them, ne mund të vendosim një kriter për shembull që, të ruajmë të njëjtën traditë që është ruajtur deri në momentin aktual që të çohen 9 deri në 10, sa janë çuar dhe në vitet pasardhëse pastaj të shihet mundësia, sepse Shkolla e Magjistraturës aty është, nuk është se ndryshon.

Bujar Nishani: Zoti Caka! Zonja Shtylla! Zoti Mustafaj!

Dritan Caka: Duke lexuar arsyetimin që ishte bërë lidhur ne përcaktimin e numrit, do të kisha një sugjerim. Nuk e di se sa mund të jetë i bazuar por kam përshtypjen që sipas atij planifikimi që është bërë, ndoshta do të ishte mirë që këto 16 studentë të rinj që mendohet, të ndaheshin për 2 vite sepse do të ishte mirë që edhe vazhdimësia e Shkollës së Magjistraturës të bëheshin 10 ose 8 për vitin që vjen dhe të lihen 8 vende të tjera. Sepse kështu siç ishte planifikuar mua më duket që për vitin pasardhës, sipas kësaj, do të jetë zero.

Xhezair Zaganjori: Jo s'ka mundësi të jetë zero. Pse nuk do dalin në pension, nuk do hapen vende vakante?

Dritan Caka: Sugjerim e kam. Nuk e di.

Ilir Mustafaj: Unë një problem kam këtu Zoti President. Unë jam shumë dakord që në analizën që thuhet në relacion janë 10 vende bosh në gjykatën e faktit, janë 10 vende bosh në gjykatën e apelit, janë 7 vende bosh nga këta që dalin në pension, vetëm të mos harrojmë një gjë që e kemi problematike, është problemi i 7 vendeve vakante në gjykatën administrative, të cilat me ligjin që kemi ne sot dhe me praktikën që ne kemi bërë nuk janë për t'u mbushur asnjëherë sepse nuk shkon askush. Dhe ne me të drejtë kemi bërë kërkesë këtu me ndryshimin në ligjin "Për gjykatën administrative" dhe kemi thënë, për gjykatën administrative, për studentët e Shkollës së Magjistraturës, i kemi thënë edhe arsyet, të hiqet provimi. Tani në qoftë se neve me mënyrën se si e kemi gjendjen sot do të vendosim këto 7 që kemi për gjykatën administrative të shkallëve të para, ngelet e pazbatueshme dhe do ngelin këto vende, do të mbarojnë magjistratët dhe

nuk i emërojmë dot në këto 7 vende sepse duan konkurs. Ndaj duhet të ndryshojmë sepse këtu janë të parashikuara 7 vende, mbështetet mbi këto 7 vende vakant. Kështu që duhet të ndryshojë ligji, që kandidatët që mbarojnë Shkollën e Magjistraturës për gjyqtarë duhet që të mos kenë probleme për të vajtur në këto vende. Kështu që kjo 7-she i sjell shumë problematikë në situatën e numrit që kemi. Faleminderit!

Albana Shtylla: Faleminderit, Zoti President!

Në fakt, në vijim pikërisht të asaj çfarë ju parashtruat dhe në relacion, doja t'i thosha pikërisht edhe Zotit Gjoni, është bërë një analizë lidhur me numrin e vendeve të cilat janë vakante, qoftë në shkallë të parë apo të dytë. Ne këtu jemi anëtarë të KLD-së, kemi diskutuar që do të vijohet në fillim me plotësimin e vendeve të gjykatës së apelit dhe kuptohet pastaj emërimet e magjistratëve, megjithatë vlerësoj që është një element shumë i rëndësishëm duke qenë se kanë kaluar tashmë, po bëhet viti i dytë, duhet të kemi një emërim të 10 magjistratëve, çfarë do të thotë që duhet KLD-ja të vijojë me procesin e emërimit të tyre.

Për sa i përket numrit të vendeve vakante, në bazë të llogarive që parashtrohen në fakt nga relacioni i KLD-së, rezulton që janë 15 vende. Nëse do t'i shtohet në fakt edhe argumenti që thotë pikërisht Zoti Mustafaj, normalisht ne mund të kemi raste të tjera shtesë për sa i përket vendeve vakante. Po kështu, nëse do t'i referoheni dhe vendimit të mëparshëm të KLD-së për shtimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Administrativ, përsëri mund të jenë vende të tjera vakante. Pra, unë mbaj mend që një vendimmarrje shumice këtu vendosi që të ketë 6 shtesa në Gjykatën e Apelit Administrativ. Pra, le të themi, ideja ka qenë normalisht që ka vende të cilat mund të shkojnë drejt lirimimit apo hapjes së vendeve vakante në sistemin gjyqësor.

Në këtë kontekst jam duke argumentuar faktin që numri i parashikuar dhe i përcjellë në relacionin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është plotësisht i mundshëm për të patur një emërim dhe garantim të magjistratëve për pozicione në sistemin gjyqësor, e para dhe e dyta, besoj që ashtu siç është bërë edhe në vitet e mëparshme, ka patur studime, besoj edhe studimet që janë bërë për studentët e magjistraturës të cilët mbarojnë sivjet, kanë patur apo janë paraprirë nga një studim i cili është bazuar në shifra në të dhëna të sakta, e njëjta gjë do të veprohet edhe në vijim. Pra mbështes propozimin e bërë për të

patur një rritje të numrit të.. më saktë, caktimin e numrit të magjistratëve për gjyqësorin në 16 persona, bazuar në analizën e bërë nga vetë KLD-ja.

Bujar Nishani: Po, Zoti Hamitaj!

Tritan Hamitaj: Duke u bazuar vetëm tek ky studimi i paraqitur, numri i vendeve maksimalisht bosh është 15, ndërkohë që propozimi bëhet për 16. Për 1 vend nuk ka asnjë lloj justifikimi. Pse duhet të jetë 16 dhe pse nuk kërkohet 15?

Bashkohem me Zotin Mustafaj që këto 7 vendet e gjykatës administrative, ne nuk mund t'i marrim si mundësi për t'i mbushur, pa ndodhur një ngjarje e sigurt, që është ligji. Ndryshimi i ligjit për t'u dhënë mundësi gjyqtarëve të tjerë pa bërë 5 vjet apo pa kaluar në provim për t'u mbushur këto vende.

Bashkohem dhe me Zotin Caka që thotë që Shkolla do një vijueshmëri për të bërë një grup studentësh të një viti akademik. Nuk mund të bëhet me 2 studentë. Këtë vit mund të bëhet me 16. Vitin tjetër dalin në pension 2 veta dhe i bie që klasa të bëhet me 2 studentë. Do një vijueshmëri.

Dhe e treta është që këto vende bosh janë maksimalisht. Sikur të funksionojë çdo lloj gjëje dhe të mbushen vendet në kohën e duhur. U shpall vendi bosh dhe të mbushet. Ne sot jemi në një praktikë të gjatë disa vjeçare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që vendet nuk mbushen në kohën e duhur dhe kjo do të na sjellë, në këtë ngërç që jemi sot, dhe janë 10 magjistratë dhe po bëhet viti që nuk janë emëruar. Vendet janë bosh teorikisht në sistem dhe praktikisht nuk mbushen dot sepse ka probleme nga më të ndryshmet që të dalin, jo një vlerësim, jo një problem ligji, jo një problem tjetër nga më të ndryshmet. Dhe në qoftë se ne i qëndrojmë kësaj situatë teorike që janë kaq vende, shpallim kaq studentë, do të kemi problem në momentin për t'i emëruar këta ose problem page, që do t'i paguajmë kot. Do të vazhdojë historia e mbarsur.

Kështu që duhet të jemi të rezervuar për mendimin tim në përcaktimin e vendeve. Duhet të lëmë një hapësirë, një valvul shkarkimi që ta kemi mundësinë sepse sistemi funksionon dhe me 5 gjyqtarë mangët edhe me 10 gjyqtarë mangët. Nuk është se ne duhet t'i mbushim se s'bën ato vende 10 vende bosh. Do të ndodhemi në një situatë nesër që organika do të ndryshojë. Sot janë këto organika, por pas 2 vjetësh mund të mblidhemi e të themi që Kavaja ka më shumë se ç'duhet, atëherë çfarë do bëjmë me këta gjyqtarë?

Prandaj duhet lënë një hapësirë, ta kemi një valvul shkarkimi. Prandaj për këtë numër unë nuk jam dakord.

Vangjel Kosta: Unë do ta filloja nga kriteret. Mbi ç'kriteret ne duhet të nisim për të përcaktuar numrin? Unë besoj që njëri kriter u diskutua gjerësisht lidhur me nevojën por nga ana tjetër duhen parë edhe kapacitetet që ka Shkolla e Magjistraturës lidhur me mundësitë e studentëve që mund të pranojë. Përvoja e deritanishme ka vërtetuar, le të themi, që ky numër i propozuar është brenda kapaciteteve të shkollës dhe natyrisht me të drejtë diskutimi mbetet që, -ç' do të ndodhë më këtë numër studentësh që do të kthehen nesër gjyqtarë në kohën e parashikuar në studim?

Studimi mua më duket konkret dhe diskutimi i dytë që shtrohet është cilat janë pritshmëritë përtej organizimit konkret që kemi sot, pra me organizimin që ne kemi sot, ne presim që të lirohen vende për 16 gjyqtarë dhe me të drejtë, unë bashkohem me shqetësimin që çfarë do të ndodhë me riorganizimin e gjyqësorit, nëse do të kemi më shumë nevojë për gjyqtarë të kualifikuar apo do të kemi më pak nevojë?

Ne kemi qenë këtu të pranishëm në shumë diskutime, sipas të cilave, ngarkesa e gjyqtarëve në Shqipëri është relativisht e lartë dhe ne po kërkojmë mundësi dhe alternativa për ta ulur këtë ngarkesë sepse kjo po pengon në një farë mënyre realizimin e misionit të drejtësisë. Nga ana tjetër, unë do të shtoja edhe këtë argument, nëse ne do të pranohim një numër më të vogël gjyqtarësh dhe nesër, për shkak të një organizimit, do të kemi nevojë për gjyqtarë më shumë, atëherë do të pranohim nga nevojat të merrim gjyqtarë të pa trajnuar, në kuptimin e trajnimit fillestar, nga jashtë sistemit, dhe në këtë pikëpamje rreziku që do të vinte nga gjyqtarët e jashtë sistemit, sipas vlerësimit tim, do të ishte më i lartë, se sa rreziku që na vjen nga mbingarkesa me gjyqtarë, në kuptimin që buxheti i shtetit do të paguajë përkohësisht disa gjyqtarë për shkak të pamundësisë për t'u punësuar në momentin që ato do të kenë përfunduar studimet.

Në këtë pikëpamje, mbështes propozimin e bërë për numrin e gjyqtarëve sipas studimit. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, faleminderit!

Zoti Saliko!

Hysen Saliko: Faleminderit, Zoti President!

Në fakt, unë jam dakord me studimin që ka bërë Shkolla e Magjistraturës, por nuk do të isha dakord me numrin e propozuar, konkretisht duke e rritur numrin nga një eksperiencë që ka patur vetë shkolla nga 8 deri në 10 magjistratë, këtë vit kërkon 16 magjistratë dhe pikërisht në një vit akademik kur studimi duhet të bëhet për një periudhë trevjeçare, çka do të thotë vazhdimësinë dhe periodicitetin e ndarjes dhe kërkesave që duhet të kërkohen për gjyqtar por edhe për student.

Them se numri 16 i kërkuar, jo vetëm që nuk i përputhet atij studimi, se 15 janë vendet që do të lirohen, por dhe vetë kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës, për këtë periudhë, të paktën këto 10 vjetët e fundit, numri i magjistratëve ka varjuar nga 6 deri maksimalja këto 2-3 vjet ka qenë me 10. Edhe kualiteti i tyre detyrimisht, po ta vësh re, edhe cilësia e magjistratëve, numri i konkurrentëve, më mirë të themi, që marrin pjesë në konkursin e Shkollës së Magjistraturës, sapo vjen dhe po bie, për shkaqe dhe për mos garantimin ose mospëlqimin e vendeve prej tyre sepse gjithë ata kanë mbaruar kohët e fundit, kanë pas rastin që të emërohen nëpër gjykatat e rretheve të largëta.

Dhe në këtë kuadër, unë mendoj se një numër prej 10 kandidatësh, do të ishte më se i mjaftueshëm, dhe njëkohësisht t'i siguronim Shkollës së Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë, të bënin një studim trevjeçar ose pesëvjeçar, për të përcaktuar vazhdimësinë e shkollës. Normalisht mund të kemi një periudhë që për 3-4 vjet mos të ketë mosha që mund të dalin në pension, por përfshi dhe atë që parashikimet apo reformat e mëdha që po parashikohen dhe ligji "Për Gjykatën e Lartë" ka sanksionuar që anëtarët e Gjykatës së Lartë, me mbarimin e mandatit mund të rikthehen në gjykatat e apelit, dhe na vë para pamundësisë objektive për të sistemuar gjyqtarët, pamundësi që neve po e tregojmë. Janë 10 magjistratë të cilët nuk po emërohen, ndërkohë që për 2 muaj mbarojnë edhe 8 të tjerë, edhe bëhen 18. Ata marrin rrogën edhe gjyqtarët e tjerë, punojnë edhe marrin përsipër edhe ngarkesën që do t'u takonte normalisht atyre gjyqtarëve.

Prandaj unë propozoj që numri i magjistratëve të ruaj këtë statu quo-në e këtyre viteve dhe mbas një studimi pesëvjeçar që duhet t'i bëhet kësaj pune, të përcaktohet dhe për vitet në vazhdim numri i saktë i kandidatëve që duhet t'i nënshtrohet konkursit për Shkollën e Magjistraturës. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, faleminderit!

Tjetër?

Po, Zoti Hamitaj!

Tritan Hamitaj: Në strategjinë për sistemin gjyqësor, që është akoma i pa formalizuar, në projekt,t parashikohet që për 2015-2020, në strategji është parashikuar që të gjithë gjyqtarët të jenë me ndihmës ligjorë dhe siç e ka gjykata administrative tani, dhe pjesa tjetër e sistemit të bëhet me ndihmës, dhe në qoftë se do të ndodhi kjo, atëherë do të jemi para faktit që organikat nuk do të jenë këto që janë sepse një pjesë të madhe të punës së gjyqtarit do ta bëjë ndihmësi. Dhe do të kemi një tkurrje të organikës, për sa i përket numrit total të gjyqtarëve. Duhet ta kemi parasysh edhe këtë.

Bujar Nishani: Tjetër?

Po, Zoti Kryetar!

Xhezair Zaganjori: Nga diskutimi duket që ka dy... domethënë ato që përkrahin propozimin që ka bërë Shkolla e Magjistraturës dhe kolegët e tjerë të cilët japin argumentet e tyre për ta kufizuar këtë numër. Personalisht do të mendoja që t'i përgjigjeshim propozimit që na është bërë nga Shkolla e Magjistraturës. Gjyqtarë për frymë popullsie në Shqipëri, neve jemi ndër vendet më të fundit dhe sigurisht që edhe në procesin e integritimit, neve do të na kërkohet që të shtojmë numrin e gjyqtarëve. Ngarkesa është shumë e madhe, e para dhe e dyta, përgjigjet që i japim propozimit, më duket... Domethënë ne nuk duhet të kemi frikë... Sigurisht që ne nuk mund ta paragjykojmë vitin 2019 dhe nuk mendoj që vitin që vjen, po të kemi sivjet 15 apo 16, vitin që vjen nuk do të kemi. Praktika për rreth 20-vjeçare ka treguar që minimalisht, çdo vit, ka 8 deri në 10 vende bosh (hapen 8-10 vende bosh). Ky vit është përjashtimor sepse ka 2 vjet që nuk... domethënë vitin që kaloi, e dimë që të gjithë që nuk kishte konkurrim për shkak të ligjit dhe sivjet, numri i kandidatëve do të jetë shumë më i madh, do të jetë shumë më i madh se vitet e tjera. Dyfish do të jetë. Ja, këtu do të jemi edhe do ta shohim. Prandaj do të thosha që mund të përkrahim propozimin që bëhet.

Bujar Nishani: Po, Zoti Caka!

Dritan Caka: Sepse jemi vendosur pak gabim. Nuk është çështja se është sugjerimi i shkollës kjo 16 gjyqtarë. Ky është i administratës së Këshillit, kështu që duhet ta kemi parasysh edhe këtë gjatë diskutimit.

Flamur Kapllani: Po, faleminderit Zoti President!

Për të mbështetur edhe pak dhe propozimin e Zotit Caka, unë do të isha për një të arsyeshme. Vejmë tek numri 12, që të rruajmë edhe një diferencë për vitin që vjen dhe në vazhdimësi. Ideja është që shkolla të jetë në parametra të barabartë dhe numri mos të shkojë sivjet 16 dhe vitin që vjen me 2 apo 3 studentë.

Ilir Mustafaj: Unë në diskutimin tim nuk nisesha fare, domethënë nuk është problemi i numrit, është 12 apo 13 apo 14. Unë jam më shumë dakord të vendosim 16 saç janë. Por problemi qëndron... domethënë mos të kalojmë në përsëritje. Në kriteret që vendosej numri 16, vendoseshin 7 vendet e gjykatës administrative të shkallës së parë, të cilat realisht i kemi të bllokuara. Domethënë, me formën që ne kemi, me ligjin që kemi, absolutisht që nuk ka për t'u përmbushur asnjë nga ato vende. Bëmë dy herë test, bëmë kërkesa për të bërë testim dhe nuk u realizuan. Kështu që këto 7 vende, në qoftë se nuk ndryshon ligji, absolutisht nuk mund të zihen ndonjëherë, të paktën me ato çka kemi ne deri më sot.

Bujar Nishani: Po, Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Më fal që po e marrë fjalën, por marrë shkas nga qëndrimi që mbajti Zoti Saliko. Po t'i referohemi afatit të përfundimit të Shkollës së tyre, i bie që në vitin 2018 këta të jenë të gatshëm për t'u futur në sistemin e drejtësisë. Të mos harrojmë dhe t'i referohemi ligjit "Për Gjykatën e Lartë". Në momentin aktual, po t'i referohesh ligjit "Për Gjykatën e Lartë", të gjithë personat të cilët kanë qenë gjyqtarë dhe kanë ardhur nga gjykatat në karrierë gjyqësore, i bie që të kthehen automatikisht dhe i bie që vetëm në vitin 2016, 2017 dhe 2018 janë rreth 6 deri në 8 vetë nga Gjykata e Lartë që përfundojnë mandatin e tyre si anëtarë të Gjykatës së Lartë, të cilët priten që të kthehen në sistem dhe i bie që numri total të jetë i plotësuar në momentin... sepse duke qenë se ligji është në fuqi dhe këta të cilët kanë një karrierë gjyqësore, i bie që t'i kthesh përsëri në sistemin e drejtësisë, me karrierë gjyqësore (jo ata që kanë ardhur nga jashtë karrierës) dhe në momentin aktual, i bie që të kthehen dhe po u kthyen, o duhet që t'i japësh rrogën, o duhet patjetër që t'i lesh në listë pritje dhe të emërosh magjistratët dhe mos të emërosh këta që kanë një karrierë jashtëzakonisht shumë të pasur, dhe përveç kësaj, po t'i referohesh statistikave edhe unë prandaj ngul këmbë, në momentin aktual, marrë Gjykatën e Apelit të Tiranës, a është kapaciteti për 30 gjyqtarë, e cila është në organikë

në momentin aktual, sepse i bie që vendet vakante në momentin aktual, atë që tha Zoti Hamitaj, që mund të ketë riorganizime të kësaj natyre për shkak të krijimit të gjykatës administrative dhe të Apelit Administrativ ose shtimit të numrit të tyre, por edhe për shkak të projektligjit të ri që besoj në mbledhjen e ardhshme do të jetë objekt diskutimi që propozimet që ka sjellë Ministria e Drejtësisë, për krijimin e të paktën tre gjykatave të Apelit Administrativ në Shqipëri, unë mendoj që do ketë prapë riorganizim të sistemit dhe në rast se ne shkojmë në këtë studim, unë nuk jam kundër studimit që ka paraqitur dhe aq më tepër që studimin s'e paska paraqitur Shkolla e Magjistraturës, e ka paraqitur administrata e Këshillit, kjo është ideja ime.

Bujar Nishani: Mirë, unë mendoj që këtu ka argumente dhe normalisht të gjitha argumentet janë të pranueshme dhe është vështirë ndoshta tani që ne të gjykojmë apo ta elaborojmë mendimin se si do jetë një reformë në struktura dhe organika, krejt normale. Për shembull është vënë re dhe është i nevojshëm shtimi i kapaciteteve të gjyqtarëve tek gjykatat administrative. Mund të ketë një vlerësim për rishpërndarje të numrit të gjyqtarëve në gjykatat e apelit. Këto janë çështje që mbeten në të ardhmen e diskutimeve.

Tani unë do bëja një propozim konkret që ta racionalizojmë diskutimin dhe vendimmarrjen. Ka një eksperiencë në këtë shkollë, që janë pranuar gjithmonë një numër nga 8 deri në 10 studentë edhe kapacitetet janë të konsoliduara, kështu që.

Xhezair Zagjanori: Këto vitet e fundit, se ka pasur edhe 15, edhe 16.

Bujar Nishani: ..bashkë me prokurorët. Po, tani unë do të bëja propozim që të qëndrojmë tek 10-ja dhe të miratojmë një 10-she për këtë vit dhe pastaj ecim dhe të ruajmë dhe atë eksperiencë që kanë pasur, pastaj ata le të shikojnë dhe shtimin e kapaciteteve të shkollës vetë, se ndoshta shkolla dhe i mirëpret, por duhet që të mendojnë dhe të jenë dhe të përgatitur për kapacitetet, në kuptimin akademik dhe kutikulat dhe me radhë.

Kush është dakord për 10, të miratojmë numrin 10 të magjistratëve për vitin 2014 – 2015, 2015 - 2016, po. 10 veta.

Po se '14 – '15 iku.

Kundra?

S'ka.

Miratohet.

Atëherë me 10 vetë t'i çohet përgjigje Shkollës së Magjistraturës.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 6, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 5 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Bujar Nishani*** (kryetar)
- 2. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 3. Flamur Kapllani*** (anëtar)
- 4. Dritan Caka*** (anëtar)
- 5. Gjini Gjoni*** (anëtar)
- 6. Ilir Mustafaj*** (anëtar)
- 7. Hysen Saliko*** (anëtar)
- 8. Tritan Hamitaj*** (anëtar)
- 9. Astrit Haxhialushi*** (anëtar)

10. Sokol Çomo (anëtar)
11. Albana Shtylla (anëtare)
12. Vangjel Kosta (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Nasip Naço, Zoti Artan Broci.

Shënim 2: Zoti Zaganjori largohet nga salla e mbledhjes në fillim të shqyrtimit të kësaj pike dhe nuk merr më pjesë në mbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.
4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.
5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.
6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.
9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.
10. Agnes Bernhard, Eksperte EURALIUS IV.
11. Erton Karagjozi, Përfaqësues i EURALIUS-it.

RENDI I DITËS:

5. Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Bujar Nishani: Pika 6 e rendit të ditës (sipas procesverbalit i bie pika 5): Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Komisioni, para se të fillojmë, Dritan Caka një informacion të shkurtër.

Dritan Caka: Po, atëherë në emër të komisionit po ju lexoj raportin. Mbështetur në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 227/2, datë 28.03.2008 “Për funksionin drejtues në gjykata”, i ndryshuar, është ngritur Komisioni i Posaçëm për Shqyrtimin e Kandidatëve për Kryetar Gjykatë.

Komisioni, pasi u njoh me të dhënat dhe materialet e depozituara nga kandidatët, si dhe fashikullin e tyre personal, vlerësoi kandidaturat e paraqitura për funksionin drejtues të kryetarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, përkundrejt kritereve të përcaktuara në nenin 16, pika 2, të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 3, të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 227/2, datë 28.03.2008 “Për funksionin drejtues në gjykata”.

Kandidatët të cilët paraqitën kërkesat e tyre për funksionin drejtues të kryetarit në këtë gjykatë janë: Zoti Genci Sinjari dhe Zonja Klodiana Veizi (Mema).

Konkretisht, po ju paraqesim të dhënat sa më poshtë vijon: Zoti Genci Sinjari - aktualisht gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Ka ndjekur dhe përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet 1993-1994, me mesatare note 6.6. Me vendimin nr. 1, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Berat dhe me dekretin nr. 8265, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Është deleguar për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 385, datë 28.10.2013 të KLD-së. Vjetërsia në punë si gjyqtar është 20 vjet. Vlerësimi profesional “Shumë mirë” (3 nga grup kriteret “Shumë mirë” dhe 1 “Mirë”) dhe për vitet 2007-2009 “Shumë mirë” (2 nga grup kriteret “Shumë mirë”). Nuk rezulton që ndaj tij të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore. Gjuhë të huaja: anglisht, italisht, frëngjisht (sipas CV-së që ka paraqitur vetë kandidati.

Zonja Klodiana Veizi (Mema) - aktualisht gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Ka ndjekur dhe përfunduar Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet 1997-2001, në sistemin me shkëputje nga puna, me mesatare notë 9.5. Gjatë viteve 2002-2005 ka ndjekur dhe përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe me

dekretin nr. 4322, datë 17.09.2004 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare dhe është caktuar për kryerjen e stazhit profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me dekret të mëvonshëm të datës 03.10.2005 të Presidentit të Republikës është caktuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe më pas është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës me dekretin nr. 8643, datë 24.07.2014. Vjetërsia në punë si gjyqtare është 10 vjet, duke përfshirë këtu edhe vitin e stazhit profesional. Vlerësimi profesional “Shumë mirë” (3 nga grup kriteret “Shumë mirë”). Gjuhë të huaja: anglisht, italisht (sipas CV-së). Nuk rezulton që ndaj saj të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me shkresën nr. 420/1 prot., datë 09.02.2015, në përgjigje të shkresës nr. 371 prot., datë 30.01.2015 të KLD-së mbi kërkesën për informacion drejtuar këtij institucioni, për kandidatët konkurrues në funksionin drejtues, shprehet se për subjektet e kërkuara Genci Sinjari dhe Klodiana Veizi ka përfunduar kontrolli i plotë dhe deklaratat e tyre kanë rezultuar pa probleme dhe në përputhje me kërkesat e ligjit”.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë i Drejtësisë nëpërmjet shkresës së tij nr. 190 prot., datë 17.01.2014 ka kërkuar pranë Dhomës së Avokatisë Durrës, opinion lidhur me kandidatin për kryetar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Kjo dhomë avokatie, me shkresën nr. 24/1 prot., datë 24.01.2014 drejtuar KLD-së, ka shprehur opinion pozitiv, duke e quajtur gjyqtarin Genci Sinjari të përshtatshëm për t’u emëruar kryetar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Faleminderit!

Bujar Nishani: Faleminderit!

Ka ndonjë ..?

Urdhëro, Zoti Kosta!

Vangjel Kosta: Faleminderit! Unë kam qenë pjesë e komisionit por kam mbajtur një qëndrim disi ndryshe nga shumica dhe e kam pasqyruar edhe mendimin tim. Në fakt goftë për këtë rast edhe për raste të tjera, në vijim dhe të diskutimeve që kam bërë dhe në mbledhjen e mëparshme, të paktën jam munduar të mbaj një qëndrim konsekuent lidhur me faktin që Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të ndërtojë disa standarde që të harmonizojnë më mirë objektivitetin në vendimmarrje me qëndrimin subjektiv të çdo anëtari. Në këtë pikëpamje unë besoj që kriteri, le të themi, elementi më ndikues në objektivitet do të ishte

pikërisht vlerësimi i gjyqtarëve që aplikojnë për karrierë, qoftë në gjykata të karrierës, qoftë edhe për të aspiruar për t'u bërë kryetarë gjykatash. Në këtë pikëpamje unë kam vendosur që të vë standarde, i përcaktuar edhe nga ligji, sipas të cilit ne nuk mund të marrim një vendim objektiv karriere nëse gjyqtarët nuk do kenë të paktën secili prej tyre nga dy vlerësime, minimalisht.

Në këtë këndvështrim, meqenëse disa nga kandidatët që kanë aplikuar, nuk e plotësojnë këtë kriter, ne do t'i përjashtonim ato padrejtësisht nga konkurrimi dhe në këtë konsideratë kam kërkuar që procesi të pezullohet e t'u jepet mundësia të gjithë kandidatëve nëpërmjet procedurës së vlerësimit të përshpejtuar, të plotësojnë kriterin minimal të pasjes së dy vlerësimeve dhe pas kësaj ne të vazhdojmë me procedurën e konkurrimit për kryetarët e gjykatave administrative. Jo vetëm për Durrësin, këtë shpjegim e jap edhe për raste të tjera të cilat i kemi dhe sot në rendin e ditës. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po. Faleminderit!

Tjetër diskutim?

Mirë, atëherë të ftohen kandidatët për t'u dëgjuar. Të vinë sipas... Genci Sinjari.

Po, po, përpara. Prit një minutë. Po, po, urdhëroni!

Albana Shtylla: Më falni, proceduralisht, meqenëse u bë një propozim nga njëri prej anëtarëve të komisionit i cili ka hedhur një ide që të ketë një shtyrje të procesit...

Bujar Nishani: Po, por është pakicë në komision. Ka raportin e komisionit, të vijojmë.

Albana Shtylla: Pavarësisht se është në pakicë. Me e hedh këtu në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe për të patur një vendimmarrje, nëse mundet.

Bujar Nishani: Ka një raport të komisionit dhe ne ecim mbi bazën e raportit të komisionit.

Hysen Saliko: ...edhe shqetësimin e anëtarit Kosta, edhe shqetësimin e Albanës, por tashmë KLD-ja e ka kapërcyer këtë situatë dhe qoftë në emërimet në gjykatën e apelit apo qoftë në emërimet për kryetarë, ka mbajtur një standard dhe ne nuk mundët, shumica të ndryshonte qëndrimin e tij dhe tani gati kur jemi në fund të emërimeve të kryetarëve të gjykatave të ndryshonte rregullat e lojës dhe këta tre-katër apo pesë kryetarë gjykatash që kanë mbetur të kërkohet që të bëhet vlerësimi dy herë, ndërsa për ata që kemi emëruar në

gjykatën e apelit dhe për kryetarë gjykatash gjatë vitit që kaloi u emëruan, të kishim një vlerësim vetëm një herë. Kështu që, raporti është i plotë. Tek ata gjyqtarë që ka mundur Këshilli i Lartë i Drejtësisë t'i bëjë dy vlerësime, i kanë. Fakti që ne kemi përjashtuar ata gjyqtarë që nuk plotësojnë kushtet, por dhe nuk ka kandidatë të tjerë që mund të kërkojnë, dhe po të kishin kërkuar detyrimisht dhe të kishte ndonjëri ndonjë sugjerim, se: -Unë në këto dy vlerësime të ardhshme do ta kem vlerësimin "Shumë mirë" dhe në vlerësimin që më është bërë e kam patur është "Mirë", ne detyrimisht mund ta kishim marrë në shqyrtim. Në këto kushte, unë vlerësoj se raporti është i plotë dhe ne duhet të vazhdojmë me procedurën për zgjedhjen e kryetarit.

Bujar Nishani: Po, urdhëro!

Albana Shtylla: Më fal edhe një herë që po e kërkoj fjalën.

Këtu nuk bëhet fjalë për një praktikë apo një procedurë të vendosur më parë nga KLD-ja, por bëhet fjalë për një parashikim ligjor dhe konkretisht nenin 16, ku bëhet fjalë për kushtet dhe emërimin e kryetarit të gjykatës, ku thuhet që: "Kryetari i gjykatës të jetë vlerësuar "Shumë mirë" nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dy herët e fundit". Pra, normalisht po bëhet fjalë për zbatimin e një përcaktimi ligjor. Nëse shumica në komisionin e ngritur nga KLD ka vlerësuar në kundërshtim me nenin 16, okej, vazhdoni. Por ideja ime ishte që, meqenëse ka patur një qëndrim pakice të referuar në një dispozitë ligjore, të provohesh edhe për t'u diskutuar në KLD nëse do të vijojmë sipas parashikimit ligjor apo sipas raportit të prodhuar nga shumica e komisionit. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, faleminderit!

Të njoftohet zotëria, Zoti Genci Sinjari.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari Genci Sinjari.)

(Zoti Zaganjori largohet nga salla e mbledhjes.)

Përshëndetje! Mirëserdhe Zoti gjyqtar! Ju kemi thirrur për t'ju dëgjuar, pasi po shqyrtojmë procedurën për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative. Një nga kandidatët jeni ju që keni paraqitur kandidaturën. Komisioni përkatës i ngritur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka gjetur në përputhje me ligjin dhe kriteret kandidimin tuaj.

Do të procedojmë në këtë mënyrë: Keni në dispozicion 10 minuta kohë për të paraqitur në mënyrë të përmbledhur platformën dhe vizionin tuaj për drejtimin e gjykatës

në fjalë, pastaj anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë do të kenë hapësirën dhe kohën e tyre për të drejtuar pyetje nëse do të kenë.

Urdhëro! Keni fjalën për ta paraqitur në mënyrë të përmbledhur atë platformë, pasi ne jemi njohur në tërësi me të.

Genci Sinjari: Faleminderit!

Prej datës 4 nëntor 2013 filloi funksionimi i gjykatave administrative në Republikën e Shqipërisë, një ditë kjo e pritur prej shumë vitesh nga publiku dhe subjektet e interesuara. Ky dokument i përmbledhur synon të manifestojë qoftë edhe një strategji të pjesshme menaxhimi. Mund të punoj për të promovuar një qeverisje efektive të gjyqësorit duke përcaktuar një vizion gjithëpërfshirës, çka përbën një sistem efektiv dhe pastaj të bind edhe publikun dhe aktorët e tjerë se mbajtja e një vizioni të tillë është i zbatueshëm vetëm nëse gjykatat kanë pavarësi të dukshme për të menaxhuar çështjet e tyre.

Lidershipi është energjia mbrapa sistemit të gjykatave dhe arritjeve të tyre, ndërsa menaxhimi është organizimi dhe harmonizimi i resurseve për të arritur suksesin. Katër shtyllat e menaxhimit janë: planifikimi, organizimi, udhëzimi dhe monitorimi. Lidershipi dhe menaxhimi janë sisteme të domosdoshme të veprimit. Gjykatat kanë nevojë për njerëz që janë kompetent, profesional, etik dhe të zotuar.

Menaxhimi i resurseve njerëzore mundëson performancë më të mirë dhe kontribuon në efikasitetin e gjykatës.

Në lidhje me menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe të regjistrave: Menaxhimi i çështjeve që ndonjëherë i referohet si “zemra e administrimit të gjykatës” është një proces me të cilin gjykatat i kryejnë funksionet e para të lëvizjes së çështjeve dhe parashtrimit të tyre deri në mbylljen, duke siguruar se palët e përfshira kalojnë nëpër një proces që kryhet në kohën e duhur dhe me mbështetje të barabartë.

Menaxhimi i regjistrave është i domosdoshëm për të siguruar saktësi, disponueshmëri të të gjithë regjistrave, si dhe ruajtje dhe deponim të duhur të regjistrave të vjetër.

Në lidhje me ngarkesën dhe çështjet e prapambetura, si dhe vonesat, mendimi është: Shkurtimi i vonesave bazohet në teknikat për të identifikuar shkaqet për vonesa gjatë procedimit të çështjeve të tanishme dhe atyre që do të vijnë në të ardhmen, duke

parashikuar edhe pengesat e mundshme. Zvogëlimi i ngarkesave me çështje të prapambetura zhvillon strategji për të adresuar ngarkesat e tanishme dhe të parandalojë grumbullimin e mëtejshëm të çështjeve të prapambetura pa ndërhyrë në procesin në kohë të duhur të ngarkesave.

Në lidhje me menaxhimin financiar dhe buxhetor, fakti sesi gjykatat i gjejnë resurset, i marrin dhe i menaxhojnë, ndikon në veprimet e secilës gjykatë dhe përcakton sesi gjykatat e përmbushin mandatin e tyre dhe i shërbejnë publikut. Kryesisht gjyqësori varet nga dega legislative për buxhetin dhe rritjen e pagave, ndërsa në fusha të tjera, si siguria në gjykata, dega e gjyqësorit rregullisht bashkëpunon ngushtë me degën ekzekutive. Duke pasur parasysh shkallën e lartë të ndërvarësisë midis këtyre degëve, është kritike që çdo degë të kuptojë dhe të respektojë rolin e të tjerëve.

Gjyqësori duhet të punojë në mënyrë konstruktive me degët e tjera, në rastin tonë në nivelin vendor, por të mos hezitojë për të folur me siguri dhe në mënyrë të drejtë për ndërhyrje të tepruara ekzekutive apo legislative në punët e gjykatës, kur kjo dëmton qëllimet kryesore. Ky është një akt balancues, i vështirë dhe sensitiv, i atillë që aktorët në sistemin e qeverisjes mund të arrijnë më mirë përmes zhvillimit të një bashkëpunimi kushtetues mbi bazën e parimeve kryesore të përgjegjshmërisë juridike dhe të qeverisjes.

Në lidhje me qasjen për publikun dhe për transparencën, është e qartë se informacioni në komunitet dhe në publik në përgjithësi e përmirësojnë performancën e gjykatës dhe e rrisin besimin e publikut në gjyqësor. Qasja në drejtësi përfshin vetëdijesimin e publikut mbi shërbimet e gjykatës, qasjen strukturale dhe mënyrat sesi pjesëmarrësit akomodohen me vështirësitë, me gjuhën, kulturën dhe lëvizshmërinë.

Herë pas here sistemi gjyqësor përballet me kritika, kryesisht në formën e sulmit ndaj vendimeve të veçanta të gjykimeve individuale dhe të gjykatave. Gjykime të tilla mund të krijojnë një klimë të tillë në të cilën degët e tjera të qeverisjes ndërhyjnë në aftësinë e gjyqësorit për drejtimin e punëve, duke ndërhyrë në fonde, në praktikat, në procedurat mikro-drejtuese. Ndonjëherë, në të vërtetë është veprimi apo mosveprimi i gjyqësorit që shkakton këto ndërhyrje. Kjo, mund të ndodhë kur gjykata mund të dështojë në performacën e detyrave të saj në një mënyrë efektive, por kjo mund të ndodhë gjithashtu kur trupa gjyqësore dështon t'u artikulojë degëve të tjera të qeverisjes sesi

dëmtimi i aftësisë së gjyqësorit për t'u qeverisur minon kapacitetin e tij për të siguruar cilësinë më të lartë të shërbimit për publikun.

Në lidhje me strategjitë praktike - Përveç nevojës për të artikuluar dhe komunikuar një vizion të qartë të rolit të tij, duhet të ndërmerren një sërë hapash praktikë, të përditshëm, për të komunikuar dhe promovuar objektet e vetë institucionit. Një element kryesor në këtë këndvështrim është udhëheqja koherente. Gjyqësori duhet të flasë me një zë. Shumë shpesh degët e tjera prezantohen me degët e gjyqësorit, që flet me zëra të shumtë dhe shumë herë kontradiktorë. Organet kushtetues dhe ligjorë të pushtetit të tretë duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të riskuar sistemin administrativ, përfshirë dhe anën buxhetore për promovim të aftësive të degës të gjyqësorit për të adresuar dhe folur mbi çështje të sistemit të gjerë nga perspektiva e gjyqësorit e parë si një e tërë.

Në lidhje me detyrat specifike të kryetarit të gjykatës, kryetari duhet të marrë një rol të dukshëm udhëheqës mbi çështjet administrative të punës në gjykatë, përmirësimin, sigurimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit me kancelarin dhe me publikun, të ndërmarrë një rol aktiv në procesin legjislativ vjetor, duke përfshirë dorëzimin e propozimeve për ndryshme legjislative. Pushteti legjislativ ka fjalën e fundit në politikë. Gjykata ka një rol legjitim për sigurimin e inuteve në lidhje me ndikimin e legjislacionit mbi veprimet e gjykatës.

Gjithashtu kryetari duhet të marrë pjesë aktive në komisione, konferenca për të manifestuar, studiuar, diskutuar nevojat dhe problemet e gjykatave dhe çështje të rëndësishme të përbashkëta, të zhvillojë komunikime, zyrën e marrëdhënieve me publikun, përmirësimin e punës së saj, që punon në bashkëpunim me publikun dhe aktivisht me median dhe qytetarët; të shprehë qartë performancën e degës së gjyqësorit dhe rolit të tij; të sigurojë që ai vetë dhe grupe të gjykatësve të takohen me zyrtarë publik dhe të flasin në forume dhe takime për të përmirësuar kuptimin mbi funksionet e gjyqësorit, nevojat dhe problemet e përbashkëta; të shfrytëzojë burimet e brendshme, donacionet e mundshme; të rrisë performancën publike dhe të ndikojë për edukimin juridik të popullsisë lokale nëpërmjet kimit të fletëpalosjeve informuese, zhvillimi i një faqe interneti të gjykatës, gjë që mbetet prioritet i realizueshëm në vitet e para të punës; të paraqesë në fund të çdo viti dhe sa herë që kërkohet një raport të plotë informativ për

realizimin e punës në gjykatë, që faktikisht bëhet çdo muaj dhe i raportohet KLD-së një raport i tillë.

Si konkluzion, dega e gjyqësorit do jetë gjithmonë subjekt i kritikave për veprimet e tij. Kjo është e paevitueshme në një shoqëri të lirë dhe të hapur. Sfida e gjykatave është të ndalojë një kritik të tillë. Gjyqësori duhet të artikulojë një vizion të qartë, të demonstrojë se aftësia e gjykatës për të plotësuar shpresat e publikut varet nga liria për të kontrolluar dhe drejtuar punët. Gjyqësori duhet të marrë çdo mundësi për të komunikuar këtë mesazh me partnerët në qeveri dhe në Parlament. Kjo do të sigurojë që degët e tjera të çmojnë se qeverisja e gjyqësorit nuk është një fund në vetvete, por një mjet kritik i sigurisë që nivelet e gjyqësorit janë në gjendje të sigurojnë cilësinë maksimale të shërbimit për qytetarët.

Për sa më sipër ju siguroj se do përpiqen të drejtojë me profesionalizëm. Ju faleminderit!

Bujar Nishani: Ju faleminderit dhe juve !

Pyetje?

Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Faleminderit, Zoti President!

Zoti Sinjari, ju keni një periudhë kohore që keni marrë drejtimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative të Durrësit. Deri në momentin aktual, cilët kanë qenë, mendoni juve, anët pozitive dhe anët negative, meqenëse nuk keni qenë drejtues asnjëherë të asnjë gjykate deri në momentin aktual, cilat shihni si pika të forta dhe të dobëta në lidhje me këtë drejtim të kësaj gjykate? Pyetja e parë.

Genci Sinjari: Në lidhje me pikat e dobëta, sigurisht që e thatë dhe ju, që mungesa e përvojës ndikoi, pasi nuk kam qenë në pozita drejtuese më parë, megjithatë pikat e mia të forta, mendoj që janë vjetërsia në profesion, marrëdhëniet më koleget edhe me publikun, të cilat i kisha të qarta para se të vija në këtë detyrë. Pikë tjetër e dobët ose e fortë mund të themi, se varet si e komenton, ishte se gjykata administrative ishte një gjykatë e re, me një strukturë që u parashikua me një volum më të vogël pune edhe erdhi gjatë vitit edhe performanca edhe plotësimi me punonjës personeli edhe mënyrat e drejtimit erdhën dhe u përmirësuan mendoj.

Gjin Gjoni: Pyetja e dytë ka të bëjë: Në çfarë nivelesh ka qenë bashkëpunimi midis ju si drejtues i gjykatës së shkallës së parë me Ministrin e Drejtësisë për sa i përket problemit të infrastrukturës, dhe kam parasysh godinën, stafit administrativ dhe këshilltarëve deri në momentin aktual?

Genci Sinjari: Në lidhje me godinën mund të them që në fillim gjykata hasi shumë vështirësi, pasi u sistemua vetëm në pesë ambiente pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës, e cila edhe vetë nuk ishte shumë mirë me ambiente. Në muajin qershor gjykata u sistemua në ambientet ku është sot, pranë zyrave të përmbartimit Durrës, domethënë në ambientet e autoritetit portual Durrës. Kjo periudhë zgjati gati 6 muaj, me kërkesa të vazhdueshme. Kam kërkuar gjithmonë transferimin në ambiente më të përshtatshme. U realizua. Mund të them që bashkëpunimi me ministrinë ka qenë normal. Vetë situata nuk ka qenë normale, kurse bashkëpunimi për mendimin tim ka qenë shumë normal.

Gjin Gjoni: Në lidhje me këshilltarët, aktualisht janë përzgjedhur?

Genci Sinjari: Në lidhje me këshilltarët, jemi në fazën kur janë zgjedhur 2 kandidatë, të cilët do i nënshtrohen provimit në një fazë tjetër.

Gjin Gjoni: Faleminderit! Nuk kam pyetje të tjera.

Bujar Nishani: Tjetër pyetje?

Nuk ka.

Mirë atëherë, duke vlerësuar prezencën tuaj dhe paraqitjen zoti gjyqtar, me ju mbaruam. Mund të shkoni!

Genci Sinjari: Faleminderit!

(Gjyqtari Genci Sinjari largohet nga salla e mbledhjes. Ndërkohë hyn në sallën e mbledhjes gjyqtarja Klodiana Veizi.)

Bujar Nishani: Zonja gjyqtare, mirë se ke ardhur!

Ju kemi thirrur për shkak të shqyrtimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë të procesit të emërimit të kryetarit të Gjykatës Administrative të Durrësit. Ju jeni një nga kandidaturat e paraqitura për të këtë post. Komisioni shqyrtues e ka gjetur në përputhje me ligjin dhe kriteret e përcaktuara kandidimin tuaj. Do të procedojmë në këtë mënyrë: Keni 10 minuta kohë për të paraqitur në mënyrë të përmbledhur platformën tuaj, vizionin

tuaj për drejtimin e gjykatës, pastaj nëse ka paqartësi dhe kërkesa për njohuri të detajeve të mëtejshme, anëtarët Këshillit do t'ju drejtojnë pyetje. Urdhëro, keni fjalën.

Klodiana Veizi: Faleminderit i nderuar President!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mendoj se si fillim do ishte e nevojshme një prezantim i shkurtër lidhur me atë se kush jam unë.

Quhem Klodiana Veizi Mema. Kam mbaruar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Më pas kam fituar të drejtën nëpërmjet konkursit për në Shkollën e Magjistraturës. Vitin tim të stazhit profesional e ka kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe më pas jam emëruar me dekret të Presidentit, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje, ku kam patur fatin të punoj në një trupë gjyqësore shumë profesioniste. Më pas kam marrë pjesë në testimin e zhvilluar për Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë. Pavarësisht rezultatit tim pozitiv, nuk arrita të kem besimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të qenë pjesë e trupës gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, dhe me një vendimmarrje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë unë ushtroj funksionet në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Durrës.

Duke marrë vetëm 10 minuta nga koha juaj në mënyrë të përmbledhur unë do t'ju parashtroj atë se si e mendoj, se si e konceptoj unë rolin e kryetarit të gjykatës.

Gjatë 10 viteve të para të karrierës sime si gjyqtare, gjithmonë e kam parë dhe konceptuar këtë rol si një të parë ndërmjet të barabartëve. Është një shprehje që ne ndeshim randomë, por tek e fundit ky është roli apo pozicioni që është i mirë përcaktuar në dispozitat e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushteti gjyqësor”, neni 18 i tij, i cili i ka përcaktuar kompetencat e kryetarit të gjykatës, të cilat më tepër se sa të drejta, mbartin në vete detyrime dhe duke qenë i tillë, kryetari i gjykatës, përveçse gjyqtar si të tjerët dhe për shkak të të qenurit gjyqtar, është i lidhur me atë kontratën, le të themi, të shërbimit që ne lidhim me publikun për t'i shërbyer atij dhe për të dhënë drejtësinë, ai njëkohësisht është i lidhur dhe me një marrëdhënie tjetër shumë delikate dhe shumë të rëndësishme, sikurse është ajo e përfaqësimit të trupës gjyqësore të cilën ai e drejton dhe kjo marrëdhënie e dytë natyrisht mbart detyrimin e kryetarit të gjykatës që të përfaqësojë denjësisht në publik dhe përpara aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë gjyqtarët, për të transmetuar problemet, vështirësitë në punën e tyre dhe normalisht kontribuar në zgjidhjen e këtyre problemeve me qëllim mbarëvajtjen dhe administrimin e punëve në

drejtësi. Tashmë të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se një nga sfidat e sistemit gjyqësor në drejtësi është ofrimi i një shërbimi sa më cilësor tek publiku, dhe këto objektiva marrin rëndësinë e tyre në rastin e kryetarit të gjykatës, i cili është një figurë që ligji e vendos në drejtimin e gjykatës dhe në administrimin e drejtësisë dhe mendoj që një rol i tillë bëhet pak më i vështirë mendoj për gjykatat administrative, këto janë gjykata të krijuara rishtazi, dhe mendoj se ndeshen, me aq kohë sa unë shërbej në gjykatën time, me probleme të tilla si: mjedise modeste të ofrimit të shërbimit ndaj publikut, një numër i madh çështjesh të regjistruar për gjykim, një kuadër i ri ligjor lidhur me procedurat në gjykim, afate të shpejta gjykimi, një staf i pa trajnuar mjaftueshëm, mungesë ndihmësash ligjorë, trajnime minimale të gjyqtarëve që ndeshen me një shumëllojshmëri konfliktesh shtet-individ, dhe një praktikë ende e pa konsoliduar lidhur ende akoma me çështje të kompetencës lëndore dhe jo me pak rëndësi për mendimin tim është edhe shpërblimi apo paga e gjyqtarëve të gjykatave administrative jo në përputhje me vëllimin e punës së përballuar.

Objektivat e mia duke i grupuar në objektiva në raport me gjykatën dhe trupën gjyqësore me të drejtën e publikut për t'u informuar dhe garantimin e një procesi të rregullt ligjor, unë do t'i relatoja përmbledhtazi në këtë mënyrë: Për sa i përket kompetencave të kryetarit të gjykatës në funksion të krijimit të një ambienti sa më të mirë të mundshëm për gjyqtarët e gjykatës. Gjykata ku unë ushtroj funksionin aktualisht është e përbërë nga 4 gjyqtarë, janë 4 gjyqtarë që ushtrojnë funksionin e tyre në një godinë që i përket autoritetit portual Durrës, është kati i fundit i një ndërtese, ku nga njëra anë është administrata dhe gjyqtarët e akomoduar në zyrat e anës së djathtë të korridorit, përballë tyre qëndrojnë zyrat e shërbimit përmbartimor Durrës. Kohët e fundit një nga këto zyrat e shërbimit përmbartimor është përshtatur për sallë gjykimi por duke mos qenë kjo e fundit e përshtatshme për t'u përdorur si e tillë, përshtatshmëri e cila vjen si për shkak të mjeteve të pamjaftueshme ashtu edhe për shkak se një pjesë e mirë e gjykimeve zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve dhe cenohet në këtë mënyrë publiciteti i seancës. Për të bërë të mundur përshtatshmërinë e zyrës ekzistuese dhe shtimin e një zyre tjetër, mendoj se me rëndësi duhet të jenë kontaktet me Ministrinë e Drejtësisë, në mënyrë që kjo e fundit të bëjë të mundur kalimin e një tjetër zyre në administrim të gjykatës. Dukja dhe pamja e jashtme e godinës, e sallave, e zyrave të gjyqtarëve apo të administratës, ka

impaktin e parë tek publiku lidhur me pritshmëritë e tyre për mënyrën se si ata do të marrin drejtësinë e pretenduar dhe në këtë drejtim mendoj se ka shumë për t'u bërë.

Instalimi i sistemit elektronik në shpërndarjen e çështjeve gjyqësore, tashmë ky është një objektiv i realizuar megjithatë unë nuk e vlerësoj të tepërt të përmend anët pozitive të shpërndarjes elektronike të çështjeve, duke respektuar regjistrimin elektronik të çështjeve sipas radhës së paraqitjes të tyre në gjykatë, barazinë e shpërndarjes së çështjeve me short nëpërmjet gjyqtarëve, pamundësinë e ndërhyrjes në këtë shpërndarje nga ana e tyre që e administrojnë shortin elektronik dhe të gjitha këto duhet të jenë normalisht qëllime të punës time pasi unë i mëshoj shumë faktit se procesi i rregullt gjyqësor fillon në momentin e hedhjes së çështjes në short.

Përpunimi i formacioneve statistikore pse jo dhe ngritja e një shërbimi statistikor duhet të ishte një objektiv i realizueshëm që do të shërbente për përlllogaritjen periodike të të dhënave lidhur me çështjet për secilin gjyqtar dhe do të ishte i nevojshëm duke patur parasysh numrin e madh të çështjeve që regjistrohen për gjykim si dhe bërjen transparente të këtyre aspekteve përpara medias, në mënyrë që këto të fundit të marrin dijëni lidhur me volumin e punës që përballojnë gjyqtarët në gjykatat administrative.

Tek objektivi i rëndësishëm, ai i ofrimit të shërbimit cilësor tek publiku, mendoj se me rëndësi është marrja e informacionit nga publiku në mënyrë elektronike, kjo në mënyrë që palët të informohen lidhur me procesin gjyqësor dhe të evitohen kontakte të panevojshme të tyre me administratën duke u lehtësuar dhe përqendruar kjo e fundit tek funksioni dhe detyrat me rëndësi që duhet të përmbushë.

Duke u rikthyer tek marrëdhënia delikate kryetar gjykate dhe trup gjyqësore, referuar gjithmonë kompetencave që neni 18 i ligjit përcakton për kryetarin e gjykatës, mendoj që në këtë aspekt me rëndësi, roli i tij për marrjen e masave përkatëse lidhur me rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore, në aspektin e organizimit të diskutimit për çështje të përgjithshme të natyrës juridike, njohjen e praktikës së vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, apo dhe të vendimeve që kontrollojnë në hierarki vendimet tona, qoftë edhe për rezultatet që dalin nga aktet e kontroleve tematike që organizon Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo Ministria e Drejtësisë. Në këtë aspekt merr rëndësi edhe mbikëqyrja nga ana e kryetarit të gjykatës të detyrimit që kanë gjyqtarët për të marrë pjesë në trajnimin e detyruar të organizuar nga Shkolla e

Magjistraturës dhe mendoj se këto trajnime bëhen akoma më të rëndësishme në rastin e gjyqtarëve të gjykatave administrative për shkak të larmisë së çështjeve dhe konflikteve që shtrohen për zgjidhje por edhe numri tepër modest të trajnimeve që janë organizuar deri tani në lidhje me mosmarrëveshjet e kësaj fushe. Kuptohet që do të ketë një bashkëpunim të përditësuar me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kjo për të bërë të zbatueshme kompetencat e mia të parashikuara në nenin 18 të Ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, në lidhje me informimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për sa i përket respektimit të etikës dhe solemnitetit të gjykimeve nga ana e trupës gjyqësore.

Një moment delikat që mendoj që lidhet me funksionet e kryetarit të gjykatës është ai i vlerësimit të gjyqtarëve, ku si qëllim i vetëm i imi është përshkrimi i veprimtarisë së gjyqtarit, bërja e një vlerësimi në lidhje me disiplinën në punë, solemnitetin në gjykim, duke eliminuar në maksimum subjektivizmin dhe duke patur si parim kryesor zbatimin e meritës në mes të trupës gjyqësore.

Marrëdhëniet me administratën gjyqësore - Administrata gjyqësore tashmë edhe në të gjithë praktikën e Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar me një rol të rëndësishëm për sa i përket procesit të dhënies së drejtësisë duke qenë se i shërben gjyqtarit edhe në kryerjen e funksioneve të tij në këtë drejtim, normalisht merr rëndësi zhvillimi i më tej të njohurive për personelin, ndërgjegjësimi i tyre në lidhje me misionin dhe funksionin që kanë, duke patur parasysh edhe stafin e gjykatës, ku unë gjykoj që janë relativisht në një moshë të re dhe vuajnë mendoj nga kjo ideja dhe rëndësia e misionit dhe funksionit që ata kryejnë dhe një administratë e përgjegjshme mendoj se mund të jetë e suksesshme duke u mbikëqyrur vazhdimisht disiplina e saj në punë dhe duke qenë ajo e tillë edhe shërbimi që ofron do jetë më cilësor.

Një rëndësi për gjykatat administrative merr çështja e përzgjedhjes së ndihmësve ligjorë, çështje për të cilën është e nevojshme bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe kuptohet që çështja e përzgjedhjes së ndihmësve ligjorë do të bëhet mbi bazën e kriterëve ligjorë të meritës, pasi unë e vlerësoj si një moment me rëndësi për të evituar ngarkesën dhe për të qenë ndihmë në procesin e dhënies së drejtësisë.

E fundit, dhe jo më pak e rëndësishme është transparenca. Transparenca në punët e drejtësisë. Drejtësia duhet të jepet mendoj jo vetëm thjesht në bazë të bindjes që krijon trupi gjykues por duhet të shihet dhe të vlerësohet nga të gjithë se kjo drejtësi që jepet

është në thelb e paanshme. Në këtë aspekt unë mendoj se merr rëndësi bërja e përpjekjeve me Ministrinë e Drejtësisë për instalimin e sistemit audio në sallën e gjyqimit të gjykatës administrative. Një gjë e tillë mendoj se duhet të jetë e nevojshme për të bërë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të cilat bëjnë të nevojshme mbajtjen e procesverbaleve me anë të regjistrimit në këtë sistem, por njëkohësisht ai do të sjellë edhe lehtësi të konsiderueshme në dokumentimin e veprimeve përgatitore edhe të seancave gjyqësore.

Në fund unë dua të vë theksin që këto objektiva të cituara më sipër janë disa objektiva që unë i kam përgatitur brenda një afati të shkurtër. Ato janë modeste sepse është praktika ajo që nxjerr në pah problemet, ajo që nxjerr në pah çështjet që i shtrohen për zgjidhje një drejtuesi apo një menaxhuesi. Objektivat e mësipërme unë gjithmonë i shikoj të lidhura me pritshmërinë e publikut dhe të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë në momentin që është miratuar ligji nr. 49/12 “Për gjykatat administrative”, si dhe të krijimit të këtyre gjykatave, pritshmëri të cilat kanë të bëjnë me rritje të cilësisë për sa i përket gjyqimit të mosmarrëveshjeve administrative apo për procese më pak të zvarritura dhe unë mendoj se në këtë drejtim ka sukses. Megjithatë unë nuk mund të lë pa përmendur dhe një aspekt shumë pozitiv të vendimmarrjes së gjykatave administrative, i cili ka të bëjë me faktin se në këto konflikte që ne i gjykojmë gjithmonë përballë individit, qëndron organi i administratës publike dhe në ato momente kur gjykata gjen në veprimtarinë e organit të administratës shkelje të ligjit apo të të drejtave themelore të njeriut, mendoj se ky vendim i gjykatës do të shërbejë për ta bërë më ndërgjegjshme dhe më të përgjegjshme veprimtarinë e administratës publike dhe një veprimtari e tillë do të prodhojë më pak shkelje, më pak cenime të të drejtave dhe lirive të shtetasve dhe produkti i të gjithë kësaj pastaj do të jetë një shoqëri më pak konfliktuale, më sociale, më e mirë, më e paqtë, më e përparuar; një shoqëri ku respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut që mendoj se është dhe sfida e shoqërive më të përparuara.

Kuptohet që për të bërë të mundshme dhe të realizueshme sa më sipër, unë mendoj që kryetarit të gjykatës i nevojitet punë, përkushtim dhe të qenurit imun ndaj çdo lloj ndikimi apo ndërhyrje të padrejtë në punët e drejtësisë. Ju faleminderit që më dëgjuat.

Bujar Nishani: Po edhe unë ju falenderoj që prezantuat atë që ju parashikoni si mundësi dhe si vizion në platformën tuaj.

Pyetje nga anëtarët?

Zoti Kosta!

Vangjel Kosta: Unë e kuptoj nga mënyra e shpjegimit që ndonëse nuk artikullohet në mënyrë të drejtpërdrejt, besimi i publikut për gjykatën tuaj është pjesë e shqetësimit të programit tënd si drejtuese e mundshme e gjykatës. Ndonjë element më konkret mendon se do të ndikonte, pra çfarë mendimi mund të ketë kryetari i gjykatës në veprimtarinë e tij që gjykata të ketë nivel më të lartë besueshmërie para publikut, i cili i adresohet asaj?

Klodiana Veizi: Çfarë gjërash konkrete mund të bëjë kryetari i gjykatës, përveç atyre që I thashë përmbledhtazi?

Mendoj se kryetari i gjykatës, e para njëherë, në dukjen e vetë edhe në punën e vetë, në mënyrën se si e jep drejtësinë, duhet të përbëjë një garanci mendoj për të tretët, me sjelljen e tij, etikën, korrektësinë, ndershmërinë dhe paanësinë në procesin e dhënies së drejtësisë. Unë mendoj që transparenca është ajo që mund të jetë çelësi dhe sukcesi i një kryetari gjykate, duke bërë të mundur, duke filluar që nga momenti që organizohet shorti elektronik dhe regjistrimi i çështjeve për t'u hedhur në short, duke filluar me bërjen ose regjistrimin në sistemin audio të seancave gjyqësore, duke respektuar barazinë e ndarjes së çështjeve dhe nuk e di pastaj çfarë mund të dalë tjetër gjatë rrugës por që do ta mendoj.

Bujar Nishani: Tjetër?

Mirë, unë kam dy apo tre pyetje Zonja Klodiana.

Së pari, në lidhje me funksionimin e shortit për shpërndarjen e çështjeve, keni ndonjë rezervë, keni ndonjë merak, funksionon në mënyrë të plotë, cili është gjykimi juaj deri tani? E para pyetje.

Pyetja e dytë, në lidhje me ambientet e punës në gjykatën tuaj, shikoni që ka hapësirë që të angazhohet dhe kryetari i gjykatës për realizimin e ambienteve të përshtatshme dhe nëse po, cila mendoni ju se mund të jetë forma që mund të angazhohet kryetari i gjykatës?

Dhe e treta, nëse keni për gjykatën në tërësi, nëse jo, ju personalisht, afërsisht, në %, si është raporti i çështjeve të fituara shtet-individ në çështjet në gjykatën tuaj. Nëse ke për gjykatën, ose nëse nuk keni informacion, ju personalisht, afërsisht, në çështjet që keni shqyrtuar, si është balanca në %? Këto tre pyetje kisha.

Klodiana Veizi: Atëherë në lidhje me shortin që zhvillohet në gjykatë, ashtu sikurse e përmenda, janë disa muaj që është aplikuar shorti elektronik dhe mendoj që aplikimi i këtij shorti sepse unë në fakt vij nga një gjykatë ku në fakt ndarja e çështjeve bëhej me short dhe respektohej shumë barazia në ndarjen e çështjeve, mendoj se kjo përbën një risi dhe unë nuk kam frikë të them që ky, okej, është një sukses dhe një gjë pozitive e kolegut tim, Gencit. Por në momentin derisa u aplikua shorti elektronik, bëhej ndarja e çështjeve me short manual unë kam rezervat e mia. Kam qenë në fakt në momentin që jam emëruar në këtë gjykatë e përballur me një numër të konsiderueshëm çështjesh të regjistruara në momentin që unë emërohem aty më ngarkohen mua në short dhe normalisht, kjo ishte një situatë që ka ngarkuar dhe e ka vështirësuar deri diku punën time në vijim. Ndërsa me shortin elektronik nuk mund të them asnjë gjë. Nuk kam ndonjë dyshim në lidhje me shpërndarjen apo barazinë e çështjeve në short. Për më tepër që shorti elektronik është i tillë që me sa unë jam i informuar, regjistron çdo ndërhyrje apo çdo veprim që bëhet në të. Kështu që nuk e mendoj se mund të ketë të tilla.

Lidhur me ambientet e gjykatës, unë e thashë, ambientet e gjykatës janë shumë modeste dhe kjo nuk ecën në përpjesëtim të drejtë me ngarkesën që duhet gjyqtarët e kësaj gjykate të përballojnë. Një gjyqtar i gjykatës, në vitin e kaluar, në analizën që ne bëmë, kishte 700 çështje të gjykuara, ndërkohë që edhe unë për aq pak muaj sa kisha në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, kisha gjykuar aq çështje saç kisha gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Këto normalisht nuk janë pozitive dhe që të japësh një drejtësi cilësore duhet që të kesh edhe këto ambiente dhe ajo që mund të bëjë kryetari i gjykatës, përveçse të zbatojë në mënyrën më të mirë të mundshme ato resurse që i vihen në dispozicion nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, njëkohësisht mendoj se duhet të bëjë shumë edhe në kontakte me Ministrinë e Drejtësisë, të tregohet këmbëngulës dhe kokëfortë, në mënyrë që ashtu sikurse iu mor autoritetit portal një nga zyrat dhe u bë sallë, të merret edhe një zyrë tjetër dhe të bëhet një sallë e dytë, në mënyrë që 4 gjyqtarët e kësaj gjykate të mundet të rakordojnë me njëri-tjetrin dhe të bëjnë të paktën seancat gjyqësore në sallë sepse edhe zyrat janë të tilla që nuk krijojnë kushte për ta bërë procesin gjyqësor sipas standardeve.

Ndërkohë që në lidhje me çështjet e fituara, nga organet e administratës shtetërore, kundrejt individit, çështjet që gjykojmë ne janë çështje ku palë janë ose Dega

Doganore Durrës, tatimet dhe në këndvështrimin tim unë e vlerësoj veprimtarinë e administratës shtetërore si të ligjshme, në atë që kam gjykuar dhe atë që kam parë dhe duke dhënë vendime pozitive në pjesën më të madhe të tyre pro vendimmarrjes së organeve të administratës shtetërore. Kjo është pikëpamje personale. Nuk kam një statistikë se si ka qenë për kolegët e tjerë dhe cili është rezultati i vendimeve të kolegëve të tjerë lidhur me këtë aspekt.

Bujar Nishani: Ju falenderoj dhe meqë nuk ka pyetje të tjera, mbaruam. Mund të shkoni!

Klodiana Veizi: Ju faleminderit!

(Gjyqtarja Klodiana Veizi largohet nga salla e mbledhjes.)

Bujar Nishani: Mirë.

Gjin Gjoni: Tek komisioni Zoti President. Zoti Broci nuk është. Të caktojmë një përfaqësues tjetër për efekt të komisionit.

Bujar Nishani: Para se të kalojmë tek komisioni, ka ndonjë merak, ndonjë koment tjetër?

Gjin Gjoni: Të them të drejtën më vjen mirë që kjo zonja arriti që të ambientohet me gjykatën, se ka qenë shumë e vështirë për të në momentet e fillimit dhe tani na vjen mirë që paska bërë edhe kërkesë për kryetare gjykate dhe të them të drejtën...

Bujar Nishani: Po, tjetër?

Mirë atëherë, ju lutem, për të plotësuar komisionin. Është Zoti Saliko në komision, është Zoti Astrit dhe dikush tjetër. Kë propozoni?

Zoti Hallunaj! Dakord me Zotin Hallunaj?

Dakord, mirë atëherë. Zoti Hallunaj, Zoti Saliko dhe Zoti Haxhialushi, ju lutem të fillojë procesi i votimit. Administrata, fletët e votimit edhe e fillojmë këtë proces.

(Pasi fletët e votimit firmosen nga tre anëtarët e komisionit, shpërndahen dhe pas votimit rezulton si më poshtë.)

Hysen Saliko: Në përfundim të votimit, pasi u numëruan fletët e votimit, në votim kanë marrë pjesë 12 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, 3 nuk janë prezent (Zoti Zaganjori, Zoti Broci dhe Zoti Naço). Kanë votuar 12 dhe nga 12, 3 fletë janë të pavlefshme, pasi tre anëtarë kanë votuar kundër të dy kandidatëve. 6 (gjashtë) vota ka

marrë kandidati Genci Sinjari dhe 3 (tre) kandidatja Klodiana Mema. Në përfundim komisioni shpall si fitues për postin e kryetarit të gjykatës gjyqtarin Genci Sinjari.

Bujar Nishani: Po, faleminderit!

Mbyllet dhe kjo pikë e rendit të ditës.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 7, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 6 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Bujar Nishani*** (kryetar)
- 2. Nasip Naço*** (anëtar)*
- 3. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 4. Flamur Kapllani*** (anëtar)
- 5. Dritan Caka*** (anëtar)
- 6. Gjini Gjoni*** (anëtar)
- 7. Ilir Mustafaj*** (anëtar)
- 8. Hysen Saliko*** (anëtar)
- 9. Tritan Hamitaj*** (anëtar)

- 10. Astrit Haxhialushi* (anëtar)
11. Sokol Çomo (anëtar)
12. Albana Shtylla (anëtare)
13. Vangjel Kosta (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori dhe Zoti Artan Broci.

Shënim 2: Zoti Naço hyn në sallën e mbledhjes gjatë fillimit të shqyrtimit të kësaj pike.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.*
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Agnes Bernhard, Eksperte EURALIUS IV.*
- 11. Erton Karagjozi, Përfaqësues i EURALIUS-it.*

RENDI I DITËS:

6. Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Bujar Nishani: Kalojmë në pikën 7 (sipas procesverbalit i bie pika 6): Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Zoti Caka, relacionin për Shkodrën të lutem.

Dritan Caka: Po, atëherë pjesa hyrëse e raportin është e njëjtë, kështu që nuk po e lexoj sepse është e njëjtë për të katra gjykatat, pra baza ligjore dhe përbërja e komisionit. Drejtpërdrejtë po vijoj me të dhënat e kandidatëve.

Kandidatët për funksionin drejtues në këtë gjykatë janë: Zoti Ahmet Jangulli dhe Zonja Valbona Durraj. Komisioni konstaton se kandidatura e gjyqtarit Ahmet Jangulli nuk i plotëson kriteret ligjore, pasi është vlerësuar për veprimtarinë profesionale dhe etike për periudhën 2005-2006 “Mirë”, si dhe ndaj këtij gjyqtari është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” me vendimin nr. 19, datë 03.03.2015 të këtij Këshilli. Megjithatë komisioni ka hartuar materialin për të dy kandidatët që ia paraqet mbledhjes plenare të Këshillit.

Konkretisht për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, kandidatët janë Zoti Ahmet Jangulli, aktualisht gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Ka ndjekur dhe përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet 1993-1994 me notë mesatare 7, kurs i plotë i përsheptuar. Me vendimin nr. 5, datë 01.07.1994 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Bulqizë dhe me vendimin nr. 2, datë 12.04.1995 të KLD-së është emëruar kryetar në këtë gjykatë, detyrë të cilën e ka kryer deri në datën 30.08.2007, kohë kur kjo gjykatë u suprimua. Me vendimin nr. 235, datë 24.10.2008 të KLD-së ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe më pas me dekretin nr. 8282, datë 01.08.2013 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Vjetërsia në punë si gjyqtar është 20 vjet. Vlerësimi profesional “Mirë”. Ndaj këtij gjyqtari, siç ju thashë, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.

Kandidatja tjetër, Zonja Valbona Durraj - Ka ndjekur dhe përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet 1985-1989, me shkëputje nga puna, me mesatare note 9. Me vendimin nr. 15, datë 30.05.1998 të KLD-së është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit të Shkodrës dhe gjatë viteve 2006-2010 ka kryer edhe

detyrën e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me dekretin nr. 8268, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Vjetërsia në punë si gjyqtare është 16 vjet. Me vendimin nr. 386, datë 28.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është deleguar për të kryer përkohësisht detyrën e kryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Në vitin 2012 ka përfunduar studimet Master në Shkencat Juridike Civile, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Vlerësimi profesional për periudhën 2005-2006 “Shumë mirë”. Gjuhë të huaja: anglisht. Nuk rezulton që ndaj saj të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të, me shkresën nr. 420/1 prot., datë 09.02.2015, në përgjigje të shkresës që i ka dërguar Këshilli i Lartë i Drejtësisë me kërkesën për informacion drejtuar këtij institucioni, për kandidatët konkurrues në funksionin drejtues, shprehet se “...Deklaratat e interesave private të subjekteve: Ahmet Jangulli, Valbona Durraj, janë në proces kontrolli të plotë, në referim të nenit 25/1 të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Në përfundim të këtij procesi do t’ju njohim me rezultatet konkrete të kontrollit”.

Pra këto janë të dhënat lidhur me konkurrentët për kryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Bujar Nishani: Faleminderit, Zoti Caka!

Pyetje e komente rreth raportit?

Nuk ka.

Atëherë ngelemi me një kandidaturë sepse Jangulli nuk i plotëson kriteret.

Po? Urdhëro?

Është tërhequr. Po mirë edhe raporti i komisionit thotë që nuk i plotëson kriteret edhe ai është tërhequr, kështu që jemi më një kandidaturë. Po, urdhëro Albana?

Atëherë të njoftohet. Ka ardhur Zonja Durraj?

Të njoftohet të vijë.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtarja Valbona Durraj.)

Mirë se keni ardhur!

Ju kemi thirrur për të qenë pjese e procedurës së emërimit të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Ju jeni kandidatë për këtë post. Komisioni i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i shqyrtimit të kandidatëve ka gjetur kandidaturën tuaj në plotësim të kushteve dhe kriterëve të ligjit.

(Zoti Naço hyn në sallën e mbledhjes.)

Do të keni në dispozicion 10 minuta kohë për të na paraqitur në mënyrë të përmbledhur platformën dhe vizionin tuaj, në mënyrë të përmbledhur gjithmonë sepse ne jemi njohur në tërësi me të, pastaj nëse anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë do të kenë nevojë për informacione më të detajuara dhe do të kenë mundësi t'ju adresojnë pyetje. Urdhëro, keni fjalën juve.

Valbona Durraj: Po, ju falenderoj!

Pa humbur kohë, duke qenë se e kam kohën e limituar në lidhje me paraqitjen e programit për menaxhimin dhe drejtimin e gjykatës, në mënyrë të sintetizuar, kam përgatitur një material ku kam performuar atë se çfarë unë mendoj në drejtimin e gjykatës administrative të shkallës së parë.

Duke qenë se me ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, është krijuar me ligj të veçantë gjykata administrative, ku ndër to është edhe gjykata e shkallës së parë administrative. Në veprimtarinë e saj, gjykata i qëndron besnik bindjes së saj në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe Konventës Evropiane, si pjesë organike e legjislativës të brendshme, duke qenë kështu një mjet i pashmangshëm për ruajtjen e qetësisë publike dhe institucioneve demokratike në vend.

Që të realizohet një gjykatë me reputacion të gjere në shoqëri, në të cilën të jepet drejtësi, një rol të veçantë zë dhe titullari i këtij institucioni. Për mendimin tim, detyra e titullarit të institucionit është e ndarë në tre komponentët e saj:

Ka të bëjë me atë të administrimit të mjeteve financiare, që është faktori ekonomik; ka të bëjë me menaxhimin e burimeve njerëzore (ushtrimin e funksionit të kryetarit në lidhje dhe me kontrollin formal të punës dhe të proceseve gjyqësore për seancat e gjykimin në orare të planifikuara nga gjyqtarët dhe përfaqësimin e institucionit, si një element shumë i rëndësishëm duke qenë se është personalitet juridik, ka një titullar i cili e përfaqëson raportin e kësaj gjykate me mediat dhe me personat e tretë.

Për sa i përket administrimit të mjeteve financiare. Duke qenë se financimi ekonomik përbën një rol jo pak të rëndësishëm për ecurinë edhe veprimtarinë e funksionimit të gjykatës, mendoj se puna e kryetarit të gjykatës, si një nga funksionet që i njeh ligji, është dhe menaxhimi i burimeve financiare, nëpërmjet hartimit (në bashkëpunim me kancelarin dhe zyrën e buxhetit) të projektbuxhetit të gjykatës, të cilën duhet të pasqyrohen në mënyrë të detajuar të gjitha nevojat dhe kërkesat për përmirësimin dhe funksionimin e mirë të gjyqësorit. Në këtë drejtim, duke qenë se është një institucion i ri, që faktikisht godina është inkorporuar në disa ambiente të katit të katërt të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, parashtrohet si nevojë e domosdoshme ekzistenca e një ambienti pune, ku gjykata të bëjë prezantimin e saj në funksion të misionit për dhënien e drejtësisë.

Duke qenë se kam qenë në funksionin e kryetares së komanduar të kësaj gjykate, duke njohur dhe resurset që paraqet edhe ambienti, edhe prezantimi i performancës së punës së gjykatës në ambiente pune të përshtatshme, në mendimin tim, kam parashtruar dy ide të cilat aktualisht, në fakt njëra është realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me zyrën e buxhetit. Njëra ide ka qenë ndarja e një kati të tërë për gjykatën administrative ku të ketë mundësi dhe për salla gjykimi për gjyqtarët, në mënyrë që të ketë mundësi gjykimi në salla dhe jo në zyrat e gjykimit dhe ideja tjetër ka qenë ambiente me qira. Aktualisht që ne po flasim është bërë e mundur që në godinën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të bëhet një ndarje ambientesh, ku kati i katërt t'i vihet në dispozicion gjykatës administrative, shkallë e parë, dhe presim fonde për investime të mëtejshme në këtë gjykatë.

Gjithashtu nga financimi në infrastrukturë, si nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët, do të përdoren për informatizimi i proceseve gjyqësore: Kompjuterizimi i të gjitha sallave të gjykimit; Investimi me inverter për te përballuar luhatjet e tensionit për të mundësuar vazhdimësinë e proceseve edhe ne rast ndërprerje të energjisë; Investimi me mjete logjistike të arshivës si dhe me kompjuter, si dhe program elektronik për arshivën; Trajnime të sekretareve gjyqësore dhe të kryesekretarisë; Instalimi në të gjithë kompjuterët e librisë ligjore. Gjithashtu, gjatë periudhës në vazhdim do të bëhet e mundur instalimi dhe mirëmbajtja e programit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Aktualisht që flasim është bërë e mundur instalimi i këtij programi. Sot vendoset hedhja e

çështjeve me short dhe problematikat janë vetëm problematika teknike të cilat shumë shpejt do të gjejnë zgjidhje me financime nga ZABGJ-së si dhe me donatorin që është USAID-i, i cili ka marrë përsipër programin për një drejtësi të shpejtë në instalimin e sistemit audio për sallat e gjyqimit.

Për sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, është një nga elementët e punës së kryetarit të gjykatës në ushtrimin e funksionit të tij. Kryetari duhet të mbajë raporte korrekte me trupën gjyqësore në mbështetje të kodit të etikës duke ushtruar funksionin e tij për llogaridhënie në lidhje me zbatimin korrekt nga ana e trupës gjyqësore për zbatimin e disiplinës formale në punë dhe të respektimit nga ana e tyre të orareve të seancave gjyqësore të planifikuara më parë nga vetë ata. Kjo realizohet nëpërmjet kontrolleve të përditshme në lidhje me prezantimin në punë të gjyqtarëve, si dhe respektimit nga ana e tyre të orareve të seancave gjyqësore.

Organizimi i mbledhjeve dy herë në javë, duke diskutuar vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të institucioneve të tjera të cilat ajo ka marrëdhënie, diskutimi mbi shkaqet materiale dhe procedurale të cenimit të vendimeve gjyqësore që prishen, të cilat duhet të analizohen jo vetëm në analizë vjetore por edhe gjatë seancave në mënyrë që të bëhet përthithja e të gjitha ndryshimeve në legjislacion si dhe në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë. Në të ardhmen mendoj se duhet të ecet në këtë frymë duke pasqyruar dhe mbajtur në mënyrë protokollare problematikat e trupës gjyqësore që dalin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të përditshme.

Për sa i përket përzgjedhjes së administratës, duhet ndjekur parimi i përzgjedhjes nëpërmjet vlerësimit të njëpasnjëshëm të bërë nga ana e gjyqtarëve dhe të kancelares së gjykatës për sekretaret e reja me kontrata provizore, të cilat do të punësohen. Mendoj se kjo mënyrë e përzgjedhjes së sekretares është më efektive, pasi vlerëson punën e tyre për kohën që ato janë në marrëdhënie pune deri në momentin e kalimit si sekretare definitive pranë një sektori gjyqësor.

Marrëdhënia e tretë është marrëdhënia e gjykatës me publikun dhe median. Publiku në kuadrin e frymës së transparencës së punës së gjyqësorit, marrëdhënia me publikun paraqitet si marrëdhënie delikate, e cila kërkon vlerësim të posaçëm nga drejtuesi i institucionit. Puna në këtë aspekt fillon që me transparencën e hedhjes së çështjeve gjyqësore me short, duke vazhduar me publikim në holl të gjykatës të listës së

shorteve, të listës së orareve të gjykimit për secilin gjyqtar. Zhvillimi i seanceve gjyqësore të hapura ku lejon hyrjen e lirë të publikut në sallë duke respektuar rregullat e gjykimit. Krijimi i ambienteve brenda strukturës së gjykatës ku t'i jepet akses publikut që të ketë mundësi dhe kohën e mjaftueshme për të marrë informacion elektronik dhe manual, si dhe të ketë mundësi të ndihmës juridike falas për qytetarët.

Për sa i përket medias, media si ajo vizive dhe ajo e shkruar, ka një ndikim të rëndësishëm në realizimin e veprimtarisë së gjykatës. Çdo individ ka ndikimin e tyre tek të tjerët me krijimin e reputacionit apo të imazhit të gjykatës duke i trajtuar me kujdes, duke i konsideruar si individë me fuqi të lartë. Aktualisht, raporti i gjykatës me publikun dhe median realizohet nga kancelari i gjykatës. Në të ardhmen mendoj se pranë gjykatës duhet të atashohet një personel i veçantë, ku të jetë zëdhënës me publikun i specializuar që të japë informacione atë që i nevojitet mediave të shkruara dhe vizive.

Këto ishin tre komponentë ku një kryetar gjykate në funksionin e tij duhet të përfshijë veprimtarinë e tij administrative dhe funksionale jashtë punës së të qenurit gjyqtar.

Bujar Nishani: Mirë! Ju falenderoj, zonja gjyqtare!

Pyetje, nëse ka nga anëtarët e Këshillit?

Po, Zoti Ministër!

Nasip Naço: Faleminderit, Zoti President! Pyetja ime është, nëse jeni vlerësuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë? Dhe nëse po, sa herë jeni vlerësuar?

Valbona Durraj: Në dijeninë time jam vlerësuar një herë nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Nasip Naço: Pyetja e dytë është: Në dijeninë tuaj, çfarë parashikon ligji për sistemin e vlerësimit dhe sa herë duhet të jesh vlerësuar për të konkurruar për kryetar gjykate? Faleminderit!

Valbona Durraj: Në dijeninë e ligjit dhe njëherësh edhe në dijeninë time është dy vlerësime të njëpasnjëshme dhe vlerësime “Shumë mirë”.

Bujar Nishani: Tjetër pyetje?

Mirë, atëherë! Duke vlerësuar prezencën dhe paraqitjen, mbaruam. Mund të shkoni!

Valbona Durraj: Ju falenderoj për kohën që humbët!

(Gjyqtarja Valbona Durraj largohet nga salla e mbledhjes.)

Bujar Nishani: Mirë, atëherë. Komente të tjera, para se të kalojmë në proces votimi?

Mirë, atëherë kalojmë në procesin e votimit.

Kush është dakord për emërimin e Zonjës Valbona Durraj si kryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër?

Zoti Nasip Naço!

Kundër!

Zonja Shtylla!

Kundër!

Zoti Saliko!

Pro!

Zoti Hamitaj!

Pro!

Zoti Kapllani!

(Nuk ndodhet për momentin në sallë.)

Zoti Gjoni!

Pro!

Zoti Hallunaj!

Pro!

Zoti Broci!

(Mungon.)

Zoti Mustafaj!

Pro!

Zoti Haxhialushi!

Pro!

Zoti Caka!

Pro!

Zoti Çomo!

Kundër!

Zoti Kosta!

Kundër!

Nishani!

Pro!

Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë (8) janë pro dhe katër (4) kundra.

Miratohet emërimi i Zonjës Durraj, si kryetare e Gjykatës Administrative të Shkodrës.

Po, Zoti Ministër!

Nasip Naço: Faleminderit, Zoti President!

Në radhë të parë dua të falenderoj juve që i futët në rendin e ditës mbas disa kohësh dhe insistimi për të emëruar kryetarët e gjykatave administrative. Por votova kundër - nuk kam gjë me kandidaten - por votova kundër për shkak të mosrespektimit rigoroz të ligjit. Besoj se jo pa qëllim e pyeta kandidaten që çfarë parashikonte ligji dhe sa herë ishte vlerësuar dhe besoj se s'ka nevojë të bëjmë koment. Unë do vazhdoj që të votoj kundër sa herë që nuk respektohen procedurat ligjore në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Por, kam edhe një kërkesë prapë dhe dua të inkurajoj këtë Këshill që të respektojë në çdo rast ligjin, i ka të gjitha mundësitë që me procedurë të përshpejtuar, këta pak kandidatë që kanë ngelur mund t'i vlerësojë dy herë siç e parashikon ligji, dhe besoj që ky Këshill i ka të gjitha mundësitë, të gjitha kapacitetet, ka integritet, të tregojë edhe efikasitetin që i mungon. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, Zonja Shtylla!

Albana Shtylla: Edhe unë, një shpjegim vote. Duke qenë se e thashë edhe në fillim të këtij procesi, për sa i përket kandidatëve nuk i hyj meritës së tyre, por pikërisht parashikimit të kriterit ligjor të përcaktuar në nenin 16 të ligjit. Kaq!

Bujar Nishani: Po, faleminderit!

Tjetër?

Nuk ka.

Atëherë, mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 8, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 7 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Bujar Nishani*** (kryetar)
2. ***Nasip Naço*** (anëtar)
3. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
4. ***Flamur Kapllani*** (anëtar)
5. ***Dritan Caka*** (anëtar)
6. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
7. ***Ilir Mustafaj*** (anëtar)
8. ***Hysen Saliko*** (anëtar)
9. ***Tritan Hamitaj*** (anëtar)

- 10. Astrit Haxhialushi* (anëtar)
11. Sokol Çomo (anëtar)
12. Albana Shtylla (anëtare)
13. Vangjel Kosta (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori dhe Zoti Artan Broci.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.*
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.*

RENDI I DITËS:

7. Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Bujar Nishani: Kalojmë në çështjen tjetër (*sipas procesverbalit i bie pika 7*): Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Zoti Caka, të lutëm!

Dritan Caka: Kandidatët të cilët kanë paraqitur kërkesë për funksionin drejtues të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë janë: Zoti Sokol Ibi dhe Zonja Etleva Çami (Gjamo).

Në emër të komisionit po ju paraqes të dhënat sa më poshtë vijon:

Kandidati Sokol Ibi aktualisht është gjyqtar në këtë gjykatë. Ka ndjekur dhe përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitet 1998-2002, me mesatare note mbi 9. Gjatë viteve 2004-2007 ka ndjekur dhe përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe me dekretin nr. 5048, datë 04.10.2006 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. 5515, datë 14.11.2007 është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për t’u emëruar së fundmi me dekretin nr. 8267, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Është deleguar për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. 387, datë 28.10.2013 të KLD-së. Vjetërsia në punë si gjyqtar është 8 vjet, duke përfshirë këtu edhe periudhën e stazhit profesional. Vlerësimi profesional “Shumë mirë” (2 nga grup kriteret “Shumë mirë” dhe 1 “Mirë”). Gjuhë të huaja: Anglisht me dëshmi. Nuk rezulton që ndaj tij të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore. Dhoma e Avokatëve Korçë me shkresën nr. 98 prot., datë 03.02.2015 në përgjigje të shkresës nr. 364 prot., datë 30.01.2015 të KLD-së për kërkim opinionit për gjyqtarët konkurrentë, drejtuar kësaj dhome avokatie, thekson se Zoti Sokol Ibi, si kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ka treguar profesionalizëm në marrëdhënie me avokatët në respektim të kuadrit ligjor të përfaqësimit të avokatëve.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, me shkresën që e kam përmendur tashmë “Mbi kërkesën për informacion” drejtuar nga KLD-ja për kandidatët konkurrues në funksionin drejtues, shprehet se Zoti Sokol Ibi, ka përfunduar kontrollin e plotë dhe deklaratat e tij kanë rezultuar pa probleme dhe në përputhje me kërkesat e ligjit.

Zonja Etleva Çami Gjamo - aktualisht është gjithashtu gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Ka ndjekur dhe përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet 1991-1995, me shkëputje nga puna, me mesatare note 9.8. Me vendimin nr. 7, datë 08.02.1996 të KLD-së është emëruar

ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Korçë dhe më pas me vendimin nr. 15, datë 30.05.1998 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Korçë. Me dekretin nr. 8266, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Vjetërsia në punë si gjyqtare është 16 vjet, 19 vjet gjithsej në sistemin gjyqësor. Vlerësimi profesional 2005-2006 “Shumë mirë” (3 nga grup kriteret “Shumë mirë” dhe 1 “Mirë”) dhe për vitet 2007-2009 “Shumë mirë” (2 “Shumë mirë” dhe 1 “Mirë”). Gjuhë të huaja: anglisht, rusisht (sipas CV-së të paraqitur nga vetë kandidatja). Nuk rezulton që ndaj saj të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore.

Edhe për këtë gjyqtare, Dhoma e Avokatëve Korçë me të njëjtën shkresë, në kërkim të opinionit për gjyqtarët konkurrent, thekson se: “Zonja Etleva Gjamo (Çami) ka treguar korrektësi në marrëdhëniet me avokatët dhe në përfaqësimet në gjykim nga ana e tyre”.

Po ashtu, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive ka kthyer përgjigje se në lidhje me Zonjën Etleva Gjamo (Çami) është në proces kontrolli të plotë, dhe në përfundim të këtij procesi do të njohë Këshillin me rezultatet konkrete të kontrollit.

Bujar Nishani: Faleminderit, Zoti Caka!

Po, Zoti Kosta!

Vangjel Kosta: Faleminderit!

Thjesht për të shpjeguar qëndrimin tim. Edhe në këtë vendim kam qenë kundër shumicës së komisionit, me të njëjtin argumentim që, në respekt të ligjit, meqenëse njëri nga kandidatët nuk kishte dy vlerësime, duhej të pezullohej procesi për t’i dhënë mundësi vlerësimit me procedurë të përshpejtuar të kandidatit që nuk plotësonte kriterin ligjor, për të qenë konkurrimi pastaj i barabartë dhe i ndershëm ndërmjet kandidatëve. Faleminderit!

Bujar Nishani: Tjetër?

Mirë atëherë, kalojmë në dëgjimin e kandidatëve. Të vijnë, Etleva Çami, pastaj Sokol... Sipas alfabetit.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtarja Etleva Gjamo Çami.)

Zonja gjyqtare, mirë se keni ardhur!

Ju kemi thirrur për të qenë pjesë e shqyrtimit të emërimit të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Ju jeni një nga kandidaturat. Komisioni i ngritur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka gjetur në përputhje me ligjin dhe kriteret kandidimin tuaj. Do të procedojmë në këtë mënyrë: Ju do të keni 10 minuta në dispozicion për të paraqitur dhe njëherë në mënyrë të përmbledhur platformën tuaj, pastaj anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nëse do të kenë nevojë për qartësime të mëtejshme, do t'ju adresojnë pyetje. Urdhëro, keni fjalën!

Etleva Gjamo: I nderuar Zoti President i Republikës, I nderuar Zoti Ministër, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në vijim të kërkesës time të paraqitur pas shpalljes së vendit vakant për kryetar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, paraqiten para jush për të prezantuar aspektet kryesore të projekt programit të drejtimit dhe menaxhimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Paraprakisht dua t'ju informoj se kam filluar punë në sistemin e drejtësisë prej vitit 1996, fillimit si ndihmës gjyqtare dhe më pas prej vitit 1998 e në vijim si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe prej fillimit të punës së gjykatës administrative, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Personalisht nuk kam patur përvoja të mëparshme në drejtim institucional dhe përsëri nuk mendoj që të drejtosh një gjykatë është një detyrë e zakonshme, por mora iniciativën për të kërkuar vlerësimin tuaj nisur nga përvoja e gjatë e punës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe tashmë në gjykatën administrative dhe veçanërisht në seksionin administrativ të Gjykatës së Rrethit Korçë, seksion të cilin kam punuar për një periudhë prej 10 vite rresht. Duke punuar për një kohë të gjatë si gjyqtare në gjykimin e çështjeve administrative, personalisht mendoj se kam fituar dhe një përvojë të vlefshme për mënyrën e trajtimit të konflikteve, duke përcjellë vit pas viti jo vetëm problematikat që mbartin këto çështje tepër të prekshme për interesat e individëve dhe të shtetit, por duke qenë në kontakt edhe me qëndrimin e Gjykatës së Lartë të shprehur rast pas rasti. Kjo përvojë e gjatë pune ishte dhe arsyeja e konkurrimit për në gjykatën administrative, ku pas testimit të zhvilluar jam vlerësuar me 94 pikë, duke u emëruar mandej në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Duke patur parasysh në konsideratën time këtë përvojë të gjatë në gjykimin e mosmarrëveshjeve, e mbështes këtë kërkesë timen për të kandiduar në pozicionin e drejtuesit, me qëllim për ta ngritur këtë përvojë në një nivel më të lartë, atë të dhënies edhe të kontributit për drejtimit të gjykatës nëpërmjet vënies në jetë të vizionit të parashtruar në projekt programin e kandidimit, si një sintezë e asaj çfarë unë kam mësuar në gjithë këto vite. Procesi gjyqësor, deri në finalizimin e dhënies së vendimit, kërkon një menaxhim efektivë që nënkupton jo vetëm identifikim e kuadrit ligjor për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, por edhe zbatimin praktik të dispozitave procedurale për të siguruar një gjykim brenda afateve të arsyeshme, për të garantuar marrjen në kohë të provave, të drejtat e palëve, pra zbatimin e të gjitha parimeve që vendimi përfundimtar të jetë pasojë e një procesi të rregullt ligjor.

Në këtë aspekt e kam konceptuar edhe drejtimin e gjykatës duke bërë një paralelizëm më të gjerë ndërmjet aspektit organizativ dhe drejtues që manifeston gjyqtari në gjykimin e një çështjeje, deri në dhënien e vendimit, me atë të drejtimit dhe të menaxhimit të institucionit.

Ligji 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, solli risi jo vetëm në aspektin teknik të krijimit dhe funksionimit të gjykatave administrative, por dhe në drejtimin të aspekteve procedurale të gjykimit, duke mëshuar veçanërisht në një sërë parimesh në gjykimin e këtyre mosmarrëveshjeve, zbatimi dhe garantimi i të cilave nuk është vetëm mision i gjyqtarit që gjykon çështjen konkrete, por është dhe misioni i drejtuesit të gjykatës, duke e parë atë në një prizëm më të gjerë. Në këtë aspekt, për të arritur në një nivel më të lartë të cilësisë dhe profesionalizmit për menaxhimin e proceseve gjyqësore, mendoj se roli i drejtuesit të gjykatës merr një rëndësi të veçantë. Kompetencat e drejtuesit të gjykatës normohen me akte ligjore, por ushtrimi i tyre efektiv në këndvështrimin tim është parë në dy askete kryesore, më qëllim mirëfunksionimin e brendshëm institucional. Është parë në rolin e drejtuesit të gjykatës në raport me trupën gjyqësore dhe në rolin e drejtuesit të gjykatës në raport me administratën gjyqësore dhe sektorët e tjerë të saj.

Përveç këtyre dy komponentëve bazë që janë të lidhur drejtpërdrejtë me menaxhimin e çështjeve gjyqësore nga pikëpamja e faktit dhe që janë detajuar më tej në pika të veçanta dhe drejtime të veçanta në projektin e gjerë të raportit, një rëndësi të

madhe mendojë që për drejtuesin e gjykatës merr dhe ndërtimi i marrëdhënieve me institucionet që luajnë rol në mirë ushtrimin e funksioneve të gjykatës dhe si subjekte të tjera si Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, gjykatat e tjera, Dhoma e Avokatisë.

Në këndvështrimin tim, vizioni i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, duke e përqasur dhe me parimet që përshkojnë njëkohësisht edhe ligjin “Për gjykatën administrative”, si ligj i posaçëm, është perceptuar si garantim i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave fizik, juridik dhe shtetit, nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme për një shqyrtim efektiv, duke rivendosur të drejta të cenuara nga veprimet apo aktet e nxjerra nga organet e administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, si dhe garantimin e aksesit të çdo qytetari në drejtësinë administrative, por duke ruajtur gjithmonë dhe interesin publik. Realizimi i këtij vizioni, dikton edhe përcaktimin e rrugëve për vendosjen e tij në raport me kushtet që ofron aktualisht infrastruktura e Gjykatës Administrative Korçë, si dhe ngritjen e vazhdueshme profesionale të stafit të gjykatës për të garantuar zbatimin e ligjit.

Gjykata administrative, për parantezë, funksionon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për shkak të faktit që ajo është një gjykatë e re, me të gjitha parametrat bashkëkohore, mendoj se dhe ne na janë ofruar këto parametra, por që gjithmonë ka vend për përmirësimin në drejtim të punës dhe organizmit dhe në aspektin tim të këndvështrimit dhe të projekt raportit, mendoj se pavarësisht standardeve aktuale për të ofruar një shërbim sa më të mirë, do të ishte e nevojshme të shihej mundësia për të funksionuar në një godinë më vete, për të krijuar salla gjykimi veçmas për çdo gjyqtar sepse i gjithë solemniteti i gjykimit dhe fakti që t’i përcjellim gjykimit atë që ne po zhvillojmë një proces të rregullt ligjor, lidhet pike së pari edhe me infrastrukturën se ku zhvillohet gjykimi i një çështje.

Përveç sa më sipër mendoj që nevojitet fillimi i funksionimit sa më shpejtë i sistemit informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, e cila shihet edhe nga pikëpamja e transparencës për publikun, që mundëson hedhjen e shortit në mënyrë elektronike për të siguruar përveç transparencës edhe ndarje të drejtë të ngarkesës së punës edhe monitorim sa më të mirë të ecurisë së procesit.

Vlerësoj në aspektet e drejtimit të gjykatës se do të ishte me rëndësi edhe krijimi i faqes së internetit të gjykatës për të ofruar një informacion për publikun dhe për institucionet e tjera, duke patur parasysh faktin se në themel të vendimmarrjes së gjykatave administrative është shqyrtimi i ligjshmërisë së vendimmarrjes të administratës publike dhe nga përvoja ime e punës jam në dijeni të faktit që këto janë gjithmonë çështje të prekshme.

Në krijimin e imazhit pozitiv të gjykatës dhe përmirësimit të tij do të ndikonte zhvillimi dhe ndërtimi i një marrëdhënieje korrekte me median nëpërmjet komunikimit dhe informimit për çështjet administrative, veçanërisht ato që i referohen grupeve të interesit të cilave ligji për gjykatat administrative ju njeh të drejtën për t'u paraqitur nëpërmjet kërkesëpadive në gjykatë, që janë dhe risi të ligjit. Në kuadrin e risive, merr rëndësi dhe roli i këshilltarit ligjor për të cilin ne jemi në kuadrin e përzgjedhjes së tyre, i cili do të japë një ndihmesë të madhe në identifikimin e kuadrit ligjor të zbatueshëm në varësi të natyrës së konfliktit dhe të ndihmojë gjykatën jo vetëm për zgjidhjen e çështjes por edhe si një faktor i rëndësishëm që do të ndikojë në përshpejtimin e procesit të vendimmarrjes.

Përveç sa më sipër nga ana ime si kandidate për kryetare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, janë evidentuar edhe drejtimit kryesore ku përqendrohen realizimi i misionit të gjykatës, të cilat përmbledhen, por jo vetëm në luftën kundër korrupsionit, në rritjen e transparencës, në shkëmbimin e eksperiencës, e cila konceptohet si një aspekt i rëndësishëm që ndikon dhe në realizimin e projekt programit si dhe trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në veprimtari kualifikuese.

Në funksion të realizimit të vizionit të gjykatës administrative merr rëndësi specifike dhe krijimi i një marrëdhënieje të mirë bashkëpunimi brenda gjykatës i cili sipas këndvështrimit tim do të konsistojë në ndërgjegjësimin e gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore për të përmbushur detyrimet ligjore, si dhe në krijimin e një klime sa më bashkëpunuese në gjykatë, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mirëfunksionimin institucional.

Ndërgjegjësimi i gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore shihet si një aspekt i rëndësishëm jo vetëm në drejtimin personal të gjithsecilit për të përmbushur detyrimet

ligjore, por edhe në aspektin institucional si pjesë përbërëse e veprimtarisë së gjykatës administrative. Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit dhe roli i drejtuesit të gjykatës në këtë aspekt padyshim që do të ndikojë jo vetëm në parandalimin e korrupsionit por edhe në rritjen e besimit tek publiku.

Fryma e bashkëpunimit është një aspekt tjetër i cili sipas meje vlerësohet se do të përqendrohet në ndërtimin e marrëdhënieve sa më korrekte midis kryetarit dhe kancelarit të gjykatës, kryetarit dhe gjyqtarëve, kryetarit dhe administratës gjyqësore. Përqendrimi i punës së drejtuesit në realizimin e aspekteve të mësipërme do të mundësojë rritjen e transparencës, shmangien e zvarritjeve të pajustificuara të proceseve gjyqësore, ofrimin e shërbimeve me shpejtësi dhe cilësi dhe profesionalizëm në zhvillimin e gjykimit dhe në vendimmarrje.

Përveç aspekteve kryesore ku përqendrohet komplet programi, sigurisht nga ana ime është evidentuar edhe në projekt synimi final, duke parashtruar faktin se projekt program është konceptuar për të mundësuar realizimin e misionit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë në dhënien e drejtësisë, në ofrimin dhe garantimin e standardeve kushtetuese për procese të rregullta ligjore brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Gjithashtu zbatimi i projekt programit do të mundësojë zhvillimin e gjykimeve duke siguruar dhe mbrojtjen juridike të të drejtave dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të subjekteve që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e institucioneve të administratës publike si dhe do të garantojë parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të personave privat.

Duke patur një vizion të strukturuar për mendimin tim për drejtimin e gjykatës administrative, një përvojë të gjatë pune si gjyqtare, veçanërisht në gjykimin e këtyre çështjeve administrative, duke patur edhe dy vlerësime pune “Shumë mirë” për vitet 2005-2006 dhe 2007-2009, personalisht mendoj se plotësoj kushtet ligjore për pozicionin e drejtuesit të gjykatës administrative dhe duke shprehur bindjen në gjykimin tuaj të drejtë kërkoj mbështetjen tuaj në vënien në jetë të programit dhe njëherazi ju falenderoj që më lejuat këtë prezantim.

Bujar Nishani: Po, edhe unë të falenderoj për paraqitjen dhe për gjithçka sqaruar.

Pyetje nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për gjyqtaren?

Zoti Mustafaj!

Ilir Mustafaj: Zonja kandidate, ju keni afërsisht 1 vit e gjysmë punë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë të Korçës. Në pikëpamjen tuaj, çfarë probleme do të evidentonit në mënyrën e drejtimit të gjykatës nga ana e kandidatit të sitshim ose gjyqtarit të komanduar në pozicionin e kryetarit dhe çfarë do të bënit ndryshe ju në drejtimin e gjykatës, nga ajo që po bën kandidati që është tani? Faleminderit!

Elteva Gjamo: Para së gjithash dua të informoj Këshillin e Lartë të Drejtësisë se pavarësisht faktit se ne jemi vetëm 2 gjyqtarë dhe 1 vit e disa muaj punë në atë gjykatë, kemi patur marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi me njëri-tjetrin, kemi patur koherencë në të gjitha problematikat që i kanë lindur gjykatës. Secili ka vizionin e vetë. Unë nuk mund të bëj dot një krahasim të detajuar se çfarë do të bëja më mirë se gjyqtari tjetër, por do të gjejë format e mia personale për të vënë në jetë këtë program që kam paraqitur para jush.

Bujar Nishani: Po, tjetër?

Zoti Ministër!

Nasip Naço: Faleminderit!

Si ka ndikuar funksionimi i Gjykatës Administrative në Korçë nga mosplotësimi i vendeve vakante?

Elteva Gjamo: Ka ndikuar vetëm në rritjen pak të ngarkesës së gjyqtarëve, por mendoj që i kemi kushtuar kohën e duhur dhe nuk ka cenuar procesin e cilësisë së vendimmarrjes. Pavarësisht faktit se kemi ngarkesë më tepër sesa kishim kur kemi qenë gjyqtarë në gjykatën e shkallës së parë. Jemi munduar për të gjetur mundësinë për t'i plotësuar standardet e gjykimit me gjithë atë ngarkesë që është.

Bujar Nishani: Tjetër?

Unë kisha një pyetje zonja gjyqtare. Afërsisht, një balancë në përqindje të çështjeve të fituara në raportin shtet-individ, si janë në rastin e... ose më mirë, si janë në rastin tuaj? Afërsisht.

Elteva Gjamo: Një informacion të saktë ndoshta mund të mos ta jap, por përgjithësisht në konfliktet e punës ka ecur balanca drejt individit, ndërsa në raport me çështjet që lidhen me aktet administrative, në një numër të konsiderueshëm janë fituar nga shteti, me doganat, me tatimet, gjrobat e vendosura nga INUK-u. Në konceptin tim

është një shumicë dërrmuese vendimesh që janë vlerësuar të drejta aktet administrative. Ka dhe raste që për shkelje flagrante të ligjit që ne i quajmë pavlefshmëri absolute të akteve, janë pranuar kërkesëpaditë apo në rastet kur gjykata s'ka krijuar bindjen që ka ndodhur një kundra-vajtje administrative. Por një përqindje të saktë nuk mund ta jap.

Bujar Nishani: Po, faleminderit!

Mirë atëherë, duke vlerësuar praninë tuaj dhe shpjegimet që dhatë, mbaruam. Mund të shkoni!

Etleva Gjamo: Faleminderit!

(Gjyqtarja Etleva Gjamo del nga salla e mbledhjes. Ndërkohë hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari Sokol Ibi.)

Bujar Nishani: Zoti gjyqtar, mirë se keni ardhur! Uluni!

Ju kemi thërritur për të marrë pjesë në procedurën e emërimit të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Ju jeni një prej kandidatëve. Komisioni i ngritur për vlerësimin e kandidaturave e ka gjetur edhe kandidaturën tuaj në përputhje me ligjin dhe kriteret për emërimin e kryetarëve të gjykatës administrative. Do të procedojmë në këtë mënyrë: Ju keni në dispozicion 10 minuta në mënyrë për ta paraqitur edhe njëherë në mënyrë të përmbledhur vizionin dhe platformën tuaj për drejtimin e kësaj gjykate, pastaj nëse do të ketë pyetje dhe paqartësi anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë do të kenë kohën për t'ju drejtuar juve pyetje. Urdhëro, keni fjalën.

Sokol Ibi: Faleminderit, i nderuar Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë! Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Së pari desha t'ju falenderoj për besimin që më keni dhënë për të drejtuar këtë gjykatë që nga dita e krijimit të saj me dekret të Presidentit të Republikës, 4 nëntor të vitit 2013, deri në ditën e sotme që jemi mbledhur. Nëse do të kisha besimin tuaj për të drejtuar këtë gjykatë në vitet në vijimësi, në këtë mandat, do të fokusohesha në programin tim në këto pika kryesore... Programi im konsiston në disa aspekte kryesore, duke qenë se mendoj se e keni të parashtruar në mënyrë të hollësishme gjithsecili nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë më të detajuar, konsiston në këto pika: Pikësëpari, shërbim ndaj publikut; pikësëdyti, transparencë në drejtimin e gjykatës; së treti, miradministrim i burimeve njerëzore dhe i burimeve materiale. Përveç detyrave kryesore që ka çdo administrator dhe çdo drejtues institucioni, që janë të zakonshme.

Për sa i përket pikës së parë, të aspektit kryesor, të shërbimit të publikut, ideja ime është që gjykata duhet të jetë dhe është organ që përveçse është pushtet dhe jep drejtësi, pikësëpari duhet të fokusohet, duhet ta ketë shërbimin e saj ndaj publikut, në mënyrë që të mos krijohen pengesa në punën e përditshme. Për fat të mirë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ushtron veprimtarinë e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila është një godinë me infrastrukturë të re, e ndërtuar në vitet 2010-2011 dhe pjesën e shërbimit ndaj publikut e ka në nivele të kënaqshme. Për sa i përket kësaj pjese, do të theksoja që është i rëndësishëm këndi i njoftimeve, ku të afishohen njoftimet periodike, urdhrat e titullarit, lista e gjykimeve pas hedhjes së shortit dhe të gjitha njoftimet që janë me interes për publikun.

Për sa i përket pikës së dytë, të transparencës, transparenca duhet të jetë pikësëpari me publikun dhe pikësedyti, me kolegët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Transparencën e shikoj jo vetëm thjesht në kuadrin e veprimtarisë administrative të titullarit, duke iu shpërndarë kopjen e çdo akti kolegëve, por edhe në drejtim të transparencës së buxhetit, duke qenë që titullari është njëkohësisht edhe menaxhues i buxhetit të gjykatës. Transparencë jo vetëm për sa i përket hartimit të buxhetit, duke marrë edhe mendimin e kolegëve – kështu e mendoj drejtimin – me qëllim që të ketë një sy kritik më tepër për sa i përket hartimit të buxhetit por edhe për sa i përket hartimit të një raporti përfundimtar, në fund të vitit, të shpenzimeve, për mënyrën se si janë kryer, dhe bërja të ditur kolegëve.

Për sa i përket pikës së tretë të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të menaxhimit të burimeve materiale – për sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, ku do të fusja në mënyrë të përmbledhur edhe solemnitetin në gjykim të gjyqtarëve, do të fusja shpërndarjen e listë prezencës të përditshme në gjykatë, me qëllim që të evidentohet jo vetëm performanca e administratës gjyqësore por edhe performanca e trupës gjyqësore. Do të fusja në këtë pikë edhe rekrutimin e administratës gjyqësore mbi baza merite, duke qenë se në pjesën më të madhe të stafit, kompetencën e ka kryetari për ta rekrutuar, me qëllim që të mund të punësojë njerëz që me të vërtetë e meritojnë të jenë në këto struktura të drejtësi-dhënies.

Në mënyrë të përmbledhur, këto ishin pikat kryesore. Ajo që do të desha të shtoja është edhe për sa i përket sistemit, duke qenë se aktualisht është instaluar sistemi ICMIC i

menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe i shortit, i cili duhet të jetë transparent për trupën gjyqësore dhe për publikun, në kuadër edhe të transparencës.

Sigurisht ka nevojë për përmirësim, ndonëse ushtrijmë funksionet në kushte normale, ka nevojë për përmirësim në drejtim të ambienteve, në drejtim të sigurisë në gjykatë sepse kemi nevojë për një punonjës sigurie. Detyra të cilat në vazhdimësi mendoj se do t'i realizoj. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, faleminderit edhe ju!

Po, Zoti Ministër!

Nasip Naço: Faleminderit!

Pyetja ime është, se sa herë jeni vlerësuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë? - pyetja e parë. Dhe pyetja e dytë, në lidhje me ligjin, sa herë e parashikon ligji se duhet të vlerësoheni për të konkurruar për kryetar të gjykatës?

Sokol Ibi: Faleminderit, Zoti Ministër!

Pikësëpari, desha t'i përgjigjesha pyetjes së parë. Jam vlerësuar një herë nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kam marrë vlerësimin "Shumë mirë" për vitet 2007-2009, vite të cilat kam filluar ushtrimin e funksionit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, pas mbarimit të Shkollës së Magjistraturës dhe kryerjes së stazhit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa i përket pyetje së dytë – po jap mendimin tim, besoj mendimin tim kërkuat – mendoj se nuk është detyra ime të kem vlerësim të dytë dhe nuk është ky qëllimi i ligjit. Është detyra e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e organeve shtetërore, të më vlerësojnë, sepse unë kushtet i kam plotësuar, domethënë kushtet e punës. Ideja e ligjit është që të kesh vjetërsi për mendimin tim - vjetërsi pune. Pastaj vlerësimi nuk është detyrim i imi, është detyrë e këtij organi të nderuar të vlerësojë gjyqtarin dhe mos vlerësimi im përsëdyti nuk duhet të përbëjë pengesë ligjore për të hyrë në garë, për sa kohë që është marrë një vendim që jam pjesë e kësaj gare, mendoj se duhet respektuar si vendim dhe duhet votuar.

Bujar Nishani: Po, faleminderit!

Tjetër pyetje?

Unë e kam një pyetje. Zoti gjyqtar, në eksperiencën tuaj të deritanishme, me përafërsi, në raportet e konflikteve shtet-individ, si është % e çështjeve të fituara, përafërsisht?

Sokol Ibi: Faleminderit, Zoti President!

Përafërsisht, në konfliktet gjyqësore, sepse Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë (gjykatat administrative) e kanë natyrë të punës së tyre që njëri palë e kanë shtet në përgjithësi, përgjithësisht konfliktet janë të fituara nga individët – i saktë mbase s’jam në statistikat e mia – mbi 50% të fituara nga individët. Domethënë një % më të madhe janë fituar nga individët.

Bujar Nishani: Ju falenderoj!

Po, Zoti Ministër!

Nasip Naço: A ka ndikuar mosplotësimi i vendeve vakante në ushtrimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, kur dihet që 50% nuk janë emëruar në këtë gjykatë?

Sokol Ibi: Mendoj se ka ndikuar. Ka ndikuar në drejtim të zvarritjes së gjykimeve. Jo vetëm mungesa e dy gjyqtarëve, por edhe mungesa e stafit, që për fat të mirë, sivjet u plotësua – edhe mungesa e stafit. Kjo ka çuar në zvarritje të gjykimit, në mosfunksionimin normal të gjykatës, për shkak se unë e presupozoj, mendoj që është një staf gjyqtarësh i përgjysmuar dhe një staf administrate i përgjysmuar dhe kemi përballuar një volum të madh pune me këtë staf të përgjysmuar dhe kjo ka sjellë si pasojë që të zvarriten gjykimet, jo për faj të gjyqtarëve, përtej asaj çfarë pritej ose do të gjykohehe më shpejt nëse stafi do të ishte i plotësuar. Këtë ka sjellë si pasojë pra, jo se nuk kemi përballuar. I kemi përballuar, madje i kemi gjykuar përtej limiteve njerëzore, do të thosha.

Bujar Nishani: Po, mirë atëherë, ju falenderoj dhe vlerësoj prezencën tuaj. Së bashku mbaruam. Mund të shkoni!

(Gjyqtari Sokol Ibi largohet nga salla e mbledhjes.)

Atëherë, përpara se të kalojmë në procesin e votimit, ka ndonjë koment, ndonjë kërkesë?

Mirë, ju lutem, komisioni që ishte, të organizojë votimin.

(Pasi fletët e votimit firmosen nga tre anëtarët e komisionit, shpërndahen dhe pas votimit rezultoi si më poshtë.)

Hysen Saliko: Mirë atëherë ta shpallim rezultatin?

Komisioni, pasi numëroi fletët e votimit, rezultoi se kanë marrë pjesë në votim 13 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. 3 nga këto janë fletë të pavlefshme, pasi kanë votuar kundër të dy kandidatëve. 7 (shtatë) vota ka marrë kandidati Sokol Ibi dhe 3 (tre) vota kandidatja Etleva Gjamo. Në përfundim, komisioni shpall si fitues gjyqtarin Sokol Ibi për postin e kryetarit të Gjykatës Administrative Korçë.

Bujar Nishani: Po, faleminderit!

Atëherë ka shpjegim vote?

S'ka.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 9, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 8 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Bujar Nishani*** (kryetar)
- 2. Nasip Naço*** (anëtar)
- 3. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 4. Flamur Kapllani*** (anëtar)
- 5. Dritan Caka*** (anëtar)
- 6. Gjini Gjoni*** (anëtar)
- 7. Ilir Mustafaj*** (anëtar)
- 8. Hysen Saliko*** (anëtar)
- 9. Tritan Hamitaj*** (anëtar)

- 10. Astrit Haxhialushi* (anëtar)
11. Sokol Çomo (anëtar)
12. Albana Shtylla (anëtare)
13. Vangjel Kosta (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori dhe Zoti Artan Broci.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.*
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.*

RENDI I DITËS:

8. Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Bujar Nishani: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës (*sipas procesverbalit i bie pika 8*). Zhvillimi i procedurës për emërimin e kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Dritan Caka: Zoti President, në lidhje me këta, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, rezulton që të dy kandidatët kanë kërkuar shtyrjen për sot.

Bujar Nishani: Dakord.

Kandidatë që konkurrojnë dhe që kërkojnë shtyrje, hera e parë që po ndesh unë.
Është sëmure njëri?

Mirë, në qoftë se është sëmure njëri, dakord.

Mirë, përderisa nuk janë, do ta shtymë.

Dakord atëherë, e shtymë për mbledhjen e ardhshme.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i raportit të Inspektoratit "Mbi procedimin disiplinor të gjyqtarit Albano Çepele".

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 10, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 9 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|-------------------------|
| <i>1. Bujar Nishani</i> | <i>(kryetar)</i> |
| <i>2. Nasip Naço</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Flamur Kapllani</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Dritan Caka</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Gjini Gjoni</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Mustafaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Hysen Saliko</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Tritan Hamitaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

- 10. Astrit Haxhialushi* (anëtar)
11. Sokol Çomo (anëtar)
12. Albana Shtylla (anëtare)
13. Vangjel Kosta (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori dhe Zoti Artan Broci.

Shënim 2: Zoti Broci hyn në sallën e mbledhjes në fillim të shqyrtimit të kësaj pike, por del nga salla serish.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.*
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i raportit të Inspektoratit “Mbi procedimin disiplinor të gjyqtarit Albano Çepele”.

Bujar Nishani: Pika 10 e rendit të ditës (*sipas procesverbalit i bie pika 9*): Shqyrtimi i raportit të Inspektoratit mbi procedimin disiplinor të gjyqtarit Albano Çepele.

Është paraqitur gjyqtari?

Urdhëro?

Ka paraqitur raport.

Atëherë, është depozituar një kërkesë, Albano Çepele, përfaqësuar nga studio ligjore T&N, avokat Ferdinand Caka. Objekti: “Kërkojmë shtyrjen e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor të gjyqtarit Albano Çepele”. Drejtuar: Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjyqtari Albano Çepele për arsye shëndetësore është në pamundësi për të qenë prezent në këtë mbledhje. Për gjyqtarin Albano Çepele është lëshuar raport shëndetësor për tre ditë, nga data 28.04 deri në datën 01.05. Lutem që të pranohet kërkesa për shtyrje të kësaj mbledhjeje, pasi gjyqtari Albano Çepele kërkon që të jetë personalisht prezent në shqyrtimin e kësaj çështje. Bashkëlidhur kërkesa dhe raporti mjekësor. Prokura e avokatit që ka bërë kërkesën.

(Zoti Broci hyn në sallën e mbledhjes, por ridel sërish.)

Mirë atëherë, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Dakord?

Po, Zoti Ministër!

Nasip Naço: Unë mendoj që pavarësisht nga kërkesa, Inspektorati duhet të bëjë verifikim e pretendimeve të dhëna nga vendimi i Gjykatës së Lartë. S’ka të bëjë me vjen apo s’vjen në rastin konkret gjyqtari. Kur të vijë, të këtë një material të përgatitur nga Inspektorati, nga detyrat e lëna, sipas vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Faleminderit!

Bujar Nishani: Me sa di unë, është përgatitur nga Inspektorati.

Marsida Xhaferllari: Ne kemi përgatitur një material përmbledhës ku përshkruhen e gjithë ecuria e këtij procesi, që nga fillimi i verifikimeve, paraqitja e kërkesës së Ministrit, procedimi disiplinor në KLD dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, dhe kemi nxjerrë ca sugjerime, që nga faqja 13 e në vijim të këtij raporti, ku kemi sugjeruar që në qoftë se KLD-ja çmon, Inspektorati mund të urdhërohet të plotësojë verifikimin e vetë, se cili ka qenë shkaku përcaktues në vonesat e konstatuara të gjyqtarit Albano Çepele; për të saktësuar llojin e sëmundjes të gjyqtarit Albano Çepele, por edhe marrjen e të dhënave në gjykatë mbi raportet eventuale që ai mund të ketë paraqitur përgjatë vitit 2012, që përkohë me kohën e inspektuar. Mund të verifikohen edhe kërkesat apo njoftimet eventuale të gjyqtarit tek kryetari i gjykatës apo KLD për gjendjen e tij shëndetësore, për të njëjtën periudhë.

Gjithashtu, në qoftë se KLD-ja e çmon të nevojshme, mund të urdhërohet edhe një ekspertimi i gjendjes fizike të gjyqtarit Albano Çepele, për të përcaktuar llojin e sëmundjes që ai ka, sepse ai e ka ngritur këtë pretendim që në momentin që është njoftuar nga Ministri i Drejtësisë mbi procedimin disiplinor edhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por edhe në Gjykatën e Lartë. Problemi që ne kemi konstatuar është që akti mjekësor i paraqitur prej tij është i vjetër në kohë. Përkon 2 vjet përpara kohës së verifikimit dhe nuk e dimë si cila është gjendja aktuale fizike e tij.

E dyta, duke mos ditur dhe llojin e sëmundjes konkrete, ka nevojë ndoshta edhe të saktësohet se çfarë impakti ka kjo sëmundje tek aftësitë e tij fizike për të përmbushur detyrën.

Këto janë çështjet kryesore që ne kemi ngritur. Sigurisht, pastaj mbetet edhe problemi që të gjitha këto duhen pasqyruar në vendimmarrjen eventuale të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Nuk e dimë në qoftë se pastaj gjyqtari Albano Çepele, kur të dëgjohet sërish në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, do ngrejë pretendime shtesë, apo jo?!

Bujar Nishani: Mirë, dakord.

Atëherë, pretendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pavarësisht materialeve që ka paraqitur, kërkon që të urdhërohet, nëse e shikon të arsyeshme Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për verifikim shtesë.

Zoti Ministër, çfarë mendimi ke?

Dakord.

Po, Zoti Gjoni?

Gjin Gjoni: Faleminderit, Zoti President!

Po t'i referohesh vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, Gjykata e Lartë në gjithë arsyetimin e vetë, ndalet në dy momente: Duhet shkarkimi i tij për shkak të shkeljeve të rënda të cilat kanë pasjellë uljen e figurës sipas dispozitave ligjore për të cilën është bërë; apo për shkak të sëmundjes. Të ndahem momenti në arsyetimin e vendimit. Kjo ka qenë. Dhe në rast se do ecim paralelisht me të dyja, atëherë në përfundim të arrihet në konkluzion, për shkak të situatës së krijuar ose pamundësisë reale për të ushtruar funksionin, për shkak të sëmundjes. Se ky është qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pra vendimmarrja ose për njërin, ose për tjetrën. Në rastin për sëmundjen, duhet të verifikohet. Është në atë situatë që sëmundja mund të

pasjellë pamundësinë e tij për të vajtur në punë ose ka pasjellë për pasojë edhe qëndrimin e tij në lidhje me vendimmarrjen? Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, tjetër mendim?

Po, Zoti Hallunaj?

Dritan Hallunaj: Atëherë, unë personalisht kam mendimin që proceduralisht ne të jemi në rregull, mendoj që duhet ta shtymë njëherë dhe pastaj seanca plenare të vijojë kur të krijohen kushtet për një mbrojtje sa më efektive, se çdo veprim që mund të bëjmë mund të na vlerësohet si nul nëse nuk respektojmë procedurën.

Prandaj unë jam i mendimit që në momentin që kemi një kërkesë për shtyrje apo një raport, të pranohet ajo, të shtyhet për një datë tjetër dhe pastaj në vijim të konkludojmë për hapat që do ndërmarrim nëse duhet akt ekspertimi apo... Faleminderit!

Bujar Nishani: Atëherë, juve Zonja Marsida, për çfarë të dhënash shtesë keni nevojë të merrni nga gjykata?

Marsida Xhaferllari: Vetëm për të parë se si ka qenë frekuentimi në punë, në detyrë i gjyqtarit, për 10 muajt e vitit 2012, kur ai ka patur këto vonesa në arsyetimin e vendimeve. Pra, nëse ka patur mungesa me raport mjekësor nga njëra anë dhe e dyta, çfarë raportesh zyrtare ka patur me kryetarin e gjykatës, nëse ai ka kërkuar zyrtarisht me shkrim kryetarin të gjykatës, faktin e mbingarkesës në punë, të gjendjes shëndetësore dhe të këtë pasur një qëndrim nga kryetari i gjykatës. A është përjashtuar nga shorti në këtë periudhë për këto arsye që ai ka pretenduar apo jo?

Bujar Nishani: Vetëm kaq?

Marsida Xhaferllari: Vetëm kaq!

Ndërsa pjesa e ekspertimit, ne nuk kemi kapacitete në Inspektorat që të bëjmë ekspertin mjekësor.

Bujar Nishani: Mirë.

Propozim tjetër për Inspektoratin, përveç kësaj kërkesë që ka Inspektorati?

Unë jam dakord që ne të kërkojmë dhe praninë e gjyqtarit. Gjithsesi, në momentin e pranisë së gjyqtarit duhet të kemi një raport të plotë me të gjitha të dhënat e ofruara nga Inspektorati, në varësi edhe të kërkesës që ka ardhur nga vendimi i Gjykatës së Lartë.

Ka ndonjë sugjerim tjetër?

Po, Zoti Mustafaj!

Ilir Mustafaj: Ndoshta do ishte mirë që, në vazhdim të asaj që tha Kryeinspektorja që do marrim këto raportet mjekësore që ka paraqitur dhe që i pranon vetë gjyqtari, ndoshta edhe mundet që nga një ekspert përkatës i fushës psikiatriko-ligjore ne të marrim mbi bazën e këtyre raporteve që na sjell, që çfarë përfaqëson kjo lloj sëmundje? A e bën të aftë apo s'e bën të aftë gjyqtarin? Se realisht gjyqtari i ka paraqitur raportet. Atëherë nuk po gjykojmë, le të themi, me këqyrjen e gjyqtarit, por të paktën po gjykojmë, atë që tha dhe Kryeinspektorja, po gjykojmë nga raportet mjekësore që ai ka paraqitur. Domethënë, në çfarë gjendje e çfarë përfaqëson? Ta marrim zyrtarisht, se deri më sot vetëm diskutojmë. Ne nuk e kemi zyrtarisht se çfarë përfaqëson sklerozë multiple.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Bujar Nishani: Janë trajtuar në fakt. Në fakt janë trajtuar dhe nga anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ilir Mustafaj: Unë të paktën mbaj mend që në diskutimin tim kam zbërthyer dhe kam gjykuar dhe për sa i përket diagnozës “sklerozë multiple”, të pranuar dhe nga gjyqtari. Nga ana ekspertëve është përcaktuar që, të paktën ato që kam pyetur ekspertë psikiatër, që në stade të avancuara, e bën të pamundur orientimin e individit me këtë lloj sëmundje. Faleminderit!

Bujar Nishani: Tani, se duhet t'i referohemi edhe protokollit të mbledhjes edhe vendimmarrjes së asaj mbledhjeje. Por unë jam i qartë në atë që është trajtuar. Janë argumentuar, jo vetëm nga personi, por edhe nga anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, arsyetimi i shkeljeve që kanë ardhur kryesisht për pasojë të problemit shëndetësor. Kjo është konsideruar si pamundësi edhe e plotësimit të funksioneve si gjyqtar.

Nuk e di, se kjo është eksperiencia e parë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë për trajtimin e një... nuk e di sesa hapësirë ka Këshilli i Lartë i Drejtësisë, qoftë dhe Inspektorati, për të kërkuar një ekspertizë mjekoligjore në rastin konkret?!

Marsida Xhaferllari: Mund t'i referohemi vetëm Kodit të Procedurave Administrative i cili ka rregulla për organin administrativ që të caktojë ekspertë për marrjen e njohurive të posaçme dhe nuk është se flet për ekspertim mjekoligjor, por flet për ekspertimin në përgjithësi. Sigurisht që mbetet edhe çështja e shpenzimeve, pavarësisht se Instituti i Mjekësisë Ligjore është një institut shtetëror dhe duan parapagim

dhe vendimi i KLD-së që mund të caktojë ekspertin, duhet të marri në konsideratë dhe kostot financiare të këtij procesi edhe pastaj edhe bashkëpunimin e gjyqtarit në proces.

Bujar Nishani: T'ia bëjmë kërkesë Ministrit neve, që t'ia marri institutit.

Jo, ne jse, duhet zgjidhur në parim njëherë.

Po, urdhëro Zoti Kapllani!

Flamur Kapllani: Për mua është rasti që ne duhet, krahas procedimit normal që është nisur thjesht për shkelje procedurale, është rasti që të hapim një procedent të ri për këto lloj problemesh sepse ai realisht është sëmure. Ne nuk mund të bëjmë sikur s'e shohim. Në e shohim, e njohim. Ai është në pamundësi për ta ushtruar atë detyrë. Ne që e njohim edhe e shohim përditë, ai është në pamundësi për ta ushtruar atë detyrë. Kështu që unë mendoj që është rasti që ne të bëjmë diçka më tepër vetë.

Gjin Gjoni: Me fal, Zoti President. Vendimi i Gjykatës së Lartë e ka dhënë në mënyrë taksative dhe duhet më shumë në rishqyrtimin e kësaj të merren në konsideratë të gjitha pikat të cilat ka lënë Gjykata e Lartë, për zbatim Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Sepse kjo konsiderohet si rast gjyqësor që Gjykata e Lartë e ka kthyer për rishqyrtim në organin administrativ dhe mbi bazën e kësaj të arrihet në konkluzion. Po iu referuam vendimit të Gjykatës së Lartë, për mua zgjidhja është, dhe nesër-pasnesër, mjafton që të zbatohet procedura dhe mos ketë shkelje të karakterit procedural. Për pjesën tjetër, çështja e zgjidhjes së themelit, pastaj ajo është çështje e vendimmarrjes së këtij Këshilli.

Bujar Nishani: Dakord.

Atëherë ky është proces tashmë në eksperiencën që ka Këshilli. Do të thirret personi. Do dëgjohet nga fillimi. Ministri, personi dhe nëse del pastaj dalin nga procesi argumente të cilat lidhen me gjendjen e tij shëndetësore, mund të autorizohet që të marrim dhe një mendim të specializuar.

Zoti Ministër!

Nasip Naço: Unë mendoj që të zbatohet vendimi i Kolegjeve të Bashkuara. Detyrat janë lëmë për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për Inspektoratin. Të bëjë ato verifikime që i lejohen Inspektoratit dhe mos të përdorim qëndrime subjektive të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe t'i fusim pastaj në vendim dhe të përdoren pastaj nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Pra, materiali ka qenë konkret, shkeljet kanë qenë konkrete, pretendimet për sëmurdjen janë paraqitur nga avokati

mbrojtës dhe tani merren si qëndrime subjektive të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, futen në material dhe kemi vendim të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

A e njohim që është sëmurë a jo? Unë besoj se nuk është objekt i shqyrtimit të kësaj kërkesë. Detyrat që kanë lënë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të verifikohen nga Inspektorati. Për aq sa i lejohen me ligj, të vijë një material dhe të thirret personi të gjykohet dhe të vazhdojmë procedurat. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, Zonja Marsida!

Marsida Xhaferllari: Dakord. Ne mund të vijojmë me verifikimin dhe mbledhjen e të dhënave që ka thënë Gjykata e Lartë, për ato akte që do gjejmë në gjykatë.

Bujar Nishani: Dakord.

Mirë atëherë, shtyhet për mbledhjen e ardhshme shqyrtimi i saj. Gjatë kësaj kohe, Inspektorati të rikonfirmojë dhe të rishqyrtojë të gjitha çështjet sipas raportit dhe njëkohësisht të rinjoftohet gjyqtari Çepele për t'u paraqitur në qoftë se... Megjithëse ai, mesa mbaj mend unë, as herën e parë kur është trajtuar, nuk ka qenë prezent, për shkak të pamundësisë fizike për të qenë. Gjithsesi, ne ta respektojmë procedurën.

Mirë. Dakord atëherë për ta shtyrë?

Mirë. Shtyhet edhe kjo pikë e rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme për gjyqtarin Çepele.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 278/2, datë 19.07.2011 "Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve".

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 11, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 10 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Bujar Nishani*** (kryetar)
2. ***Nasip Naço*** (anëtar)
3. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
4. ***Flamur Kapllani*** (anëtar)
5. ***Dritan Caka*** (anëtar)
6. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
7. ***Illir Mustafaj*** (anëtar)
8. ***Hysen Saliko*** (anëtar)

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| 9. Tritan Hamitaj | (anëtar) |
| 10. Artan Broci | (anëtar)* |
| 11. Astrit Haxhialushi | (anëtar) |
| 12. Sokol Çomo | (anëtar) |
| 13. Albana Shtylla | (anëtare) |
| 14. Vangjel Kosta | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës, Zoti Xhezair Zaganjori.

Shënim 2: Zoti Broci hyn në sallën e mbledhjes në fillim të shqyrtimit të kësaj pike.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.**
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.**

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 278/2, datë 19.07.2011 “Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve”.

Bujar Nishani: Pika 11 e rendit të ditës (*sipas procesverbalit i bie pika 10*): Shqyrtimi i projektvendimit për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 278/2, datë 19.07.2011 “Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve”.

Atëherë, nga grupi i punës, një prezantim të shkurtër, kush do të na e bëjë?

Zoti Broci?

Zoti Haxhialushi?

Caka?

(Zoti Gjoni flet pa ndezur mikrofonin.)

Marsida!

(Rihyn në sallën e mbledhjes Zoti Broci.)

Marsida Xhaferllari: Me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është ngritur grupi i punës për përmirësimin e vendimit “Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve”. Si material bazë janë përdorur rezultatet dhe rekomandimet e inspektimit tematik “Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve” dhe krahas tyre, vetë grupi i punës ka identifikuar edhe disa çështje për të përmirësuar këtë vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Konkretisht, janë shtuar rregullat, janë përmirësuar dhe janë detajuar ato, duke vendosur detyrimin e gjyqtarëve që ata të mos ushtrojnë veprimtari akademike në më shumë se dy institucione të arsimit të lartë. Është vendosur një rregull parimor që masa e shpërblimit të marrë nga gjyqtari nga veprimtaria akademike mos të tejkalojë masën e pagës së gjyqtarit. Dhe nga ana tjetër, të mos ketë një diferencë në trajtimin e gjyqtarit që ushtron veprimtari akademike me një person tjetër nga universitetet. Sidomos ky problem është evident tek universitet private.

Janë detajuar rregullat duke vendosur kritere për limitin kohor të angazhimit të gjyqtarëve në mësimdhënie, duke marrë për bazë vendbanimin, vendin e ushtrimit të detyrës dhe vendin e veprimtarisë akademike. Janë vendosur kritere në harmoni me sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve për aspektin kohor, sasior dhe cilësor të një gjyqtari, që kërkon të angazhohet gjyqtari në veprimtari akademike.

Është vlerësuar gjithashtu që të rritet bashkëpunimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit, duke vendosur një rregull për Këshillin e Lartë të Drejtësisë që brenda muajit janar të çdo viti, t’ përcillet informacion mbi të gjitha lejet e gjyqtarëve që janë autorizuar për mësimdhënie.

Mendohet që me anë të këtyre rregullave përmirësohet jo vetëm monitorimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi veprimtarinë akademike, por edhe për t’u shmangur,

për aq sa është e mundur, konflikti i interesit të gjyqtarit në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit dhe veprimtarisë së mësimdhënies.

Bujar Nishani: Dakord.

Diskutime?

Po, urdhëro Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Faleminderit, Zoti President!

Unë në radhë të parë, përgëzoj grupin e punës që më në fund arritën që të kemi një projektvendim dhe disa shtesa dhe ndryshime në lidhje me vendimmarrjen, pasi ka qenë një problematikë jashtëzakonisht shumë e trajtuar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me mësimdhënien.

Kisha dy komente në lidhje me pikën 5 - “Shtesa dhe ndryshime si vijon”: “Gjyqtarët mund të përfshihen në procesin brenda limitit kohor javor deri në 6 orë akademike”. Kam përshtypjen që duhet të përqendrohet, është më mirë që të përqendrohet në një ditë, në rast se mund të themi sepse 6 orë brenda javës, i bie që gjyqtari të shkëputet çdo një orë ose çdo dy orë të ikë nga puna dhe të shkojë për të dhënë mësim ose mund të vihet një... sepse në këtë mënyrë zgjedhje është një çikë e vështirë për të realizuar.

Jam dakord me pjesën tjetër që jo më shumë se dy institucione të arsimit të lartë në një vit akademik.

Kisha një, në lidhje me pikën e fundit që trajtoi Marsida në lidhje me: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, brenda muajit janar të çdo viti, i përcjellë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit informacion mbi autorizimet e dhëna për gjyqtarët dhe masat e shpërblimit të tyre”. S’besoj se është e nevojshme sepse ligji për konfliktin e interesave nuk e ndalon, as Kushtetuta nuk e ndalon mësimdhënien dhe pse duhet t’i japim informacion se kush nga këta? Pjesa tjetër është pjesë e deklarimit të pasurisë dhe shpërblimet që merren për shkak të mësimdhënies është pjesë që e deklaroi secili prej gjyqtarëve dhe jam dakord edhe me këtë kriterin 5-vjeçar që kanë vendosur që të jetë dhe të mos konsiderohen për mësimdhënien këta magjistratët e sapo përfunduar ose që janë në stazh, të cilët normalisht...

Dhe kërkoj që te pika e fundit: “Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për marrjen e masave për publikimin pa vonesë të këtij vendimi”. Në ç’kuptim e keni këtë? Sepse duhet që të gjithë kryetarëve të gjykatave, në rast se sot Këshilli i Lartë të Drejtësisë ka një vendimmarrje, a duhet të lihet për persona të cilët... duhet të ketë ndonjë dispozitë tranzitore për persona të cilët... kur hyn në fuqi? Për persona të cilët vazhdojnë të japin mësim, duhet të presin apo duhet të thuhet: “...deri në fund të vitit akademik”, që është qershori i këtij viti, pastaj hyn në fuqi? Se mund të kesh magjistratë të cilët aktualisht japin mësim, mund të kesh gjyqtarë të cilët kanë më pak se 5 vjet në ushtrimin... dhe kur i fillon efektet? Po pra, nga shtatori i 2015-ës, pra kur fillon viti akademik, në mënyrë që të rregullohet një herë e mirë. Ky pastaj t’u shpërndahet kryetarëve të Gjykatave e cila të jetë vendimmarrje ku të njihen secili prej atyre, që nesër pasnesër mos të na vijë që nuk është njoftuar kjo lloj vendimmarrje. Faleminderit!

Bujar Nishani: Tjetër?

Po, Zoti Broci!

Artan Broci: Më tepër për të dhënë një përgjigje për sa shtroi kolegu Gjoni. Në lidhje me nënpikën e parë që është lënë deri në 6 orë akademike brenda orarit zyrtar është marrë parasysh pikërisht vendbanimi dhe vendi i ushtrimit të detyrës. Pra, kemi lejuar në mënyrë direkte që një gjyqtar i Tiranës të japi deri në 6 orë në fakultetet e Tiranës, brenda ushtrimit të aktivitetit të tij në Tiranë. Ama, një gjyqtar i Vlorës dhe një gjyqtar, po themi ne, i Tropojës apo i Sarandës, nuk mund të japë deri në 6 orë në Tiranë apo jashtë qendrës ku ushtron sepse ashtu i bie që nga një orë në ditë, lë gjithë javën pa punë. Pra, kjo të merret parasysh rast pas rasti dhe e kemi lënë të hapur, pikërisht për të verifikuar, së pari, ku ushtron aktivitetin dhe ku është fakulteti që kërkon të japë mësim gjyqtari, në diskrecionin e inspektoratit, duke e lënë edhe këtë në verifikim.

Për sa i takon afatit në fakt, ne kemi gjykuar që duhet të paktën të ketë një eksperiencë 5-vjeçare gjyqtari, së pari, për të parë ngarkesën e atij gjyqtari që gjykatën që ushtron aktivitetin, për të parë ngarkesën në punë, si ka qenë ecuria e këtij gjyqtari dhe a është i aftë që të ushtrorë detyrën e gjyqtarit dhe pastaj edhe të lektorit. Dhe duhet një eksperiencë normalisht 5 vjet të të gjykuarit, meqenëse ka kritere për të qenë një gjyqtar apeli 7 vjet, u vendos një kriter që të jetë 3 deri në 5 vjet. Të ketë një eksperiencë pune për të parë edhe ngarkesën.

Dhe së fundi është lënë në diskrecionin e Këshillit se kur i shtrin efektet ky vendim, pra për dispozitën tranzitore. Jo pa qëllim është lënë bosh, pikërisht për t'iu referuar.

Inspektorati është vënë vetëm për shkak të ligjit për konfliktin e interesit, që gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit të nënshkruajnë një deklaratë. Në fakt edhe Gjykata e Lartë ka pasur një diskutim dhe ne gjykojmë se ligji mbi konfliktin e interesit nuk i shtrin efektet mbi gjyqtarin. Megjithatë, për sa kohë që gjyqtarët e shkallës së parë dhe gjyqtarët e apelit kanë nënshkruar një formular për deklarimin e interesit, të cilin e administrojnë sot institucioni i deklarimit të pasurive (ILDKP-ja), kemi menduar që Inspektorati t'i japi informacion këtij institucioni për të verifikuar në rastet e mundshme, nëse ka konflikt interesi të gjyqtarit që jep mësim me konfliktin. Jo për shkak të pagës që ai deklaron apo të ardhurave që ai krijon, por për shkak më tepër të konfliktit të interesit, për të verifikuar nëse ka gjykuar çështje apo ka pretendime të cilat mund t'i vijnë inspektoratit për çështje, të cilat lidhen me konfliktin e interesit, me subjektet që ai jep mësim atje. Në fakt gjyqtarit nuk i lejohet të gjykojë një çështje kur ai ka lidhje me institucionin. Parashikohet si në Kodin e Procedurës Civile, ashtu dhe në Kodin e Procedurës Penale, e drejta dhe detyrimi për të hequr dorë nga çështja, megjithatë është gjykuar në këtë pikëpamje që nuk ka ndonjë pengesë. Këshilli pastaj është në diskrecionin e tij për ta vendosur.

Dhe së fundi, për sa i takon, që e thashë, afatit të shtrirjes së efekteve së këtij vendimi, me të drejtë kolegu tha, -shtator 2015-ës, por mund të ketë dhe propozime të tjera. Prandaj është lënë e hapur. Faleminderit!

Bujar Nishani: Faleminderit!

Zoti Gjoni, atëherë, në lidhje me sqarimet që dha Zoti Broci për ndërhyrjet tuaja? Dakord me sqarimet për nënpikën?

Gjin Gjoni: Në parim jam dakord për të gjitha çfarë, thashë. Vetëm të caktojme këtë afatin. Por kjo e inspektoratit mua më duket një çikë... sepse prapë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë do të vijë të gjykohet dhe do jetë në vlerësimin kur jep dorëheqjen gjyqtari, kur përjashtohet për shkak të konfliktit të interesit.

Bujar Nishani: Për shkak të transparencës nuk ka asgjë të keqe pse çohet.

Po, Zoti Mustafaj!

Ilir Mustafaj: Faleminderit!

Një moment për problemin që ngritit Zoti Gjoni, që parafolësi im e sqaroi, është dhe një problem tjetër në rrugën akademike. 6 orë leksion në të njëjtën lëndë, një pedagog, një lëndë jep. Është e pamundur që të bëhen në një ditë, nuk mund të bëhet dot në bazë të ligjit “Për arsimin e lartë” ose në rregulloret që kanë marrë shkollat. 6 orë nuk mund t’i vësh dot realisht në një ditë. E ndalon rregullorja e shkollës. Kështu që jam dakord me sqarimin që bëri Zoti Broci, për arsytet pse ishte vendosur kjo pikë

Albana Shtylla: Përshëndes në fakt edhe propozimet e bëra nga grupi i punës për përgatitjen e këtij akti dhe për normimin e veprimtarisë së mësimdhënies së gjyqtarëve. Në fakt do të kisha vetëm një çështje për të kërkuar, ndoshta sqarim nga grupi, lidhur me parashikim për orët e mësimi gjatë orarit zyrtar.

Do doja të sillja në vëmendje që në legjislacionin në fuqi, për sa i përket nëpunësve civil, ka një standard të përcaktuar, ku nuk lejohet mësimdhënia ose kërkohet që orari zyrtar të përdoret vetëm për kryerjen e detyrave apo funksioneve që ato kanë. Në rastin e gjyqtarit ky lloj standardi i parashikuar në legjislacionin në fuqi për nëpunësit civil, a është mbajtur në konsideratë nga grupi i punës apo keni vlerësuar që pavarësisht kësaj, të keni një parashikim për mundësinë e mësimdhënies për gjyqtarët edhe gjatë orarit zyrtar? Faleminderit!

Artan Broci: Faleminderit, Shkëlqesi!

Në fakt, ne kemi ligjin e posaçëm dhe i referohemi drejtpërdrejtë Kushtetutës. Ne kemi gjykuar që ligji “Për shërbimin civil” nuk përfshin ato rregulla për gjyqtarët. Duke qenë se ligji jonë, pra ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe Kushtetuta njeh si të vetmin aktivitet për gjyqtarin mësimdhënien, ne e kemi gjykuar të pajtueshëm me Kushtetutën që, brenda orarit zyrtar, por në varësi gjithmonë të ngarkesës, gjyqtari mund t’i japi këto dhe prandaj kemi thënë duke patur parasysh edhe vendin e ushtrimit të detyrës dhe vendin e veprimtarisë ekonomike ku kërkon të ushtrojë. Prandaj kemi lenë diskrecion për të parë gjithmonë Inspektorati me shumë kujdes, sa orë kërkohen dhe sa është largësia midis vendit ku kërkohet dhe vendit ku do jepet. Kjo është.

Albana Shtylla: Në fakt nuk e vura në dyshim që dispozitat e nëpunësit civil nuk shtrihen tek gjyqtarët, prandaj dhe iu referova standardit. Por të paktën këtu kemi qenë të pranishëm në mbledhjet e vazhdueshme që kemi patur gjatë këtyre muajve në KLD, ku

në jo pak raste, pikërisht nga kjo trupë e nderuar është thënë që ngarkesa e gjyqtarëve është e konsiderueshme, madje-madje dhe kur kemi justifikuar për sa i përket kohëzgjatjes së arsytimit të vendimeve, e të tjera me radhë. Kështu që unë them nëse do ta mbajmë këtë lloj standardi, atëherë hajde ta diskutojmë dhe ta vlerësojmë, në rast të kundërt, okej, le të shikojmë rast pas rasti, duke prurë pastaj ndoshta një informacion të plotë kryetari i gjykatës, të normuar, normalisht mënyrën se si mund ta vlerësojmë rast pas rasti, le të themi çfarë ka patur çështje në ngarkim gjyqtarit gjatë vitit pararendës, në vitin aktual, kur do të jetë dhe mësimdhënia, e të tjera me radhë.

Megjithatë, unë me thënë të drejtën, do të dëshiroja që ashtu si dhe për nëpunësit publik, pavarësisht statusit të veçantë që kanë gjyqtarët, të kishim të njëjtin standard për të patur, le të themi, deri diku, një trajtim të njëjtë nga legjislacioni në përgjithësi në fuqi. Faleminderit!

Marsida Xhaferllari: Në fakt ne nuk duhet të harrojmë që ky vendim nuk po prezantohet për herë të parë, pra nuk po fillon sot veprimtaria akademike e gjyqtarëve. Ky është një projektvendim që ndryshon atë ekzistuesin. Tek ekzistuesi ne i kemi gjyqtarët të përfshirë në veprimtari akademike dhe nuk kishim fare limit kohor dhe nga inspektimi tematik ne na dolën raste gjyqtarësh që kishin më shumë se 6 orë në javë, në 2-3 universitete private, dhe mendojmë që është një hap përpara që kufizojmë masën deri në 6 orë në javë.

Nga ana tjetër i është dhënë e drejta Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të refuzojë kërkesën për mësimdhënie të gjyqtarit, nëse gjykata ku ai ushtron veprimtarinë ka një volum të lartë çështjesh gjyqësore, apo dhe në raste kur vetë gjyqtari ka problematikë në efikasitetin e vetë në detyrë. Kjo është dhe arsyeja që të gjitha kërkesat do të përpunohen paraprakisht dhe një muaj para fillimit të vitit akademik, propozohet në projektvendim, do të paraqitet një raport i detajuar mbi situatën e kërkesave në fjalë. Mendojmë që përmirësohet gjendja aktuale. Megjithatë, meqenëse po flitet për reformën në drejtësi, në qoftë se do ketë ndonjë rregullim specifik në ligj, vetë gjyqtarët ankohen që janë shumë të kufizuar, në ushtrimin

Albana Shtylla: Propozojeni e dashur, në KLD.

Gjin Gjoni: Faleminderit dhe ju kërkoi ndjesë që e marrë falën përsëri, por do të sqarohet dy momente.

Momentin e parë është dhe po e diskutoja dhe me Zotin Broci është afati 6 orë në javë dhe unë them që në rast se ne do shkojmë me këtë logjikë (6 orë në javë), i bie që një gjyqtar të bëjë rreth 24 orë në muaj. Të them të drejtën, i bie pak shumë, të jemi realistë. Atëherë, ne mund të themi 6 orë në javë, por jo më shumë se sa në muaj dhe e kufizojmë pak a shumë që edhe shpërndarjen ta rregullojnë vetë në këtë pikëpamje, sepse në rast se ne do vëmë një kufi 6 orë në javë, i bie që 26... po, 3 ditë në muaj... nuk e di se sa mund t'i bie.

Dhe aspekti i dytë, në rast se anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë do bien dakord, tek refuzimi, të thuhet, të shtohet një paragraf: “Në rast se pas marrjes së informacionit, pas marrjes së të dhënave dhe verifikimit të ngarkesës së punës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, mbi bazën e një inspektimi ose të dhënave që jep Inspektorati, të refuzojë”, pra që nesër-pasnesër mos të themi që është e parashikuar *blanshet* në vendimmarrje, vendim kuadër, që ne do miratojmë ndryshimet e sotme, por të thuhet që: “...mbi bazën e të thënave të cilat merren nga kryetari i gjykatës: shpejtësia në gjykim, dorëzimi i dosjeve”, të refuzohet, të ketë shkakun për të cilën duhet të realizohet. Faleminderit!

Ilir Mustafaj: Faleminderit, Zoti President!

Unë kam dy komente dhe një koment për Zotin Gjoni që përcakton që numri i orëve duhet të jetë.. e ndanë javore, me pjesën mujore. Në projektvendim përcaktohet që lejet do t'u jepen atyre gjyqtarëve që janë në rregull me ngarkesën, me cilësinë, kështu që një gjyqtar i mirë që e menaxhon kohën, e menaxhon çështjen, nuk ka asnjë problem në qoftë se është shumë mirë në pjesën e gjykatës dhe shumë mirë në pjesën tjetër, kështu që mos të haj ky merak i këtij problemi.

Problemi i dytë që kam me Zonjën Shtylla. Të keni parasysh që është ky vendim që do t'i shtrijë efektet, pra për veprimtarinë akademike, që ju mendoni që nuk duhet të jetë për pjesën e gjyqtarëve, shtrihet edhe për Shkollën e Magjistraturës, se këtu do jepet leja dhe për këtë pjesë, dhe i bie që në qoftë se ne do të themi që brenda orarit zyrtar, domethënë nuk do të ketë mësimdhënie për pedagoget, ata do ta ushtrojnë veprimtarinë ekonomike, atëherë i bie që Shkolla e Magjistraturës, do ta vazhdojnë mësimin pas orës 4:00 pastaj. Kur para disa ditësh, nga drejtori nderuar i Shkollës së Magjistraturës, na u shpërnda formulari, domethënë në lidhje për aplikimin për pedagog të jashtëm dhe në

dijeninë time është një numër i madh gjyqtarësh të cilët ushtrojnë veprimtarinë si pedagog i jashtëm i Shkollës së Magjistraturës.

Hysen Saliko: Për hir të së vërtetës, edhe unë numrin prej 6 orëve në javë, e konsideroj si një sasi e madhe. Mësuesit që japin mësim konsiderohen me normë normale kur japin 18 orë mësimdhënie në javë dhe ata paguhen. Tani që të thuash, të lejosh një gjyqtar të japë 6 orë në javë dhe 6 orë i shërben rruga që të shkojë deri në institucion, i thonë 12 orë në javë. 4 javë ka muaji, që i thonë 4 javë e gjysmë, i thonë 48 orë rreth 50 orë, i thonë 7 ditë në javë. Çka do të thotë që pavarësisht se sa i aftë është një gjyqtar, pavarësisht sesa i zoti do të jetë ky gjyqtar, një sasi prej 6 orë në javë unë e konsideroj si shumë të lartë dhe është e pajustificueshme. Ka gjyqtarë që janë kaq të prirur, pastaj Ilir që më mirë le të kalojnë në mësimdhënie pastaj. Unë s'kam dëshirë, Ilir.

Bujar Nishani: Propozim konkret Zoti Saliko keni?

Hysen Saliko: Unë propozim, 3 orë në javë, jo më shumë.

Bujar Nishani: 3 orë në javë.

Zoti Broci sepse ka që qëparë që pret fjalën. Pastaj, Zonja Shtylla!

Urdhëro, Zoti Broci!

Artan Broci: Jo pa qëllim është krijuar edhe grupi i punës por edhe Këshilli e ka patur të nevojshme që të normojë rregullat për mësimdhënie. Dhe ne jemi në një draft kuadër që i është propozuar Këshillit, pikërisht duke marrë për bazë shqetësimet. Ne kemi fatin e mirë që në Këshill kemi disa lektorë të së drejtës, duke filluar nga Zoti Zaganjori, nga Zoti Çomo, nga Zoti Kosta, nga Zoti Mustafaj, të cilët kanë parasysh dhe ciklin e leksioneve sa është. Pra, nuk kemi të bëjmë me një pafundësi të ditëve të punës së gjyqtarit për të dhënë këto leksione. Kuptohet, edhe koha që kërkohet të jepet për një cikël leksionesh dhe vendimi i tillë është, të dali. Jo pa qëllim është futur edhe koncepti i refuzimit, për të hequr edhe merakun e Zotit Gjoni, si me thënë, sepse do të jetë vendim individual, do të jetë vendim i arsyetuar nga ana e Këshillit. Arsyet se pse do të refuzohet: për shkak të ngarkesës pra. Mbasi më parë Inspektorati ndan ngarkesën. Sepse mund të kërkojë një gjyqtar, po themi ne, të japë 6 orë në javë. Por do i themi ne: -O Zotëri, ti ke 200 çështje në dorë. - Ti gjatë 1 viti apo gjatë 3 viteve, po themi, në qoftë se refuzohet, ti s'ke kapur normën që të ka vendosur Këshilli. -Si kërkon që të të jepet koha?! Pra, i gjithë procesi në tërësi do jetë një proces verifikimi paraprak, i cili pastaj do çojë në

vendimmarrje. Dhe në këtë pikëpamje është menduar ky vendim kuadër duke i lënë gjithmonë diskrecionin Këshillit për ta vendosur pranimin ose jo të kërkesës për mësimdhënie. Nuk është lënë një vendim që siç ishte deri tani që gjyqtari paraqiste kërkesën dhe ne e miratonim pa bërë asnjë lloj verifikimi ose e miratonim në heshtje. Është lënë pikërisht që të ketë disa momente dhe të verifikohet paraprakisht dhe si pranimi dhe si refuzimi të jenë në diskrecionin e Këshillit.

Bujar Nishani: Po, Zoti Mustafaj, urdhëro!

Ilir Mustafaj: E ndjej të nevojshme të bëj edhe një sqarim tjetër për kolegët e nderuar që kanë problem me punën e orëve. Në Shqipëri funksionon sistemi i Bolonjës. Çfarë do të thotë që kolegët e nderuar mos ta marrin që janë 30 javë në vit. 30 javë mësimore, shumëzim për 6 orë, baras me 180 orë. Por, lëndët janë semestrare dhe 6 javë presupozohen për një gjysmë semestri. Kështu që në qoftë se i japin 6 orë, do të jetë i angazhuar sepse vetëm një lëndë mund të japësh në fakultet, duhet të jesh i angazhuar vetëm me një semestër. Kështu që nuk llogaritet për pjesën tjetër. Kështu që besoj që e ka pasur parasysh edhe grupi i punës, që e ka parasysh edhe këtë fakt që ka vendosur 6 orë në javë.

Bujar Nishani: Zonja Shtylla e ka fjalën.

Albana Shtylla: Me thënë të drejtën e mbështes. Nuk diskutohet që në mësimdhënie të jetë dhe pjesa e gjyqësorit, pikërisht për ta pasuruar atë me praktikën gjyqësore dhe nuk diskutohet. Ideja është që për të gjetur një balancë të duhur ndërmjet asaj që është detyra funksionale e tyre dhe pjesa tjetër çfarë është e pajtueshme për të kryer si veprimtari në përputhje me funksionin e tyre. Ndoshta mund të gjendet një zgjidhje e mesme me 4 orë-shin, duke qenë se mund të jetë edhe një ngarkesë të paktën nisur nga ajo çfarë referoi Zoti Mustafaj për sa i përket krediteve, lektorë kryesisht, sepse nuk besoj se gjyqtarët janë seminaristë, mund të ketë edhe nga ata që janë seminaristë. Pra, maksimumi, për një lëndë semestrare mund të shkojë në tre orë në javë leksion, ja edhe një orë seminar, me përjashtim të, duke vendosur klauzolën, për Shkollën e Magjistraturës meqenëse e kishte merak Zoti Mustafaj dhe ashtu siç e parashikon edhe Ligji “Për Shkollën e Magjistraturës”. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, Zoti Hamitaj!

Tritan Hamitaj: Duhet të kemi parasysh që me Kushtetutë gjyqtari nuk bën dot asnjë lloj pune tjetër dhe që këtu fillon dhe shtjellohet më poshtë. Që do të thotë që mësimdhënia për mua duhet shikuar në aspektin që gjyqtari, atë pasuri të madhe që ka krijuar duke shërbyer si gjyqtar, ta përçojë tek të tjerët, t'ua japi studentëve dhe mos ta shikojë mësimdhënien si një marrëdhënie punësimi apo financiare që bën gjyqtari, por edhe shikojmë si një aset, që ta ndajë me të tjerët atë pasuri që ka krijuar dhe në këtë këndvështrim, këto 6 orë që mundet të japë gjyqtari leksione apo seminare në javë, ta shikojmë, maksimumi 6 orë, sipas asaj vlerës që përfaqëson ai. Kur është me tituj 'Doktor profesor', dhe zbret gradualisht dhe s'është e detyrueshme që 6 orë t'i japim një që sa ka bërë 5 vjet gjyqtar. Sepse vlera që ai përfaqëson dhe atë që ai mund të përçojë nuk mund të barazohet me një që ka gjithë ato grada dhe tituj dhe mezi e kemi dhe t'i japi ato 6 orë Iliri apo dikush tjetër. Ai tjetri që është me Master... Po pra, rast pas rasti, por duke marrë parasysh edhe individin.

Nasip Naço: Faleminderit!

Më vjen mirë që është futur në rendin e ditës dhe preket dhe veprimtaria akademike e gjyqtarëve. Sigurisht do të doja që të inkurajoja të gjithë ata gjyqtarë në këtë veprimtari akademike, duke ruajtur ato raportet dhe funksionon e tyre si gjyqtarë. Personalisht, që ditën e parë e kam zgjidhur dhe kam votuar në të gjitha rastet dhe do votoj për ata gjyqtarë që do japin mësim në Shkollën e Magjistraturës dhe në universitete publike. As kam votuar ndonjëherë për private dhe as kam për të votuar për sa kohë do të jem Ministri i Drejtësisë. Marr shkas edhe nga para disa muajsh kur një gjyqtar i ardhur këtu justifikonte 20 mijë dhe 40 mijë euro sepse kishte dhënë mësim. Kështu që gjërat janë edhe pak më larg asaj që përveç se duhet të japin mësim dhe për të justifikuar pasuritë e paligjshme të vëna. Faleminderit!

Bujar Nishani: Mirë atëherë, me sa shoh unë në tërësi diskutimet janë tek kjo ngarkesa më shumë, këtu po përqendrohen. Tani, ka një propozim të Zotit Saliko për 3 orë, një propozim të Zonjës Shtylla për 4 orë dhe drafti që është për 6 orë.

Deri në 6 orë.

Dakord.

Po, Zoti Kosta!

Vangjel Kosta: Mos do ishte më mirë, duke marrë shkas nga diskutimi i Zotit Ilir, mos ishte më mirë që të diskutojmë mbi numra orësh në bazë sezoni mësimor dhe jo në javë. Mbase mund të arrinim më kollaj kompromisin?

(Disa nga anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Bujar Nishani: Vetë programi i institucionit e disiplinon këtë, që të shkosh semestral ti.

(Disa nga anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Ilir, çfarë propozimi ke?

Ilir Mustafaj: Unë do të jem me atë që rast pas rasti t'i shikojmë. Domethënë i bie, çfarë përfaqëson, le ta lejmë në këtë pjesë dhe të gjykojmë këtu pastaj se çfarë përfaqëson kandidati.

(Disa nga anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Bujar Nishani: Atëherë kush është dakord me projektvendimin e paraqitur?

Kundra?

S'ka.

Miratohet.

Po, hyrja në fuqi është për vitin akademik që vjen, vitin akademik që fillon.

(Zoti Broci flet pa ndezur mikrofonin.)

Artan Broci: Pra të plotësohet kjo dispozita që kemi lënë bosh (neni 7): "Ky vendim publikohet pa vonesë në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe hyn në fuqi më 1 shtator 2015.

Bujar Nishani: Po. Dakord.

Gjin Gjoni: Prandaj përcaktojeni, në përfundim të vitit akademik.

Bujar Nishani: Me vit akademik. Dakord.

Artan Broci: Për efekt të procesverbalit atëherë nëse më lejohet.

Bujar Nishani: Po, urdhëro!

Artan Broci: Në nenin 7 të plotësohet "Ky vendim publikohet pa vonesë në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe hyn në fuqi në datën 01.08.2015.

01.07.

Gjin Gjoni: Më fal Tani, nuk mund të thuhet që ky vendim publikohet. Duhet të thuash: “Ky vendim hyn në fuqi dhe ngarkohet publikimi mbrapa”. Teknika legjislative nuk ta lejon.

Artan Broci: Dakord.

Marsida Xhaferllari: Një sugjerim i misionit EURALIUS, kërkon që vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë vijimësisht të publikohen në faqen zyrtare të internetit. Me ndryshimet që i janë bërë ligjit për QPZ-në, i është hequr mundësia që vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, megjithëse kanë karakter normative, të publikohen në fletoren zyrtare.

(Pa mikrofon: Po kjo ‘pa vonesë’?)

Po që mos ta vinim nën presion Sekretari i Përgjithshëm.

Bujar Nishani: Ajo të lihet domethënë. “Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të publikojë në faqen zyrtare”. Se ‘pa vonesë’ apo ‘me vonesë’ duket sikur shtojmë.

Dakord. Mirë.

Mbyllet dhe pika 11 (*sipas procesverbalit i bie pika 10*).

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i relacionit "Mbi disa propozime të grupit të punës për sistemin e pikëzimit për procesin e emërimit të gjyqtarëve në gjykata" të grupit të punës për sistemin e pikëzimit.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 12, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 11 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Bujar Nishani*** (kryetar)
2. ***Nasip Naço*** (anëtar)
3. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
4. ***Flamur Kapllani*** (anëtar)
5. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
6. ***Ilir Mustafaj*** (anëtar)
7. ***Hysen Saliko*** (anëtar)
8. ***Tritan Hamitaj*** (anëtar)

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| 9. Artan Broci | (anëtar) |
| 10. Astrit Haxhialushi | (anëtar) |
| 11. Sokol Çomo | (anëtar) |
| 12. Albana Shtylla | (anëtare) |
| 13. Vangjel Kosta | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori dhe Zoti Dritan Caka.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.**
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.**

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i relacionit “Mbi disa propozime të grupit të punës për sistemin e pikëzimit për procesin e emërimit të gjyqtarëve në gjykata” të grupit të punës për sistemin e pikëzimit.

Bujar Nishani: Kalojmë në pikën 12 të rendit të ditës (*sipas procesverbalit i bie pika 11*): Shqyrtimi i relacionit “Mbi propozimet e grupit të punës për sistemin e pikëzimit për procesin e emërimit të gjyqtarëve të gjykatave” për sistemin e pikëzimit.

Keni relacionin. Grupi i punës, Zoti Broci një përmbledhje.

Artan Broci: Besoj se kolegët e nderuar janë njohur me materialin, me relacionin shpjegues. Ka rezultuar që në vijimësi për shkak të konkurrimeve ka pasur pengesa dhe është dashur herë pas herë që Këshilli të investohet për gjyqtarët për të bërë vlerësimin e përshpejtuar. Ne kemi analizuar dhe propozojmë, përveç sa parashtrohet në material, që të krijojmë një vendim kuadër në këtë pikëpamje, që Inspektorati, në çdo rast kur paraqitet kërkesa për konkurrim për të cilët nuk është bërë vlerësimi i atij gjyqtari, të investohet pa pritur një vendimmarrje individuale për rastin konkret. Pra, në rastin, po marrë rastin e shkallës së parë për krime të rënda, një nga kandidatet – Naqellari - nuk ka, për shkak të qenies së saj në emërim në 2009, - nuk ka pasur vlerësim për 2005-2006 por përfiton për të bërë vlerësim për 2009-2010. Ka plotësuar kriterin ligjor 5 vjet për të konkurruar tek kjo gjykatë (tek krimet e rënda), por i mungon vlerësimi profesional. Në këto raste, duke qenë se ka një konkurrim që plotëson kriterin formal të ligjit për të pasur, por i mungon vlerësimi profesional, Inspektorati, me ardhjen e kësaj kandidature, të bëjë vlerësimin e përshpejtuar të kësaj kandidature, për të mos krijuar precedentin për ta skualifikuar si konkurrent nga konkurrimi. Në këtë pikëpamje është menduar që të hartohet një projektvendim tip, kuadër, për t'i dhënë të drejtën Inspektoratit për të realizuar vlerësimin e çdo kandidati për vendet vakante që shpallen, në mënyrë që të mos bëhet pengesë që të shtyhet pastaj edhe për çdo rast, nominalisht për secilin të shprehet Këshilli, të bëhet vlerësimi i përshpejtuar për këtë, të bëhet vlerësim i përshpejtuar për atë kandidat në mënyrë që të ketë edhe efikasitet puna.

Bujar Nishani: Dakord.

Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Faleminderit, Zoti President!

Unë bashkohem me raportin të cilin kanë paraqitur. Ky është edhe një shqetësim të cilin unë e kam diskutuar dhe me kolegët. Aktualisht ndodhemi në një gjendje që janë shpallur vendet vakante për gjykatat në disa, edhe në gjykatat e krimeve të rënda dhe gjykatat e niveleve të para. Po rrinë pa u emëruar magjistratët për shkak se nuk është realizuar sistemi i vlerësimit me procedurë të përshpejtuar të kandidatëve të cilët aktualisht kanë paraqitur kërkesën. Kështu që, jam plotësisht dakord që nëpërmjet një vendimi kuadër, të realizohet që të mos të vijmë në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të përcaktojmë se kush janë personat të cilët duhet të miratohen në

mbledhjen pasardhëse, por të vendosim që të gjithë personat të cilët paraqesin kërkesë për t'u promovuar dhe nuk kanë sistemin e vlerësimit në përputhje me procedurat ligjore, të realizohen nga Inspektorati vlerësimi me procedurë të përshpejtuar në mënyrë që mos të kemi pengesa dhe zvarritje të mëtejshme dhe kjo do të ishte më se e qartë dhe mbi bazën e kërkesave, duke plotësuar dhe kriteret ligjore, të realizohet dhe vlerësimi nga ana e Inspektoratit.

Përveç kësaj doja të shtroja dhe diçka, që nisur nga materiali i paraqitur rezulton që ka edhe një vend vakant që duhet plotësuar në komisionin e pikëzimit dhe duhet të caktohet një anëtar i cili duhet të vijë nga Parlamenti në rastin konkret, meqenëse dy janë gjyqtarë për shkak të dispozitave ligjore.

Në rast se mund të më lejoni Zoti President, unë propozoj Zotin Kosta që të jetë, meqenëse është më pak i ngarkuar.

Bujar Nishani: Po, të mbarojmë njëherë dhe pastaj të vijmë tek propozimet konkrete.

Në lidhje me projektvendimin e paraqitur, ka diskutime të tjera, mendime?

Po, Zoti Kosta!

Vangjel Kosta: Kam një sugjerim, që nëse është e mundur që e njëjta procedurë të aplikohet edhe për ata që kandidojnë për kryetarë gjykatash dhe që nuk plotësojnë kriterin ligjor të pasjes së dy vlerësimeve në momentin e aplikimit.

Bujar Nishani: Dakord. Të ezaurojmë njëherë pjesën përmbajtësore të vendimit dhe pastaj propozimet e reja të draftohen dhe të paraqiten për miratim.

Në lidhje me projektvendimin që kemi.

Po, zonjë...

Albana Shtylla: Prandaj po pyesja edhe kolegët.

Atëherë, ne kemi një vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që bën fjalë pikërisht për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve (261/2 të 2010), ku ka një dispozitë të posaçme ku trajton vlerësimin e përshpejtuar dhe është pikërisht neni 33, që do të thotë, ka patur një rregullim, bazuar kuptohet në dispozitat ligjore (neni 43 të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor"), një rregullim në vendimin e KLD-së për sa i përket kryerjes së procedurës së përshpejtuar dhe nëse ju kërkoni që ky proces i vlerësimit nga

ana e Inspektoratit të bëhet pa një vendimmarrje në KLD, ndoshta është vendi që ky parashikim i propozuar nga grupi i punës të përfshihet në këtë dispozitë.

Nëse do të pranohet pastaj, sa i përket propozimit të Zotit Kosta, duhet parë ku mund të përfshihet për rastin e kryetarëve të gjykatave, meqenëse këtu bëhet fjalë për sa i përket sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve. Faleminderit!

Bujar Nishani: Dakord pra, këtë thashë edhe unë, që të merremi me këtë që kemi përpara, pastaj kalojmë në çështje të tjera.

Tjetër?

Po, Zoti Broci!

Artan Broci: Me të drejtë është, po themi, edhe ndërhyrja e Zonjës Shtylla – s’po gjeja fjalën e duhur, të kërkoj ndjesë Albana. Është parashikuar në relacion, pikërisht kjo që thotë Zonja Shtylla. Në relacionin shpjegues që ne i kemi paraqitur Këshillit, në faqen 3, thuhet pikërisht procedura e vlerësimit të përshpejtuar është parashikuar në nenin 33 të vendimit 261 dhe mbi bazën e kësaj ne kemi propozuar edhe draftin për të bërë... Po, po. Për këtë është. Kemi ngarkuar Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të bëjë vlerësim profesional dhe etik me procedurë të përshpejtuar të kandidatëve që konkurrojnë në vendet vakante në gjykata, që nuk kanë vlerësim profesional dhe etik. Them: “Me procedurë të përshpejtuar, zbatuar në dispozitat e vendimit 261, pika 2 të sistemit të vlerësimit dhe që nuk bie ndesh me këtë vendim”.

Bujar Nishani: Mirë.

Tjetër?

Albana Shtylla: Si shtesë e nenit 33?

Artan Broci: Jo, e citojmë nenin 33.

Albana Shtylla: Megjithatë, Marsida mund ta rregullojë këtë pjesë mjaft mirë. Normalisht bëhet ‘shtesë në nenin kaq’, e të tjera me radhë.

Bujar Nishani: Dakord.

Kush ka diskutime të tjera rreth vendimit, projektit?

Kush është dakord me projektvendimin e paraqitur?

Kundra?

S’ka.

Miratohet.

Projektvendimi tjetër...

(Zonja Shtylla flet pa ndezur mikrofonin.)

Vendimi tjetër është që duhet plotësuar komisioni me anëtarin e ardhur nga Parlamenti. Propozime për anëtarët e Parlamentit.

Gjin Gjoni: Në qoftë se ka ndonjë zgjedhje me dëshirë, se tre janë këtu.

Bujar Nishani: Dakord

Gjin Gjoni: Në rast të kundërt, unë e bëra një propozim.

Bujar Nishani: Dakord. Do të sugjeroja që tre anëtarët e ardhur nga Parlamenti ta bënin propozimin. Po!

Artan Broci: Ne kemi dy komisione të cilat bëjnë pikëzimin dhe vlerësimin paraprak. Kemi një komision të vogël ku kemi Zotin Kosta dhe po ky komision i vogël pastaj përfshihet tek komisioni i madh, pra tek 5-ja, tek 7-ja, dhe aty është parashikuar që të ketë këto rregullime pastaj, 2 nga gjykata, Kryeinspektorja, përfaqësuesi i Ministrit, pra dhe kështu ka funksionuar edhe vitet e tjera.

Bujar Nishani: Atëherë tre anëtarët e Parlamentit të gjejnë një propozim.

Është Kosta.

Po mund të mendohet që të jetë dikush tjetër. Sokol, Albana, keni propozim për emrin e personit që duhet të paraqitet?

Vangjeli, dakord.

Sokol!

(Zoti Çomo përgjigjet pa ndezur mikrofonin.)

Sokol Çomo: S'kam propozim.

Bujar Nishani: Mirë atëherë, për Zotin Kosta?

Kundra?

S'ka.

Miratohet.

Mirë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, përpara se të shqyrtojmë aktet përfundimtare, ishim në pikën që e shtymë pra..

Artan Broci: Para se të kalojmë, jemi prapë te kjo.

Bujar Nishani: Po, më fal.

Artan Broci: Ka një moment të cilën desha ta sqaroj.

Në fakt ligji “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, parashikon që ky komisioni i madh drejtohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Po kështu, kjo është e parashikuar edhe te vendimi 274, pika 2, i datës 16 shkurt 2011 “Për organizimin dhe funksionin e komisionit të shqyrtimit të kandidaturave për gjyqtarë”. Atë në fakt që s’ka dashur ta thotë ligji, ne e kemi vendosur në një dispozitë ndaluese në këtë vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku kemi thënë që: “Mbledhjet e këtij komisioni, nuk janë të vlefshme pa pjesëmarrjen e Zëvendëskryetarit”, pra kemi vendosur një dispozitë ndaluese, ku ligji nuk e ka.

Bujar Nishani: Po në qoftë se kryetari nuk do të jetë prezent?

Artan Broci: Në një kohë që kemi dhe ligjin “Për funksionimin e organeve kolegjiale” në rastet e mungesën apo në rastet e vendit vakant po themi të Zëvendëskryetarit, mund t’i shtrijë efektet tek ligji “Për funksionimin e organeve kolegjiale” dhe e ka parashikuar qartë që komisioni drejtohet nga anëtari më i vjetër dhe besoj se mosfunksionimi i këtij komisioni, çon pastaj në bllokimin e gjithë procesit, prandaj them që është e nevojshme mbase të ndërhyjmë në këtë vendimmarrje, për shkak dhe të funksionimit të këtij komisioni, i cili bën dhe vlerësimin profesional dhe etik të kandidatëve dhe pikëzimin e tyre për vendet vakante për krimet e rënda, për apelet, për gjyqtarët e shkallës së parë, dhe njëkohësisht hap rrugën shpalljes së vendeve vakante për magjistratët, të cilët i kemi prej disa kohësh pa i emëruar, pikërisht të këtij procesi që ne kemi në vazhdim. Duke qenë se ne kemi mbetur dhe nuk kemi vende vakante për gjyqtarët, kemi mbetur duke mos bërë vlerësimin, për shkak të kësaj dispozite ndaluese.

Në këtë pikëpamje, unë do të propozoja nëse do të biem dakord, të bëjmë një ndryshim të vogël, nenin 2 të këtij vendimi, të hiqet pika 3 e cila ka këtë dispozitë ndaluese të funksionimit të këtij komisioni. Faleminderit!

Bujar Nishani: Dakord.

Normal, ne nuk kemi aktualisht Nënkryetar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Po, Zonja Shtylla!

Albana Shtylla: Për procedurë Zoti Kryetar. Nuk e di nesh propozimin është i formatuar me një projekt-akt, ndërkohë është shpërndarë në materialet e mbledhjes së KLD-së? Meqenëse mbajtëm standardin me Zotin Kosta që do të kemi një propozim të shkruar, do të kërkoja që edhe në këtë rast të kishim të njëjtën gjë. Faleminderit!

Bujar Nishani: Dakord. Të vijë propozimi me shkrim dhe ta fusim në rendin e ditës. Dakord.

Po, Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Ka një moment Zoti President, sepse në rast se ne do të shkojmë në këtë hulli që Albana ngre në lidhje me këtë, unë them që do të vonohemi dhe nja dy-tre muaj të tjerë për të emëruar.

Bujar Nishani: Dakord, le t'i mbajmë përgjegjësitë ne që kemi për t'i mbajtur.

Gjin Gjoni: Jo, jo vetëm një shfuqizim i vogël ose vetëm konsiderimi i asaj që 'mund të marri pjesë Nënkryetari', nuk jam dakord në momentin që juve propozoni që do të zgjidhet, por të hiqen dispozitat që konsiderohen të pavlefshme, sepse nuk mundet që kryetari të ketë votë mbi votat e këtyre, vetëm kjo dispozitë mundtë të rregulloj.

Bujar Nishani: Dakord, ta fusim propozimin me shkrim, me projektvendim, siç e thamë edhe për propozimin e Zotit Kosta dhe e shqyrtojmë.

Gjin Gjoni: Dakord. Faleminderit!

Bujar Nishani: Mirë.

Tjetër?

Artan Broci: Të kërkoj ndjesë Zoti President. Për të sqaruar, nuk është propozim normues por është propozim rregullues. Pra, ne kemi një dispozitë ndaluese e cila po nga ky Këshill është marrë, i cili nuk është në përputhje me ligjin, dhe nuk është propozim normues ky që jap unë dhe që duhet propozim me shkrim dhe projektvendim. Ky është një propozim normues, rregullues, i cili shfuqizon një pikë të cilën ne e kemi konstatuar gjatë punës tonë, e cila pengon veprimtarinë dhe ushtrimin e funksionit normal të këtij komisioni. Pra unë nuk propozoj që të kemi ne një akt të shkruar në mënyrën se si do të rregullohet veprimtaria e këtij komisioni. Kemi konstatuar që ky komision, për shkak të kësaj dispozite, i konsideron të pavlefshme mbledhjet për shkak të mungesës së tij. Në një kohë që ligji nuk e thotë. Dhe në këtë pikëpamje unë nuk propozoj që të normojmë.

Bujar Nishani: Dakord. Kuptoj.

Artan Broci: Jua bëj prezent dhe nuk besoj se duhet një propozim me shkrim apo të kemi një vendim kuadër për këtë punë. Ne thjesht vetëm rregullojmë normën e këtij vendimi që ka. Nuk është propozim për rend dite them unë, në koncept.

Bujar Nishani: Albana!

Albana Shtylla: Me thënë të drejtën, dëshiroja Zoti president, nëse do t'i hymë diskutimit për çështje të cilat janë të parashikuara në akte të KLD-së dhe që nuk janë të parashikuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së", atëherë do duhet të shikojmë të gjithë legjislacionin e prodhuar nga KLD-ja, kështu që për të patur një vendimmarrje sa më të mbështetur, të argumentuar, do të dëshiroja që kjo çështje të përfshihet normalisht në procedurë me një propozim projekt-akti konkret për t'u përfshirë në rendin e ditës të mbledhjeve të ardhshme të KLD-së. Faleminderit!

Bujar Nishani: Ne jse ky rishikimi i akteve është gjë tjetër. Ne e kemi kërkuar këtë, absolutisht, por ne nuk mund të bllokojmë punën e vendimmarrjes së një grupi, pse një anëtar i saj nuk është dhe kërkohet në mënyrë detyruese. S'është normale. Absolutisht s'është normale.

Mirë dakord. Atëherë, kush është dakord me propozimin e Zotit Broci, Shfuqizimin e... Si ishte propozimi Zoti Broci?

Artan Broci: Atëherë, propozimi është konkret. Neni 274, pika 2 të vendimit të datës 16 shkurt 2011 "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të kandidaturave për gjyqtarë", të behët ky ndryshim. Në nenin 2, të hiqet pika e tretë.

Bujar Nishani: Kush është dakord me propozimin e Zotit Broci?

Dy, katër, gjashtë, tetë (8).

Kundra?

Dy, katër, pesë (5).

Miratohet.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Zotit Osman Aliu.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 3, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 12 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Bujar Nishani*** (kryetar)
2. ***Nasip Naço*** (anëtar)
3. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
4. ***Flamur Kapllani*** (anëtar)
5. ***Gjin Gjoni*** (anëtar)
6. ***Ilir Mustafaj*** (anëtar)
7. ***Hysen Saliko*** (anëtar)
8. ***Tritan Hamitaj*** (anëtar)

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| <i>9. Artan Broci</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Astrit Haxhialushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Sokol Çomo</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>12. Albana Shtylla</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>13. Vangjel Kosta</i> | <i>(anëtar)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori dhe Zoti Dritan Caka.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.*
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i kërkesës së ministrit të Drejtësisë për pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Z. Osman Aliu.

Bujar Nishani: Mirë kalojmë në pikën e shtyrë të rendit të ditës (*sipas procesverbalit i bie pika 12*), për shqyrtimin e kërkesës të Ministrit të Drejtësisë për pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Zotit Osman Aliu. Zoti Ministër!

Nasip Naço: Faleminderit, Zoti President!

Jam vënë në dijeni nëpërmjet shtypit që gjyqtari Osman Aliu, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është dërguar për gjykim në këtë gjykatë. Në dijeninë time dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe të ndryshimeve ligjore të bëra, e pikërisht në ligjin nr. 101 të vitit 2014 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 21, paragrafi i dytë, shprehimisht thuhet: “Në rastin kur një gjyqtar merr cilësinë e të pandehurit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e gjyqtarit nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor të formës së prerë”.

Në dijeninë time, çështja është dërguar për gjykim. Kam bërë një kërkesë për t’u futur në rendin e ditës. Çështja është futur në rendin e ditës. Nuk besoj që ka vend për t’u diskutuar dhe për të thirrur gjyqtarin në rastin konkret. Kërkesa është e thjeshtë, me tre rreshta, por është kuptimplote. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, Zoti Mustafaj!

Ilir Mustafaj: Një pyetje kam, se nga dokumentacioni që kemi, a ka ndonjë dokumentacion të prokurorisë që është marrë? Se kështu, në televizion dhe në gjëra kemi dëgjuar, por të kemi ndonjë dokument zyrtar. Në qoftë se ka ardhur, na i sillni.

Bujar Nishani: Po, Zoti Broci!

Artan Broci: Jo, edhe unë për procedurë e kisha sepse dëgjova nga Ministri që tha që kam marrë dijeni nga mediat edhe thjesht për të pasur për procedurë një dokumentacion të shkruar, meqenëse Ministri i Drejtësisë ka akses edhe tek organi i prokurorisë por edhe mbi gjykatat, për të verifikuar, nëpërmjet inspektorateve, nëse është i vërtetë një fakt i bërë publik. Thjesht për të qenë korrekt.

Nasip Naço: Sigurisht, duke qenë korrekt në çdo rast me ligjin dhe pasi jam vënë në dijeni nëpërmjet shtypit, i kam bërë një kërkesë zyrtare Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është përgjigjur duke më sjellë bashkë me përgjigjen edhe kërkesën për gjykim në lidhje me gjyqtarin Osman Aliu, e cila është dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë. Po të lexoni kërkesën, aty thuhet që është marrë i pandehur. Pra edhe plotësohen kriteret ligjore dhe është Këshilli i Lartë i Drejtësisë ai që duhet të vendosë. Por kërkesa është bërë zyrtare. Përgjigja është marrë zyrtare bashkë me kërkesën për gjykim dhe besoj që nga ana procedurale gjërat janë konform ligjit. Faleminderit!

Bujar Nishani: Hamitaj! Pastaj, Zoti Gjoni!

Tritan Hamitaj: Atëherë, unë do të doja që ta normonim edhe për herët e tjera, që Këshilli i Lartë i Drejtësisë t'i drejtohet Prokurorisë së Përgjithshme që në çdo rast, kur një gjyqtar merret i pandehur, do të informojë menjëherë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Sepse në rastin konkret, iniciativa është marrë nga Ministri nëpërmjet mediave. Ndërkohë që Prokurori i Përgjithshëm duhet t'ia vërë në dijeni Këshillit të Lartë të Drejtësisë menjëherë sapo ka ndodhur një fakt i tillë. Jo të nisemi nga mediat, por të funksionojnë organet sipas ligjit. ...duke i kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm, që në çdo rast të na njoftojë kur një gjyqtar merret i pandehur. Të na njoftojë zyrtarisht. Ai të na bëjë shkresë neve që filan datë, e filan orë, gjyqtari është marrë i pandehur dhe ka bërë këtë veprë penale. Sipas fjalës që tha Ministri, Ministri ia kërkoi, ndërkohë që duhet ai të na raportojë kryesisht ne, jo me kërkesë.

Nasip Naço: Besoj që kërkesa mund t'i bëhet Prokurorit të Përgjithshëm. Por unë di që prokuroritë funksionojnë, në rastin në vazhdim...

Unë jam dakord dhe këtë punë kam. Kam bërë dhe kërkesa të tjera. Por prokuroria herë të merr të pandehur, herë si person nën hetim dhe është Këshilli i Lartë i Drejtësisë... Jua sjell kërkesën brenda javës dhe besoj se do vihej në pozitë të vështirë. Faleminderit!

Bujar Nishani: Po, Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Ligji e ka normuar në mënyrë takstative, po t'i referohesh ndryshimeve të ligjit, kur kërkesa shkon në gjykatë me cilësinë e të pandehurit dhe në rastin konkret, rezulton që ka ardhur një kërkesë. Për sa kohë që ka ardhur një kërkesë zyrtare, jemi në respektim të dispozitës ligjore dhe kërkohet të miratohet kërkesa e Ministrisë. Kaq!

Unë s'besoj se ka diskutime të tjera. -Jo po duhet, e jo po s'duhet.

Kërkesa është ligjore, është e mbështetur në ndryshimet e ligjore të cilat kanë ardhur. Ka një kërkesë në të cilin është i pandehur dhe të jepet pezullimi derisa të zgjidhet me vendim të formës së prerë, siç e parashikon ligji.

Nasip Naço: Dua të bëj një saktësim të vogël, duke lexuar fjalë për fjalë ligjin që të mos kemi keq interpretime. Pra, në nenin 21, paragrafi i dytë, thuhet: "Në rastin kur një gjyqtar merr cilësinë e të pandehurit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e gjyqtarit nga detyra derisa të merret vendimi gjyqësor i formës së prerë". Jo kur është

dërguar çështja për gjykim. Pra, që mos të krijoj ndonjëri ndonjë ide. Në momentin që merret i pandehur, që në atë moment vendos. S'mundet që dhe të jetë i pandehur dhe në darkë të japë gjykimin në shkallë të parë dhe pastaj të vijë tek prokurori tjetër e të merret në cilësinë e të pandehurit. Këtë ka patur parasysh ligjvënësi. Ne kemi bërë dhe dallimin e marrjes së të pandehurit, në bazë të nenin 34, nga veprimet e tjera që kryen prokurori. Faleminderit!

Bujar Nishani: Kush është dakord me propozimin e Ministrisë për pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Rrethit Gjyqësor të Kavajës, Osman Aliu?

Dy, katër, gjashtë, tetë, dhjetë, njëmbëdhjetë (11).

Kundra?

S'ka.

Miratohet.

11 pro.

Një (1) kundër.

Miratohet.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 13 (shitesë) e rendit të ditës me objekt: Mbi shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Zotit Dhimitër Pojanaku, mbështetur në vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nr. 15, datë 17.02.2015.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë është pikë shitesë (shiko procesverbalin e pikës së parë) dhe për shkak të procesverbalit është pika 13 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Bujar Nishani** (kryetar)
2. **Nasip Naço** (anëtar)
3. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
4. **Flamur Kapllani** (anëtar)
5. **Gjin Gjoni** (anëtar)
6. **Ilir Mustafaj** (anëtar)
7. **Hysen Saliko** (anëtar)
8. **Tritan Hamitaj** (anëtar)

- | | |
|-------------------------------|------------------|
| 9. Artan Broci | (anëtar) |
| 10. Astrit Haxhialushi | (anëtar) |
| 11. Sokol Çomo | (anëtar) |
| 12. Albana Shtylla | (anëtare) |
| 13. Vangjel Kosta | (anëtar) |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori dhe Zoti Dritan Caka.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.**
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.**
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.**
- 9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.**

RENDI I DITËS:

13. Mbi shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Zotit Dhimitër Pojanaku, mbështetur në vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nr. 15, datë 17.02.2015.

Bujar Nishani: Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës (*sipas procesverbalit i bie pika 13, shtesë*). Atëherë, kush është dakord për shkarkimin nga detyra për shkak të vendimit të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, e cila ka deklaruar fajtor gjyqtarin

Dhimitër Pojanaku dhe në vijimësi të këtij vendimi, bazuar në parashikimin ligjor, të shkarkohet nga detyra gjyqtari Dhimitër Pojanaku? Kush është dakord?

Po! U tha që do ta fusim në votim, pa procedurë.

Urdhëro, Zoti Ministër!

(Merr fjalën Zonja Shtylla.)

Albana Shtylla: Atë thashë që në fillim Zoti President.

Ah, më fal.

Në fakt siç e thashë edhe në fillim të mbledhjes, do të dëshiroja që mbledhja e KLD-së të zhvillohesh sipas rregullave të parashikuara, pra normalisht kemi pasur këtë çështje të përfshirë në rendin e ditës dhe për procedurë duhet t'i ishte paraqitur materiali paraprakisht anëtarëve të KLD-së për të bërë vlerësimet përkatëse për raportet, relacionet, aktet dhe për këtë arsye nuk votoja pro. Kjo është shpjegimi i votës time.

Bujar Nishani: Mirë.

Zoti Ministër, urdhëroni!

Nasip Naço: Dukë qenë se nuk e kam materialin parasysh, por do të doja që të saktësohet baza ligjore e përcaktuar. Të citohet dhe neni 147 i Kushtetutës, nëse nuk është vënë, ku gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore e fizike, për akte e sjellje... Por besoj që kemi një vendim të formës së prerë dhe përveç përcaktimit në ligj, të vihet dhe dispozita e Kushtetutës, neni 147 i saj. Faleminderit!

Bujar Nishani: Atëherë, me propozimin e... Urdhëroni, Zoti Gjoni!

Gjin Gjoni: Atëherë, bazuar në kërkesat e nenit 147, pika 6 e Kushtetutës dhe nenit 20 të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", ku thuhet se për statusin e gjyqtarit dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi... të vendoset.

Bujar Nishani: Pra baza ligjore.

Sipas propozimit të Zotit Ministër dhe të Zotit Gjoni. Dakord?

Kush është dakord për shkarkimin e gjyqtarit?

Dy, katër, gjashtë, tetë, nëntë (9).

Kundra?

Një, dy, ... katër (4) kundra.

Atëherë, miratohet dhe shkarkimi i gjyqtarit Pojanaku.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Zoti Hamitaj, fjalën!

Tritan Hamitaj: Gjyqtari aktualisht është i pezulluar nga detyra dhe nuk ushtron asnjë lloj funksioni.

Albana Shtylla: Jemi në frymën e ligjit.

Bujar Nishani: Albana, të lutem!

Albana Shtylla: Më vjen keq Zoti President, me thënë të drejtën po më ndodh sot një... Më falni, më falni një mijë herë. Po më ndodh sot një situatë pak e çuditshme. Ne mund të buzëqeshim që të gjithë këtu sa jemi anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kemi një ligj, kemi disa procedura, kemi disa rregulla, të cilat nuk janë në dëshirën e askujt për t'u zbatuar, ose jo. Kjo është me pak fjalë ajo çfarë unë përçolla, jo vetëm në këtë çështje që ju po diskutoni por edhe në atë pararendëse ku propozohet një rregullim. Hidhet një votim. Nuk ka rëndësi fare nëse është ndjekur procedura apo jo dhe vijohet më tej. Faleminderit!

Bujar Nishani: Mirë, faleminderit dhe ju!

Po, Zoti Tritan, mund të vazhdoni.

Tritan Hamitaj: Atëherë gjyqtari për mua – jo për mua, por me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është i pezulluar nga detyra dhe nuk ushtron asnjë lloj funksioni gjyqësor. Ai me sa di unë ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë dhe nuk i janë shteruar të gjitha rrugët e ankimit. Duhet të mbyllet njëherë procedura e ankimit. Të trajtohet edhe rekursi në Gjykatë të Lartë dhe... Ka marrë vendimi formë të prerë. Vendimi është i ekzekutueshëm, por ndërkohë gjyqtari nuk e ushtron detyrën dhe ne nuk kemi asnjë lloj shtrëngese ta bëjmë tani. Ndërkohë që presim edhe vendimin e Gjykatës së Lartë dhe njëherë e mirë pastaj i japim drejtim. Sepse ne mund të mblidhemi përsëri që ta kthejmë në punë atë. Mua nuk më duket serioze që sot e shkarkojmë dhe pas 6 muajsh Gjykata e Lartë jep pafajësi dhe ne e rikthejmë prapë në detyrë.

Bujar Nishani: Tjetër?

Zoti Çomo!

Sokol Çomo: Edhe unë votoj votën time kundër, për arsye procedurale, sepse kjo çështje u fut në rendin e ditës në kundërshtim me kërkesat që ka ligji “Për organizimin

dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që ato materiale që u shpërndanë, u shpërndanë gjatë mbledhjes, mbledhje e cila nuk ka pas qoftë edhe një ndërprerje, qoftë edhe një pushim, që të kishim mundësinë dhe t’i hidhnim sy edhe atyre akteve që u shpërndanë. Kështu që ne kemi qenë në pamundësi reale objektive, për të shqyrtuar rastin dhe për këtë arsye, votova kundër.

Bujar Nishani: Dakord.

Tjetër kërkesë për shpjegim vote?

Nuk ka.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit, për vitet 2007-2009, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve", për gjyqtarët:

1. Gjinovefa Gaba, Gjykata e Apelit Vlorë (Materiali i Inspektoratit "Mbi ankimin e gjyqtarës Gjinovefa Gaba për projekt-aktin e vlerësimit për periudhën 2007-2009").
2. Ramiz Lala, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.
3. Arben Zefi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
4. Nafije Curri, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
5. Dritan Caka, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
6. Emiljano Ruli, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
7. Enkelejda Softa, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
8. Klodiana Mema, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.
9. Elidon Papazisi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.
10. Matilda Shalla, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.
11. Albina Spaha, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 13, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 14 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Bujar Nishani (kryetar)*
- 2. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 3. Flamur Kapllani (anëtar)*
- 4. Gjini Gjoni (anëtar)*
- 5. Ilir Mustafaj (anëtar)*
- 6. Hysen Saliko (anëtar)*
- 7. Tritan Hamitaj (anëtar)*
- 8. Artan Broci (anëtar)*
- 9. Astrit Haxhialushi (anëtar)*
- 10. Sokol Çomo (anëtar)*
- 11. Albana Shtylla (anëtare)*
- 12. Vangjel Kosta (anëtar)*

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori, Zoti Dritan Caka dhe Zoti Nasip Naço.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*

7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.

9. Sokol Pasho, Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit, për vitet 2007-2009, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, për gjyqtarët:

1. Gjinovefa Gaba, Gjykata e Apelit Vlorë (Materiali i Inspektoratit “Mbi ankimin e gjyqtarës Gjinovefa Gaba për projekt-aktin e vlerësimit për periudhën 2007-2009”).
2. Ramiz Lala, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.
3. Arben Zefi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
4. Nafije Curri, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
5. Dritan Caka, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
6. Emiljano Ruli, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
7. Enkelejda Softa, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
8. Klodiana Mema, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.
9. Elidon Papazisi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.
10. Matilda Shalla, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.
11. Albina Spaha, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

***Bujar Nishani:** Mirë. Pika tjetër e rendit të ditës (sipas procesverbalit i bie pika 14): Shqyrtimi i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimeve për 2007-2009, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, për gjyqtarët: ... dhe është në vijim.*

Kemi ankimime?

Marsida Xhaferllari: Është një çështje që është e mbartur nga mbledhja e kaluar (ankimi i gjyqtares Gjinovefa Gaba).

Bujar Nishani: Po! Është paraqitur gjyqtarja?

Marsida Xhaferllari: Jo, është dëgjuar gjyqtarja dhe është lënë detyrë për Inspektoratin që t'ju bëjë një paraqitje të të dhënave. Është shpërndarë materiali. Është bërë analiza nga një inspektor tjetër, meqenëse një nga pretendimet kyç të gjyqtares ishte që kishte konflikte me inspektoren që kishte kryer vlerësimin.

Bujar Nishani: Po, po, më kujtohet.

Marsida Xhaferllari: Ka bërë analizën inspektori tjetër, po i seksionit të vlerësimeve, dhe konkretisht, inspektori Fatbardh Çoniku, i ka marrë një më një të gjitha pretendimet e gjyqtares dhe ka konkluduar që pretendimet e gjyqtares në përmbajtjen e vlerësimit, nuk qëndrojnë. Ky është konkluzioni që ka nxjerrë inspektori.

Bujar Nishani: Pra, pretendimet e gjyqtares nuk qëndrojnë edhe pas ri-ekspertimit.

Marsida Xhaferllari: Pas rishikimit të tyre nga një inspektor tjetër.

Bujar Nishani: Dakord.

Ka njeri pyetje në lidhje me procesin e rishqyrtimit?

Zoti Saliko!

Hysen Saliko: Detyra që i lamë Inspektoratit ishte që të verifikonte dhe të mbante qëndrim në lidhje me vlerësimin dhe me disa problematika që u konstatuan gjatë diskutimeve që ne, anëtarët e KLD-së, parashtruam gjatë debatit të vlerësimit të gjyqtares Gjinovefa Gaba.

Vërej se na është vënë në dispozicion një material prej 6 faqesh, material i cili duhet t'i vihej në dispozicion gjyqtares, e cila të debatonte ose të mbante qëndrim ndaj kësaj dhe pastaj ne të gjykojmë në lidhje me projekt-aktin e vlerësimit përfundimtar të gjyqtares.

Në kushtet kur ky akt nuk i është njoftuar gjyqtares, unë mendoj se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet. Faleminderit!

Bujar Nishani: Tjetër mendim?

Atëherë, kush është dakord për ta shtyrë?

Dy, katër, gjashtë, pesë (lapsus).

Kundra?

Tre (3).

Miratohet. Shtyhet.

Zoti Saliko, cila është kërkesa juaj përfundimtare?

Hysen Saliko: Kërkesa ime është që të njoftohet gjyqtarja për qëndrimin e mbajtur pas verifikimeve të akteve të saj dhe të japë shpjegimet për relacionin.

Bujar Nishani: Dakord. Të njoftohet që të jetë prezent në vlerësimin e rishqyrtimit. Dakord.

Mirë, atëherë vazhdojmë me të tjerat, Marsida.

Marsida Xhaferllari: Është gjyqtari Ramiz Lala, të cilit i është kryer vlerësim i përsheptuar, bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ka paraqitur ankim dhe me sa di, ka ardhur.

Bujar Nishani: Dakord. Të vijë atëherë.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari Ramiz Lala.)

Zoti gjyqtar, mirë se ke ardhur!

Ju kemi thirrur për t'ju dëgjuar në lidhje me pretendimin që keni paraqitur për projekt-aktin përfundimtar të vlerësimit tuaj për 2007-2009. Do t'ju dëgjojmë në mënyrë të përmbledhur juve për pretendimet dhe pastaj anëtarët e Këshillit nëse kanë pyetje dhe sqarime, do t'ju adresojnë dhe do të procedohet më tej me vendimmarrjen e Këshillit.

Në jemi të njohur me projekt-aktin, ashtu si edhe ju.

Tani do kalojmë në dëgjimin e pretendimeve tuaja. Urdhëroni!

Ramiz Lala: Faleminderit!

I nderuar Zoti Kryetar, Të nderuar anëtarë të KLD-së!

Unë Ramiz Lala, aktualisht gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, më datë 16.03.2015 jam njohur me projekt-aktin përfundimtar të vlerësimit tim, për periudhën janar 2014 – dhjetor 2014.

Referuar projekt-aktit përfundimtar, unë jam vlerësuar “Shumë mirë” për grup kriterin e “Aftësive profesionale të përgjithshme organizuese dhe zbatuese”, “Shumë mirë” për grup kriterin “Aftësitë profesionale, juridike dhe teknike”, “Mirë” për grup kriterin e “Aftësive të kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional”.

Me vlerësimin “Mirë” jam vlerësuar për shkak të mesatares aritmetike të rezultateve midis katër grup kriterëve: “Etika e gjyqtarit gjatë dhe jashtë procesit” – “Shumë mirë”, “Respektimi i solemnitetit dhe i disiplinës” – “Shumë mirë”, “Pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitetet profesionale dhe trajnuese” – “Mirë” dhe “Shkrime dhe botime të ndryshme me natyrë juridike” – “Pranueshëm”.

Brenda afatit ligjor kam ushtruar ankim kundër projekt-aktit përfundimtar, nëpërmjet të cilit kam kërkuar ndryshim pjesërisht të tij. Konkretisht, kam kërkuar të vlerësohem “Shumë mirë” edhe për grup kriterin “Pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitetet profesionale dhe trajnuese”, për kriterin “Aftësi në drejtimin e procesit gjyqësor”, që bën pjesë në grup kriterin e “Aftësive profesionale, juridike dhe teknike”.

Vlerësimi “Mirë” për kriterin “Pjesëmarrja dhe aktivizim në aktivitetet profesionale dhe trajnuese” është jo korrekt për shkak se, Shkolla e Magjistraturës, gjatë vitit 2014, ka organizuar 3 trajnime për gjyqtarët e gjykatës administrative dhe kam marrë pjesë në të 3 trajnimet e organizuara nga kjo shkollë, konkretisht: “Prokurimi publik dhe praktika e gjyqtarit”, e zhvilluar në 22-23 prill 2014; “E drejta administrative”, e zhvilluar në datën 2 dhe 4 korrik; “Legjislacioni tatimor dhe prokurimi publik”, zhvilluar më 14 nëntor.

Përveç trajnimeve të mësipërme të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës për gjyqtarët e gjykatës administrative, në të cilat unë kam marrë pjesë dhe jam pajisur me certifikatë përkatëse, në vitin 2014 kam marrë pjesë edhe në trajnimin me temë “Masat e sigurimit civil të padisë”.

Kam marrë pjesë në të gjitha trajnimet që ka organizuar Shkolla e Magjistraturës për trajnimin e gjyqtarëve të gjykatës administrative.

Përveç sa më sipër, në vlerësimin tim për këtë kriter, nga vlerësuesi nuk është marrë parasysh fakti se unë për vitet 2011-2012-2013 dhe 2014, plotësoj pjesëmarrjen maksimale të trajnimit prej 60 ditë (për 5 vitet e punës). Pra, në vlerësimin tim, nuk është marrë parasysh fakti i numrit të madh të trajnimeve, numri i ditëve që unë kam marrë pjesë gjatë viteve 2011-2012 dhe 2013. Nga Shkolla e Magjistraturës jam pajisur me vërtetim përkatës, ku plotësohet numri maksimal i ditëve që unë kam marrë pjesë në trajnime.

Nisur nga fakti se unë kam marrë pjesë rregullisht në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magistraturës, kërkoj të vendoset për këtë kriter vlerësimi “Shumë mirë”.

Kundërshtoj vlerësimin “Pranueshëm” për kriterin “Shkrimet dhe botimet e ndryshme të natyrës juridike”. Vlerësimi “Pranueshëm” për kriterin “Shkrimet dhe botimet e ndryshme me natyrë juridike” e kundërshtoj për faktin e pamundësisë reale për të bërë shkrime e botime për vitin 2014, pasi viti 2014 ka qenë viti i parë i organizimit dhe funksionimit të gjykatës administrative dhe ngarkesa në punë ka qenë e madhe, duke mos na u dhënë mundësia të bënim shkrime e botime.

Kundërshtoj vlerësimin “Mirë” për kriterin “Aftësi në drejtimin e procesit gjyqësor”, që bën pjesë në grup kriterin e “Aftësive profesionale juridike dhe teknike”. Sipas projekt-aktit të vlerësimit, jam vlerësuar “Mirë” pasi nga analiza e 15 vendimeve të cenuara nga 61 të ankimuara, ka rezultuar se në 6 raste janë ngritur nga gjykata më e lartë shkaqet e procesit të parregullt ligjor, me pasojë kthimin e çështjeve për rigjykim.

Vlerësimin e mësipërm, bërë në projekt-akt, e kundërshtoj për faktin se 10% e çështjeve të ankimuara dhe të cenuara nga gjykatat më të larta, tregojnë rezultat mjaft të lartë të zgjidhjes së çështjes dhe dhënies së drejtësisë. Nisur nga vetë përmbajtja e projekt-aktit të vlerësimit, i cili tregon se vlerësimi “Mirë” më është bërë për 6 çështje të prishura dhe kthyer për rigjykim nga gjykata më e lartë, në faktin se këto çështje përbëjnë 10% të çështjeve të ankimuara, në faktin se po të shikohen me hollësi vendimet e gjykatës dhe fashikulli ligjor i këtyre çështjeve, arrihet në konkluzionin se prishjet e tyre nuk janë për fajin tim. Konkretisht, për çështjen V.T. kundër Zyrës së Gjendjes Civile Përmet, me objekt: “Ndryshim kombësie”, çështja civile është pushuar për shkak se në seancën gjyqësore nuk janë paraqitur paditësit dhe përfaqësuesi i saj (avokati mbrojtës). Në sekretarinë e gjykatës dhe në seancën gjyqësore nuk kanë paraqitur shkak të ligjshëm për mos praninë e tyre. Në gjykatën e apelit, pas ushtrimit të ankimit kanë paraqitur një raport mjekësor, ku paditësja ditën e gjykimit është trajtuar me pushim për paaftësi të përkohshme në punë. Gjykata e apelit ka cenuar vendimin për mos hetim të shkaqeve të mosparaqitjes së paditësit, megjithatë, pranë saj nuk është justifikuar mos prania e avokatit mbrojtës në seancën gjyqësore në shkallën e parë.

Çështja civile që i përket paditësit B.F. kundër Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Përmet, etj., me objekt: “Detyrim regjistrim të pasurive të

paluajtshme”. Shkaku i prishjes është se vendimi është marrë në mos thirrjen në gjykim të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Nga vetë natyra e objektit të padisë, mos thirrja e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk përbën shkak për cenimin e vendimit. Organi që bën regjistrimin e pasurive është Zyra Vendore e Regjistrimit dhe jo Zyra Qendrore e Regjistrimit. Në gjykimin tim, vendimmarrja ime ka qenë e drejtë edhe për vendimet e tjera të cenuara nga gjykata më e lartë, megjithatë, duke marrë të mirëqenë vlerësimin e gjykatës së apelit për këto vendime, vlerësoj se vetëm 6 vendime të prishura të viteve 2011-2014 nuk mjaftojnë për të vlerësuar “Mirë” për këtë kriter, pasi vetëm potencialisht ndodh që vendimet të cilat i nënshtrohen vlerësimit të një gjykate më të lartë, mund të qëndrojnë të gjitha në fuqi.

Për sa më sipër, kërkoj që vlerësimi të jetë “Shumë mirë” edhe për grup kriterin “Pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitetet profesionale dhe trajnuese”; për kriterin “Aftësi në drejtimin e procesit gjyqësor” që bën pjesë në grup kriterin e “Aftësive profesionale juridike dhe teknike”. Me respekt, Ramiz.

Bujar Nishani: Zonja Kryeinspektore, cili është qëndrimi juaj në raport me pretendimet?

Marsida Xhaferllari: Në rastin konkret, gjyqtari, lidhur me çështjen e vlerësimit të angazhimit të tij në publikime dhe botime shkencore, kundërshton rregullat e vlerësimit, domethënë Inspektorati ka zbatuar rregullat e vlerësimit ashtu siç janë. Ai jep justifikimin që unë duhet të vlerësohem “Shumë mirë” për këtë grup kriter sepse nuk kam pasur mundësi që të angazhohem në shkrime. Kjo është një çështje rregulli që Inspektorati nuk i futet dot.

Lidhur me çështjen e paraqitjes së informacionit shtesë prej tij nga Shkolla e Magjistraturës për numër të lartë trajnimesh të zhvilluara prej tij jashtë periudhës së vlerësimit, ky është momenti i parë që paraqiten prej tij, megjithëse ai është njoftuar rregullisht për vlerësimin, madje ka qenë subjekt vlerësues i vetes sepse ka paraqitur edhe akte nga gjykata për shkak të funksionit të kryetarit të deleguar, nuk ka paraqitur pranë Inspektoratit as akt-vetëvlerësimi, as nuk ka kërkuar të intervistohet dhe as nuk ka ngritur ndonjë pretendim që të thotë që shiko se aktet që më janë grumbulluar mua janë të paplota. Kështu që në këtë moment ne shohim që është një akt i paraqitur në këtë moment dhe nuk mund të japim vlerësim. Mund të jetë ashtu siç thotë gjyqtari, për periudhën

pesëvjeçare. Ne kemi marrë vlerësimin vetëm për periudhën njëvjeçare, në bazë të informacionit të paraqitur zyrtarisht nga Shkolla e Magjistraturës.

Së fundmi, lidhur me aftësinë për të drejtuar procesin gjyqësor, ne i qëndrojmë vlerësimin që ka bërë Inspektorati, pasi mendojmë që në masën e vendimeve të cenuara, nga 15 vendime të cenuara gjithsej, 6 të kthyera për rigjykim nga gjykata e apelit, pa paragjykuar drejtësinë e vendimit të gjykatës së apelit, mendojmë që është një tregues që tregon që nuk kemi të bëjmë me një gjyqtar që shkëlqen. Vlerësimi “Mirë” dhe vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” është tregues i arsyeshëm në rastin konkret për aftësitë për të drejtuar procesin gjyqësor.

Bujar Nishani: Mirë, anëtarët e Këshillit kanë pyetje për gjyqtarin?

Zoti Gjoni!

Ose edhe për Kryeinspektoren.

Gjin Gjoni: Po, faleminderit Zoti President!

Duke marrë shkas nga paraqitja e materialit që z. Lala paraqiti përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në pikëpamjen tuaj, lidhur me trajnimet të cilat juve paraqisni, ndryshojnë përqindjen e vlerësimin, në rast se këto do merren të mirëqena, këto që ju paraqisni përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë në seancë plenare?

Ramiz Lala: I përgjithshmi nuk ndryshon, por i veçanti ndryshon.

Gjin Gjoni: Sa ndryshon ju lutem?

Ramiz Lala: Kriteri i tretë nga “Mirë” behët “Shumë mirë”.

Gjin Gjoni: Sa trajnime janë ju lutem?

Ramiz Lala: Gjithsej janë zhvilluar 3 trajnime. Në të 3 trajnimet jam thirrur dhe kam marrë pjesë. Kurse për 2011-2013 i kam depozituar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë të gjitha certifikatat që unë kam marrë pjesë dhe nuk e kam parë të nevojshme që të paraqesë edhe njëherë.

Gjin Gjoni: Dhe në tërësi, sa shkojnë ju lutem?

Ramiz Lala: 60 ditë në tërësi.

Gjin Gjoni: Shkojnë 60. Okej! Faleminderit! Kaq kisha.

Bujar Nishani: Tjetër?

Po, Zoti Mustafaj!

Ilir Mustafaj: Ndryshe nga Zoti Gjoni, pyetjen po ia bëj Kryeinspektore. Në qoftë se do të jenë të sakta këto informacione shtesë që u vunë sot për dijëni, do ta ndryshojnë rezultatin që ju keni vënë për gjyqtarin?

Marsida Xhaferllari: Në qoftë se periudha e vlerësimit do të ishte për 5 vjet, sigurisht që do të ndryshonte. Periudhën e vlerësimit ne e kemi për 1 vit. Domethënë, nuk mund të pranojmë që projekt-akti ka gabim, ka pasaktësi. Projekt-akti i është referuar rregullave të sistemit të vlerësimit të miratuar nga KLD-ja, që thotë: “Merre dhe vlerësoje gjyqtarin për 1 vit kalendarik”.

Gjin Gjoni: Edhe një pyetje për Kryeinspektoren.

Atëherë, sipas Kryeinspektore... por ligji parashikon që duhen në 5 vjet, 60 ditë. Në rast se zotëria në fjalë, gjyqtari, ka për 5 vjet 60 ditë dhe ka plotësuar kriterin ligjor, atëherë si mund të themi ne që zotëria në fjalë merret vetëm për një periudhë të shkëputur?

Bujar Nishani: Dakord. Sqarimin e dha. Ne i referohemi procedurës që bëjmë për 1 vit dhe i janë referuar të dhënave në 1 vit.

Gjin Gjoni: Ligji e thotë edhe që brenda 5 viteve duhen 60 ditë.

Bujar Nishani: Dakord pra. Ne këtë po rishqyrtojmë. Gjyqtari ka bërë ankesë. Prandaj ka institucione ankimore për t’i parë, për ta gjykuar nëse qëndron apo s’qëndron pretendimi.

Dakord. Tjetër pyetje?

Mirë, atëherë mund të shkoni zoti gjyqtar.

(Gjyqtari Ramiz Lala largohet nga salla e mbledhjes.)

Atëherë, ka ndonjë diskutim përpara?

Po, Zoti Saliko! Pastaj, Zoti Gjoni!

Hysen Saliko: Kam një diskutim që e kam mbajtur si qëndrim konstant në lidhje me uljen e vlerësimit të gjyqtarëve për shkak se nuk kanë pasqyruar ose nuk kanë shkruar shkrime dhe botime të ndryshme me natyrë juridike. Jo çdokujt gjyqtar i jepet për të shkruar dhe jo çdokush gjyqtar ka kohën e mjaftueshme për të qenë i qetë për të shkruar.

Në të tilla kushte, kur gjyqtari nuk ka mundësi për të shkruar ose nuk ka kohën e mjaftueshme, aq më keq kur ky ka qenë në gjykatë administrative, kur gjykata administrative, nga 4, ka 2 gjyqtarë, ne nuk mund të themi që ky gjyqtar duhet të

vlerësohet “Pranueshëm”, dhe për pasojë, dy nënkriteret e këtij grupi “Etika e gjyqtarit” dhe “Respektimi i solemnitetit” të jenë “Shumë mirë”, për shkak se ai nuk ka botuar shkrime të ndryshme me natyrë juridike të vlerësohet “Pranueshëm” dhe për pasojë, t’i shkojë rubrika “Mirë”.

Ne kemi mbajtur një qëndrim konstant, që shkrimet dhe botimet mund të shërbejnë për ta bërë gjyqtarin të shkëlqyer në të gjithë rubrikën, por jo me qëllim që ta diskriminosh.

Unë mendoj që mjafton të hiqet kjo rubrikë dhe ankimi i tij është i bazuar dhe mos të merremi me diskutime të tepërta pastaj. Edhe vetë Kryeinspektorja dhe Inspektorati nuk mundet ta pasqyrojnë nëpër akte. Kjo është pasqyruar për të gjithë gjyqtarët, për ata që s’kanë patur botime, për vetë faktin që vendimi i KLD-së për vlerësimet apo ligji e ka parashikuar si rubrikë më vete këtë zë edhe detyrimisht ka mbajtur këtë qëndrim të tillë. Faleminderit!

Bujar Nishani: Tani, problemi është që çfarë janë çështje që duhen rregulluar përmes akteve, duhen rregulluar përmes akteve. Tani, këtu është folur edhe në kuadrin e reformës në drejtësi, çështjet e sistemit të vlerësimit, sistemit të pikëzimit (të kriterëve) dhe këtu, me të drejtë, nga mjaft anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, janë ngritur çështje, qoftë vlerësimi për vjetërsinë në çështjet e pikëzimit, etj., etj, pra janë çështje të cilat nuk mund t’i zgjidhim me diskutime dhe me një vendimmarrje të tillë. Përderisa Inspektorati është i detyruar të respektojë një procedurë të parashikuar në aktet përkatëse, ne... Megjithatë, në parim unë jam dakord.

Hysen Saliko: Qëndrimi konstant – më fal, Zoti President – i Këshillit të Lartë të Drejtësisë kur ka ndryshuar ose ka shqyrtuar ankimet, ka qenë i tillë, që ne apriori nuk mund ta ndëshkojmë gjyqtarin për shkak se nuk ka kryer botime të ndryshme. Kjo ka shumë arsye që gjyqtari nuk shkruan. Gjyqtari shkruan vendimet dhe po shkruan vendimet mirë, vlerësohet për vendimmarrjen. Shkrimi dhe botimi janë kritere që merren në pikëzim, merren edhe në vlerësimin për ta quajtur gjyqtar të shkëlqyer, por jo për ta penalizuar. Ky ka qenë qëndrimi konstant që ka mbajtur Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Faleminderit!

Bujar Nishani: Mirë, dakord.

Gjin Gjoni: Unë, diskutimin tim Zoti President, e kam në lidhje me pyetjet të cilat parashtroua. Duke qenë se një nga nënkriteret për të cilën pretendohet, rezulton që trajnimet në Shkollën e Magjistraturës, brenda kuadrit ligjor është e vërtetë ajo që thotë Kryeinspektorja, që ndoshta për vitin për të cilin vlerësohet, nuk është, por në tërësinë e vetë që e parashikon ligji, është 60 ditë, aq sa e parashikon ligji në 5 vjet. Unë them që ky kriter s'ka pse të jetë në atë nivel. Duhet të përmirësohet.

Aspekti i dytë të cilin thotë edhe Zoti Saliko, të themi të drejtën, në projektligjin e ri “Për sistemin e vlerësimit”, ku EURALIUS, bashkë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë kanë përgatitur, është hequr përfundimisht termi i shkrimeve dhe i publikimeve; është hequr përfundimisht termi i gradave shkencore dhe i profesoriatit, për efekt të vlerësimit, çka tregon që deri në momentin aktual, shkrimi ose botimet e ndryshme për gjyqtarët, nuk është kriter vlerësimi. Faleminderit!

Bujar Nishani: Mirë.

Atëherë, nisemi nga propozimi i gjyqtarit, i cili kërkon ndryshimin... Për cilën pikë Marsida, të lutem?

Marsida Xhaferllari: Kërkon së pari ndryshimin e një nënkriteri të grup kriterit të dytë dhe konkretisht të “Aftësisë për të drejtuar procesin gjyqësor”. Nga “Mirë”, kërkon t'i bëhet “Shumë mirë”.

Bujar Nishani: Pra kush është dakord me propozimin e gjyqtarit për ta ndryshuar nga “Mirë” në “Shumë mirë” nënkriterin e dytë të “Aftësisë për të drejtuar procesin gjyqësor”?

Marsida Xhaferllari: E ka “Shumë mirë” rezultatin, por kërkon të ndryshojë edhe atë.

Bujar Nishani: Kush është dakord me kërkesën e gjyqtarit?

S'ka.

Kundra?

Dy, katër, gjashtë, tetë, ... (8).

Rrëzohet pretendimi i gjyqtarit. Mbetet në fuqi vlerësimi i Inspektoratit.

Marsida Xhaferllari: Çështja e dytë që kërkon, kërkon ndryshimin e grup kriterit të tretë nga “Mirë” në “Shumë mirë”, për shkak të “Aftësisë në pjesëmarrjen në

aktivitetet profesionale” dhe “...të shkrimeve dhe botimeve të ndryshme me natyrë juridike”.

Bujar Nishani: Atëherë, kush është dakord me këtë kërkesë të gjyqtarit?

Dy, katër, gjashtë, shtatë (7).

Kundra?

Një, dy, tre (3).

Miratohet kjo kërkesë e gjyqtarit. Ndryshon nëngrupi i tretë.

Marsida Xhaferllari: Kështu që miratohet vlerësimi “Shumë mirë”, me të tre grup kriteret.

Bujar Nishani: I pari u rrëzua.

Marsida Xhaferllari: Po pra, por është nënkriter ai.

Bujar Nishani: Përfundimisht, shumë mira mbetet.

Zoti Saliko, urdhëroni!

(Zoti Saliko nuk ka gjë për të shtuar.)

Vazhdojmë me gjyqtarët e tjerë. Marsida, të lutem vazhdojmë me gjyqtarët e tjerë.

Marsida Xhaferllari: Projekt-vlerësimi i gjyqtarit Arben Zefi, që ushtron detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, është vlerësimi i tij i dytë profesional dhe etik për vitet 2007-2009. Propozohet vlerësimi i tij profesional “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale të përgjithshme”, “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale juridike” dhe “Mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor”. Nuk ka paraqitur ankim, megjithëse ka marrë njoftim të rregullt.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

Një (1).

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Nafije Hasko, e cila aktualisht ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Shkallë së Parë Tiranë. Është vlerësuar për vitet 2007-2009 për herë të dytë.

Bujar Nishani: Hasko apo Curri?

Marsida Xhaferllari: Hasko e mban tashmë. Curri e ka...

Bujar Nishani: Ah, është e njëjta?

Marsida Xhaferllari: Po, është e njëjta.

Bujar Nishani: Dakord.

Marsida Xhaferllari: Është vlerësuar për veprimtarinë gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Propozohet vlerësimi i saj “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Mirë” në grup kriterin e “Aftësive profesionale të përgjithshme”, Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale juridike” dhe “Shumë mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor”. Ka marrë njoftim rregullisht dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

Një (1).

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtari Dritan Caka, i cili është vlerësuar për herë të dytë, për vitet 2007-2009, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Aktualisht është në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Është vlerësimi i tij i dytë profesional. Propozohet vlerësimi i tij “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” në të tre grup kriteret.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

S’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtari Emiljano Ruli, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Është vlerësuar për veprimtarinë e tij pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Është vlerësimi i tij i parë profesional, pasi është emëruar në vitin 2006. Propozohet vlerësimi i tij “Suumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” në të tëra grup kriteret.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

Një (1).

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Metaliaj Softa, për vitet 2007-2009 e ka vlerësimin e saj të dytë profesional. Është vlerësuar për veprimtarinë gjyqësore pranë

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Propozohet vlerësimi i saj “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” në të tre grup kriteret. Ka marrë njoftim rregullisht dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

S’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Klodiana Veizi Mema, e cila ushtron detyrën në Gjykatën Administrative Durrës. Është vlerësimi i saj i dytë profesional dhe etik. Është vlerësuar për veprimtarinë gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Propozohet vlerësimi i saj përfundimtar “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Mirë” tek “Aftësitë profesionale të përgjithshme”, “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale juridike” dhe “Shumë mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional”. Ka marrë njoftim rregullisht dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

S’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtari Elidon Papazisi – në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Është vlerësimi i tij i parë profesional, pasi është emëruar në vitin 2006. Propozohet vlerësimi i tij “Mirë” përfundimisht, si rezultat i vlerësimit “Mirë” tek “Aftësitë profesionale të përgjithshme”, “Pranueshëm” tek “Aftësitë profesionale juridike” dhe “Mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional”. Ka marrë njoftim rregullisht dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

Një (1).

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Matilda Shalla, e cila ushtron detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Është vlerësimi i saj i parë profesional dhe përfshin vetëm 1 vit

kalendari, pasi është emëruar në 2009-ën (në mars të 2009-ës). Propozohet vlerësimi i saj “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek të tre grup kriteret.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

S’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Dhe gjyqtarja e fundit është gjyqtarja Albina Spaha, e cila është vlerësuar për veprimtarinë e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Është vlerësimi i saj i dytë profesional. Propozohet vlerësimi i saj përfundimtar “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale të përgjithshme”, “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale juridike” dhe “Mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor”. Ka marrë njoftim rregullisht dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin?

Kundra?

Një (1).

Miratohet.

Mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Nr. Prot. Tiranë, . .2015
Bulevard "Zog I", Tiranë, Tel: +355 4 259817, Fax: +355 4 259822 www.kld.al

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 29.04.2015)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Delegimet.

Shënim: Sipas rendit të ditës kjo pikë i takon pikës 14, por për shkak të procesverbalit bëhet pika 15 e rendit të ditës.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 15:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Bujar Nishani** (kryetar)
2. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
3. **Flamur Kapllani** (anëtar)
4. **Gjin Gjoni** (anëtar)
5. **Ilir Mustafaj** (anëtar)
6. **Hysen Saliko** (anëtar)
7. **Tritan Hamitaj** (anëtar)
8. **Artan Broci** (anëtar)
9. **Astrit Haxhialushi** (anëtar)
10. **Sokol Çomo** (anëtar)

11. Albana Shtylla (anëtare)

12. Vangjel Kosta (anëtar)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarët: Zoti Xhezair Zaganjori, Zoti Dritan Caka dhe Zoti Nasip Naço.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 7. Etleva Vila, Asistente e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 8. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.*

RENDI I DITËS:

15. Delegimet

Bujar Nishani: Kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës, delegimet (sipas procesverbalit i bie pika 15).

Po, Atëherë, Kryeinspektoria atje, Zoti Gjoni, Zoti Kosta, Zoti Kapllani.

Marsida Xhaferllari: Çështja e parë i përket kërkesës së Gjykatës së Apelit Durrës dhe hidhet shorti për gjykatat, midis: apelit Shkodër, apelit Tiranë, Korçë dhe krimet e rënda.

(Përzgjidhet apeli Tiranë.)

Shorti: Tiranë. Më duhen 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë. (*Çështja nr. 1.*)

Lefter Hahja dhe Shkëlqim Miri.

Vazhdo po tek ata gjyqtarë, për kërkesën e dytë të Gjykatës së Apelit Durrës. Me përjashtim të Marie Qirjazit, Zamir Podës, Fatos Qatos, Valdete Hoxhës, Genti Shalës dhe Lefter Jahja që nuk duhet të marrin pjesë. 3 gjyqtarë. (*Çështja nr. 2.*)

(Përzgjidhet) Gramoz Levanaj. Edhe dy të tjerë.

(Përzgjidhet) Agim Bendo. Edhe një tjetër.

(Përzgjidhet) Ervin Metalla.

Vazhdo në apelin Durrës, 3 gjyqtarë. (*Çështja nr. 3.*)

(Përzgjidhet) Marie...

(*Gjyqtarja Qirjazi ka pengesë dhe prandaj përzgjidhet gjyqtari Malaj.*)

Edhe 2 gjyqtarë.

(Përzgjidhet) Fatmira Hajdari dhe Shkëlqim Miri.

Në apelin Durrës, prapë 2 gjyqtarë. (*Çështja nr. 4.*)

(Përzgjidhet) Fatmira Hajdari dhe Genti Shala.

Apeli Durrës, 3 gjyqtarë. (*Çështja nr. 5.*)

(Përzgjidhet) Maria Qirjazi, Shkëlqim Miri dhe Edmond Gogo.

Në Gjykatën e Apelit Gjirokastër në Apelin për Krime të Rënda, 1 gjyqtar, me përjashtim të Amarildo Laçit. (*Çështja nr. 6.*)

(Përzgjidhet) Saida Dollani.

Në Gjirokastër, të bëhet shorti mes gjykatave: Korçë, Vlorë dhe krime të rënda.

(Përzgjidhet) Korça.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 7.*)

(Përzgjidhet) Stavri Kallço.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 8.*)

(Përzgjidhet) Sotiraq Lubonja.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 9.*)

(Përzgjidhet) Entela Temo.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 10.*)

(Përzgjidhet) Brunilda Orhani.

1 gjyqtar, prapë. (*Çështja nr. 11.*)

(Përzgjidhet) Sotiraq Lubonja.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 12.*)

(Përzgjidhet) Olsi Xhavella.
2 gjyqtarë, me përjashtim të Stavri Kallços. (*Çështja nr. 13.*)
(Përzgjidhet) Olsi Xhavella dhe Sotiraq Lubonja.
2 gjyqtarë, me përjashtim të Gjyzarit. (*Çështja nr. 14.*)
(Përzgjidhet) Alma Liçaj dhe Skënder Damini.
Vazhdo nga Korça. 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 15.*)
(Përzgjidhet) Brunilda Orhani.
1 gjyqtar tjetër, po nga Korça. (*Çështja nr. 16.*)
(Përzgjidhet) Stavri Kallço.
Edhe 1 gjyqtar tjetër. (*Çështja nr. 17.*)
(Përzgjidhet) Sotiraq Lubonja.
1 gjyqtar tjetër. (*Çështja nr. 18.*)
(Përzgjidhet) Etleva Temo.
Vazhdo, 1 gjyqtar tjetër. (*Çështja nr. 19.*)
(Përzgjidhet) Olsi Xhavella.
2 gjyqtarë të tjerë. (*Çështja nr. 20.*)
(Përzgjidhet) Olsi Xhavella, Sotiraq Lubonja.
1 gjyqtar, prapë në Gjirokastër. (*Çështja nr. 21.*)
(Përzgjidhet) Sotiraq Lubonja.
1 gjyqtar nga Korça. (*Çështja nr. 22.*)
(Përzgjidhet) Etleva Temo.
1 gjyqtar, prapë për në Gjirokastër. (*Çështja nr. 23.*)
(Përzgjidhet) Olsi Xhavella.
E fundit për Gjirokastrën. 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 24.*)
(Përzgjidhet) Brunilda Orhani.
Bëj shortin mes gjykatave për të shkuar në Korçë.
(Përzgjidhen) Krimet e rënda.
1 gjyqtar. (*Çështja nr. 25.*)
(Përzgjidhet) Nertina Kosova.
2 gjyqtarë, po aty. (*Çështja nr. 26.*)
(Përzgjidhet) Fehmi Petku dhe Amarildo Laçi.

3 gjyqtarë. (*Çështja nr. 27.*)
(Përzgjidhet) Dhimitër Lara, Amarildo Laçi dhe Saida Dollani.
Vazhdojmë në Korçë, 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 28.*)
(Përzgjidhet) Dhimitër Lara.
Vazhdojmë në apelin Korçë, prapë 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 29.*)
(Përzgjidhet) Nure Dreni.
2 gjyqtarë, po aty. (*Çështja nr. 30.*)
(Përzgjidhet) Fehmi Petku dhe Gjovalin Përnoca.
1 gjyqtar tjetër. (*Çështja nr. 31.*)
(Përzgjidhet) Sokol Binaj.
Bëj shortin për në Shkodër.
(Përzgjidhet) Krimet e rënda.
1 gjyqtar. (*Çështja nr. 32.*)
(Përzgjidhet) Fehmi Petku.
2 gjyqtarë për në apelin Shkodër. (*Çështja nr. 33.*)
(Përzgjidhet) Nertina Kosova dhe Fehmi Petku.
1 gjyqtar. (*Çështja nr. 34.*)
(Përzgjidhet) Albana Boksi.
1 gjyqtar, po në apelin Shkodër. (*Çështja nr. 35.*)
(Përzgjidhet) Dhimitër Lara.
Vazhdo! 2 gjyqtarë. (*Çështja nr. 36.*)
(Përzgjidhet) Gjovalin Përnoca dhe Fehmi Petku.
2 gjyqtarë, po në apelin Shkodër. (*Çështja nr. 37.*)
(Përzgjidhet) Fehmi Petku dhe Nertina Kosova.
3 gjyqtarë. (*Çështja nr. 38.*)
(Përzgjidhet) Dhurata Haveri, Amarildo Laçi dhe Nure Dreni.
2 gjyqtarë. (*Çështja nr. 39.*)
(Përzgjidhet) Nure Dreni dhe Nertina Kosova.
E fundit për në Shkodër. 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 40.*)
(Përzgjidhet) Dhimitër Lara.
Bëj short midis gjithë gjykatave për të shkuar tek krimet e rënda.

(Përzgjidhet) Vlora.

5 gjyqtarë nga Vlora për tek krimet e rënda. (*Çështja nr. 41.*)

(Përzgjidhet) Petrit Aliaj, Nazmi Troka, Margarita Buhali, Skënder Damini, Sokol Ngresi.

Nga Mati për në Dibër. (*Çështja nr. 42.*)

(Përzgjidhet) Murat Lleshi.

Prapë nga Mati në Dibër. (*Çështja nr. 43.*)

(Përzgjidhet) Ali Koleci.

Edhe 1 tjetër. (*Çështja nr. 44.*)

(Përzgjidhet) Murat Lleshi.

Nga Kurbini, në Krujë. 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 45.*)

(Përzgjidhet) Marsela Shehu.

Nga Tropoja, në Kukës. (*Çështja nr. 46.*)

(Përzgjidhet) Dritan Seci.

3 gjyqtarë. (*Çështja nr. 47.*)

(Përzgjidhet) Artan Hajredinaj, Sami Ujkashi dhe Erjon Çela.

Nga Lezha, në Kurbin. (*Çështja nr. 48.*)

(Përzgjidhet) Jak Ndoka.

1 gjyqtar tjetër. (*Çështja nr. 49.*)

(Përzgjidhet) Ded Deda.

Nga Lezha në Kurbin, 1 gjyqtar tjetër. (*Çështja nr. 50.*)

(Përzgjidhet) Ilir Përdeda.

Vazhdo! Edhe 1 gjyqtar midis Ilir Përdedës dhe Parashqevi Ademit. (*Çështja nr. 51.*)

(Përzgjidhet) Parashqevi Ademi.

Nga Kruja, në Kurbin. (*Çështja nr. 52.*)

(Përzgjidhet) Engjëllushe Tahiri.

Nga Lezha, në Kurbin. (*Çështja nr. 53.*)

(Përzgjidhet) Ilir Përdeda.

Vazhdo, po aty. 1 gjyqtar, por jo kryetarin. (*Çështja nr. 54.*)

(Përzgjidhet) Jak Ndoka.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 55.*)
(Përzgjidhet) Parashqevi Ademi.
Kjo është anuluar. (*Çështja nr. 56.*)
1 gjyqtar, po aty. Nga Lezha, në Kurbin. (*Çështja nr. 57.*)
(Përzgjidhet) Jak Ndoka.
1 gjyqtar tjetër. (*Çështja nr. 58.*)
(Përzgjidhet) Ded Deda.
1 gjyqtar, nga Lezha, në Kurbin. (*Çështja nr. 59.*)
(Përzgjidhet) Ilir Përdeda.
1 gjyqtar tjetër. (*Çështja nr. 60.*)
(Përzgjidhet) Parashqevi Ademi.
Nga Kurbini, në Lezhë. 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 61.*)
(Përzgjidhet) Ded Miri.
Nga Fieri, në Lushnje. 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 62.*)
(Përzgjidhet) Engert Pëllumbi.
Nga Kurbini, në Mat. (*Çështja nr. 63.*)
(Përzgjidhet) Ded Miri.
Nga Korça (kolegji penal), në Pogradec. (*Çështja nr. 64.*)
(Përzgjidhet) Arjola Kristo.
2 gjyqtarë, po aty. (*Çështja nr. 65.*)
(Përzgjidhet) Admir Belishta dhe Arben Lera.
1 gjyqtar, nga Korça, në Pogradec. (*Çështja nr. 66.*)
(Përzgjidhet) Alvano Murataj.
1 gjyqtar, po aty. (*Çështja nr. 67.*)
(Përzgjidhet) Arjola Kristo.
Nga Shkodra (kolegji penal), në Pukë. (*Çështja nr. 68.*)
(Përzgjidhet) Arbër Çela.
Po nga Shkodra (kolegji civil). (*Çështja nr. 69.*)
(Përzgjidhet) Sokol Shehu.
Nga Gjirokastra, në Sarandë. (*Çështja nr. 70.*)
(Përzgjidhet) Blerta Çibuku.

1 gjyqtarë, po aty. (*Çështja nr. 71.*)

(Përzgjidhet) Mirela Kore, Guximtar Boçi.

1 gjyqtar, po aty. (*Çështja nr. 72.*)

(Përzgjidhet) Pëllumb Vehbiu.

Nga Vlora, në Sarandë. 3 gjyqtarë. (*Çështja nr. 73.*)

(Përzgjidhet) Laurent Fuçia, Anastasi Shehu dhe Arqile Basho.

Nga Gjirokastra në administrativen Gjirokastër. (*Çështja nr. 74.*)

(Përzgjidhet) Blerta Çibuku.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 75.*)

(Përzgjidhet) Blerta Çibuku.

Nga Korça, në administrative. (*Çështja nr. 76.*)

(Përzgjidhet) Miljana Muça.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 77.*)

(Përzgjidhet) Markelian Kuqo.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 78.*)

(Përzgjidhet) Seladin Pysqyli.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 79.*)

(Përzgjidhet) Alvano Murataj.

Shtesat.

Bëj shortin mes apeleve: apeli Korçë, Vlorë, krimet e rënda.

(Përzgjidhet) Krimet e rënda.

1 gjyqtar. (*Çështja nr. 1.*)

(Përzgjidhet) Nertina Kosova.

Nga apeli Korçë, në apelin Gjirokastër. (*Çështja nr. 2.*)

(Përzgjidhet) Etleva Temo.

Bëj shortin midis: apelit Vlorë, Durrës, krimeve të rënda.

(Përzgjidhet) Krimet e rënda.

2 gjyqtarë. (*Çështja nr. 3.*)

(Përzgjidhet) Amarildo Laçi dhe Saida Dollani.

Nga Mati, në Dibër. (*Çështja nr. 4.*)

(Përzgjidhet) Murat Lleshi.

Nga Gjirokastra, në Sarandë. (*Çështja nr. 5.*)

(Përzgjidhet) Pëllumb Vehbiu.

Nga Korça, në administrative Korçë. 1 gjyqtar. Pa kryetarin. (*Çështja nr. 6.*)

(Përzgjidhet) Arben Lera.

1 gjyqtar tjetër, po aty. (*Çështja nr. 7.*)

(Përzgjidhet) Seladin Pysqyli.

Po aty, 1 gjyqtar. (*Çështja nr. 8.*)

(Përzgjidhet) Luljeta Kole.

Nga Shkodra, në administrative Shkodër. (*Çështja nr. 9.*)

(Përzgjidhet) Andri Ymeri.

Mbaruam.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë